



UDHËZUES PEDAGOGJIK PËR ARSIMIMIN E NXËNËSVE ME SINDROMË DOWN

CIKLI FILLOR
DHE I MESEM I ULËT



Është **detyrë e jona të krijojmë një botë**
ku mund të lulëzoj **potenciali i çdo fëmije**
S.G

Autor: Ermira Shabani

Ky material nuk mund të riprodhohet apo shpërndahet në ndonjë formë (qoftë elektronike, i shtypur, fotokopje) pa miratim të Shoqatës Down Syndrome Kosova.

Hyrje

Ky material është i destinuar

- për mësime të cilët fillor dhe të mesëm të ulët, të cilët përgjatë rrugëtimit të tyre profesional kanë mësuar dhe mësojnë nxënës me nevoja të veçanta arsimore;
- për vet nxënësin me nevoja të veçanta arsimore dhe familjen e tij;
- për të gjithë ata të cilët angazhohen që gjithëpërfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në sistemin edukativo-arsimor në vendin tonë të jetë kuptimplotë dhe e zbatueshme në praktikë.

Përmbajtja e këtij materiali është përpiluar nga të dhënat kërkimore, praktikat e vendeve të zhvilluara për arsimimin e nxënësve me nevoja të veçanta edukativo-arsimore, nga përvoja direkte e punës me nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe institucione edukativo-arsimore në kontekstin kosovar.

Ky material ka për qëllim të përçojë mesazhin e shkollës gjithëpërfshirëse, si mjedis në të cilin çdo fëmijë mund të rritet dhe të zhvillojë potencialin e tij.

▣ Përmbajtja

Hyrje	3
1. Informacion i përgjithshëm	7
1.1 Çfarë është Aftësia e Kufizuar Intelektuale?	7
1.2 Sindroma Down	8
1.2.1 Disa fakte bazike	9
1.2.2 Si të shprehemi	10
1.3 Arsimi dhe gjithëpërfshirja	11
1.3.1 Shkollat gjithëpërfshirëse	13
1.3.2 Bashkëpunimi i shkollës gjithëpërfshirëse	14
1.3.3 Hartimi i objektivave të Planit Individual për Arsim	14
1.3.4 Kush e mbështet arsimin gjithëpërfshirës?	15
2. Një nxënës me sindromë Down në shkollë	18
2.2 Aspektet shëndetësore dhe zhvillimore që ndikojnë në mësimnxënie	18
2.3 Ndërhyrja e hershme dhe arsimimi	24
2.4 Tranzicioni për në shkollë	24
2.5 Shkolla	25
3. Qasja dhe metodologjia pedagogjike	26
3.2 Qasja dhe teknika të përgjithshme pedagogjike	26
3.3 Përshtatja e objektivave të planit mësimor	32
3.4 LEXIMI	43
3.4.1 Aftësitë e të lexuarit tek fëmijët me sindromë Down	43
3.4.2 Leximi i hershëm dhe zhvillimi i të lexuarit	45
3.4.3 Leximi logografik (leximi përmes pamjes vizuale)	46
3.4.4 Të mësuarit e shkronjave	48
3.5 SHKRIMI	49
3.6 GJUHA DHE KOMUNIKIMI	50
3.6.1 Aftësitë e komunikimit tek nxënësi me sindromë Down	50
3.6.2 Vlerësimi dhe planifikimi	50
3.6.3 Komunikimi i plotë	51
3.6.4 Gjuha dhe sjellja	57
3.7 MATEMATIKA	58
3.7.1 Aftësitë matematikore tek nxënësit me sindromë Down	58
3.7.2 Vlerësimi matematikor	58
3.7.3 Pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve me sindromë Down në matematikë	59
3.7.4 Programet matematikore	64
3.8 TRANZICIONI NGA CIKLI FILLOR NË CIKLIN E MESËM TË ULËT	65
3.9 PËRSHTATJA E PLANIT MËSIMOR PËR LËNDË NË CIKLIN E MESËM TË ULËT	65
3.10 MATERIALET	73

4 SJELLJA	77
└─ 4.1 Menaxhimi i sjelljes	78
5 PROCESIMI NDIJOR DHE MENAXHIMI I TIJ	81
└─ 5.2 Karakteristikat e çrregullimit të procesimit ndijor	81
└─ 5.2.1 Çrregullimi i procesimit ndijor dhe edukimi i përgjithshëm në klasë	82
└─ 5.2.2 Menaxhimi i problemeve ndijore	84
6 PËRFSHIRJA E BASHKËMOSHATARËVE	85
└─ Korniza ligjore për Arsim Gjithëpërfshirës në Kosovë	91
└─ Bibliografia	92

1 Informacion i përgjithshëm

1.1 Çfarë është Aftësia e Kufizuar Intelektuale?

Aftësia e kufizuar intelektuale karakterizohet nga kufizime të ndjeshme në funksionimin intelektual dhe në përshtatshmërinë e të sjellurit të shprehura këto në aftësi konceptuale, sociale dhe të përshtatjes. Kjo gjendje klinike shfaqet para moshës 18 vjeç (AAIDD, 2002).

Shkaqet e aftësisë së kufizuar intelektuale janë të shumta dhe mund të përmbliken në këtë mënyrë:

30–40%

të rasteve nuk dihet saktësisht shkak;

10%

të rasteve kanë shkaktarë perinatal;

5%

-të rasteve kanë shkaktarë kushtet gjenetike (p.sh., sindroma Down);

5%

të rasteve kanë shkaktarë postnatal;

30%

të rasteve kanë shkaktarë prenatal;

Duhet theksuar se përqindjet e paraqitura më lartë ndryshojnë vazhdimisht në bazë të ritmit të zhvillimeve në fushën e biologjisë, mjekësisë dhe gjenetikës.

Në të kaluarën përshkrimi i vonësës së zhvillimit mendor bazohej vetëm në vlerësimin e koeficientit të inteligjencës, duke përdorur klasifikimin psikometrik. Në ditët e sotme tendenca është drejtë një klasifikimi global, pra duke marrë në konsideratë aspektet biologjike, kognitive, emocionale dhe socio-kulturore të cilat ndërveprojnë në procesin e strukturimit të personalitetit të individit me aftësi të kufizuar intelektuale, duke karakterizuar kështu modalitetet e funksionimit kognitiv dhe afektiv.

Individët me aftësi të kufizuar intelektuale përbëjnë një grup shumë heterogjen, ku përfshihen që nga një numër i vogël individësh me një nivel funksionimi shumë të ulët e deri tek ata që përbëjnë pjesën më të madhe, me vështirësi të shkallës së lehtë.

1.2 Sindroma Down

Sindroma Down është kusht gjenetik. Trupi i njeriut është i përbërë nga qelizat. Çdo qelizë në trupin e njeriut ka 46 kromozome, 23 kromozome të trashëguar nga njëri prind dhe 23 të tjera të trashëguar nga tjetri. Në rastin e sindromës Down, në çiftin e 21-të bashkangjitet një kromozom shtesë si pasojë e një ndarjeje anormale qelizore, dhe si rezultat personi ka 47 kromozome në çdo qelizë ose në një pjesë të qelizave të trupit të tij.

Termi sindromë nënkupton një varg karakteristikash të cilat shfaqen së bashku. Për herë të parë sindroma Down është përshkruar në një punim akademik të Dr. Longdon Down, në vitin 1886, për nder të të cilit është emërtuar me po këtë emër. Sindroma Down nuk është sëmundje, ndaj dhe nuk ofrohet kurë mjekësore për të.

Diagnostikimi i saktë i sindromës Down mund të bëhet gjatë shtatëzënisë dhe pas lindjes së foshnjës.

Analiza diagnostikuese për sindromën Down është kariotipi, i cili kryhet si ekzaminim edhe përpara lindjes me anë të një procedure që quhet amniocentezë (marrja dhe analizimi i lëngut amniotik), analizë e cila bëhet në një periudhë të caktuar gjatë shtatëzënisë. Kariotipi është edhe analiza që i bëhet foshnjës kur mjekët dyshojnë për prezencën e sindromës Down direkt pas lindjes së tij. Prania e këtij kromozomi shtesë sjell vonesa në zhvillimin fizik dhe kognitiv të individit. Duhet theksuar se zhvillimi i madhë në fushën e mjekësisë ka rritur mundësitë për diagnostikim të hershëm.

Fakti më i rëndësishëm që duhet ditur rreth individëve me sindromën Down, është se me kujdesin dhe mbështetjen e duhur që në fëmijërinë e hershme, këta individë mund të arrijnë të përmbushin potencialin e tyre, fakt ky që çon në mundësinë për të jetuar një jetë të gjatë, gjithëpërfshirëse dhe të pavarur, pra të jenë pjesë aktive e komunitetit ku jetojnë.

Sindroma Down është sindroma më e hasur në botë, 1 në 691 lindje. Në bazë të të dhënave të Shoqatës Down Syndrome Kosova, në Kosovë brenda vitit lindin rreth 35–40 foshnja me sindromë Down, ndërsa numri i përgjithshëm i individëve me sindromë Down në Kosovë është mbi 980.

1.2.1 Disa fakte bazike

- ✓ Në ditët e sotme jetëgjatësia e individëve me sindromë Down i kalon të 60-tat. Vëmendje dhe kujdes të veçantë i duhet kushtuar aspekteve shëndetësore që mund të shoqërojnë sindromën.
- ✓ Individët me sindromë Down arsimohen në shkolla publike, punësohen dhe aftësohen për një jetë gjysëm ose plotësisht të pavarur.
- ✓ Ka disa tipare fizike që karakterizojnë individët me sindromë Down, mirëpo nga këto tipare individ i me sindromë Down mund të ketë disa ose asnjërën prej tyre. Një individ me sindromë Down i ngjason më shumë familjarëve të tij se sa një individ tjetër me të njëjtën sindromë.
- ✓ Individët me sindromë Down, si gjithë individët e tjerë, përjetojnë dhe shfaqin një gamë të plotë emocionesh. Socializimi është një pikë e fortë dhe i pa ndikuar nga prania e kromozomit shtesë.
- ✓ Individët me sindromë Down kanë një shkallë më të lartë të rrezikut të përkeqësimeve shëndetësore, për shkak të kushteve të caktuara shëndetësore (siç janë defektet congenitale (të lindura) të zemrës, probleme me frymëmarrje, në dëgjim, shikim, kushtet e tiroides), përparimi në kujdesin shëndetësor dhe trajtimi i këtyre problematikave ka bërë të mundur një jetesë të shëndetëshme për individët me sindromë Down.
- ✓ Të rriturit me sindromë Down nuk janë fëmijë, dhe nuk duhet të konsiderohen si të tillë. Ata ndjejnë kënaqësi në aktivitete dhe në shoqëri të të rriturve të tjerë. Kanë nevoja dhe ndjenja sikurse bashkëmoshatarët e tyre me zhvillim tipik.

1.2.2 Si të shprehemi

Në shprehitë tuaja vendosni personin përpara problemit të zhvillimit.

▶ Përdorni nxënësi im me sindromën Down ose emrin e nxënësit dhe jo *nxënësi im Down. ose ai Down-i.*

▶ Thoni nxënësi im merr shërbime të edukimit special dhe jo *ai është nxënës i edukimit special.*

▶ Nxisni të gjithë nxënësit që të mendojnë për individët me sindromën Down si individë.

Fjalët krijojnë barriera.

▶ Shmangni termat me konotacion negativ, si psh., *i/ e vonuar.*

▶ Preferohet të përdoret vonesë në zhvillim dhe jo *i/ e vonuar mendor ose i paaftë.*

▶ Nëse nuk jeni të sigurtë si t'i referoheni problematikës zhvillimore të nxënësit, pyesni prindërit.

▶ Përpiquni të vendosni individin përpara aftësisë së kufizuar psh., zhvillim tipik dhe jo *normal.*

Përdorni shprehje neutrale.

▶ Një individ ka sindromën Down dhe jo *vuan nga, është viktimë e... ose i prekur nga*

▶ Përdorni nxënësi im ka sindromën Down dhe jo *nxënësi im vuan nga sindroma Down.*

▶ Shmangni thëniet "Janë aq të dashur/ të lumtur gjatë gjithë kohës". Individët me sindromën Down përjetojnë emocione të ndryshme dhe nuk janë të ngjashëm me njëri tjetrin në mënyrën e përjetimeve të emocioneve.

Nxënës me aftësi të kufizuar apo nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Në Kosovë, në kontekstin edukativo-arsimor përdoret termi nevoja të veçanta arsimore pra – nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

1.3 Arsimi dhe gjithëpërfshirja

Përfshirja sociale është një çështje e të gjithë shoqërisë dhe jo vetëm e sistemit arsimor. Arsimi gjithëpërfshirës, si një hap i parë drejt përfshirjes sociale, është në dobi të të gjithë shoqërisë. Përvoja e shekullit të kaluar i dha një mësim të çmuar shoqërisë se veçimi i një pjese të nxënësve në shkolla të veçanta ka efekte negative në jetën e tyre të mëtejme por edhe të shoqërisë në përgjithësi. Në shumë sisteme arsimore të vendeve të ndryshme, gjithëpërfshirja është bërë tashmë realitet, por i shoqëruar me vështirësi të shumta. Me këtë sfidë po ballafaqohet edhe Kosova, e cila po bënë përpjekje në drejtim të realizimit të konceptit të arsimit gjithëpërfshirës.

Gjithëpërfshirja si filozofi arsimore është relativisht e re në Kosovë, edhe si koncept edhe si praktikë. Ky koncept dhe kjo praktikë ka ardhur në Kosovë pas vitit 1999 bashkë me reformat tjera arsimore.

Gjithëpërfshirja në arsim ka si synim përfshirjen e të gjithë fëmijëve pa dallim race, gjinie, etnie, aftësie të kufizuar apo ndonjë dallim tjetër në shkollën më të afërt të rregullt.

Gjithëpërfshirja është një proces në të cilin të gjithë nxënësit, duke përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara, arsimohen së bashku për të gjithë ose të paktën shumicën e ditës së shkollës. Për të folur për gjithëpërfshirje, propozuesit e saj pohojnë se duhet të ketë një pjesëmarrje të përgjithshme mbi 80% të aktivitetit akademik ditor, ndryshe nga një shumicë e thjeshtë e cila mund të përfshijë një pjesëmarrje shumë më të vogël deri në 50% të aktivitetit akademik. Me mbështetjen e mjaftueshme, nxënësit marrin pjesë në klasa të arsimit të përgjithshëm të përshtatshme për moshën në shkollat e lagjeve të tyre.

Arsimi Gjithëpërfshirës krijon kushte për arsim të barabartë dhe cilësor, ofron metoda të përshtatura mësimore që synojnë përmirësimin e nevojave të veçanta si dhe trajnime shpesh për mësuesit dhe orientohet drejt përfshirjes së prindërve si partnerë të nevojshëm në arsimimin e fëmijës. Arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara konsiderohet, para së gjithash, si një proces vazhdimisht në përmirësim i cili kërkon kohë si dhe angazhimin e të gjithë aktorëve institucional dhe partnerëve/shoqërisë civile në ndërtimin e një sistemi të suksesshëm.

Vështirësitë në arsimin gjithëpërfshirës janë në: qëndrimet e mësuesve dhe metodat e ngurta të mësimdhënies, kurrikulat jo të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, mungesën e pajisjeve didaktike të përshtatura, mungesa e përshtatshmërisë në shkolla, mungesa e mësuesve mbështetës dhe mospërfshirja e prindërve. Reforma për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës përfshin ndryshime dhe përmirësime në mentalitetin dhe qëndrimin e shoqërisë ndaj diversitetit si dhe përmirësim të politikave dhe praktikave të shkollës dhe mbarë sistemit arsimor.

Studimet kanë treguar se kur përfshirja aplikohet në mënyrë efektive, arrihen përfitime të mëdha akademike dhe sociale për të gjithë nxënësit, si ato që kanë nevoja të veçanta, po

ashtu edhe për nxënësit me zhvillim neurotipik. Nxënësit me zhvillim neurotipik janë më pranues ndaj dallimeve ndërsa nxënësit me aftësi të kufizuara janë më të motivuar. Pranimi i vërtetë i diverzitetit zhvillohet në brendësi të mjedisit shkollor dhe më pas përcillet në shtëpi, vendin e punës dhe në komunitet.

Gjithëpërfshirja realizohet kur:

Ndërtohen dhe zbatohen praktika mësimore të përshtatshme, lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë, duke synuar një shkollë për të gjithë fëmijët.

Përgatiten mësuesit dhe profesionistët e tjerë që zhvillojnë aktivitetin e tyre në institucionet arsimore për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë.

Krijohet atmosferë mikpritëse dhe mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë nga bashkëmoshatarët, mësuesit, psikologët, punonjësit social, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërit e fëmijëve të tjerë.

Forcohet bashkëpunimi me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë për t'i bërë ata partnerë të barabartë në procesin e arsimimit të fëmijëve të tyre, si dhe në përfshirjen e prindërve të fëmijëve të tjerë.

Rritet përfshirja dhe angazhimi i autoriteteve arsimore për të hartuar politika arsimore gjithëpërfshirëse, për të zbatuar kuadrin ligjor ekzistues dhe praktikat zhvilluese, për të përshtatur programet mësimore në varësi të veçorive individuale të çdo fëmije.

Krijohen kushte të përshtatshme, në mënyrë që çdo nxënës, përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë, të zhvillojnë aftësitë e tyre, përkrah bashkëmoshatarëve.

1.3.1 Shkollat gjithëpërfshirëse

Shkollat gjithëpërfshirëse promovojnë dhe sigurojnë edukim dhe arsimim për të gjithë fëmijët pa marrë parasysh kushtet e tyre fizike, intelektuale, shoqërore, emocionale dhe gjuhësore. Gjithëpërfshirja është proces i cili nuk mund të arrihet brenda një kohe të shkurtër. Kjo ka si synim ndryshimin e vazhdueshëm të sistemit arsimor, të shkollës por edhe të vetë mësimit për ta bërë atë më fleksibil, më të përshtatshëm për t'ju përgjigjur nevojave dhe larmisë së nxënësve. Synimi është që shkolla të jetë një vend ku çdo fëmijë apo nxënës të ketë mundësi të shpalosë vlerat individuale, të ndjehet i pranuar dhe i vlerësuar dhe të përfitojë maksimalisht nga procesi mësimor.

Shkolla gjithëpërfshirëse promovon dhe respekton këto parime:

- ▶ Përfshirjen, edukimin dhe arsimin e çdo nxënësi;
- ▶ Eliminimin e pengesave të çdo nxënësi në mësimnxënie;
- ▶ Rritjen e pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor;
- ▶ Planifikimi i mësimit duke marrë parasysh nevojat e secilit nxënës në klasë.
- ▶ Nxënësit janë të përfshirë në mënyrë aktive në mësimit.
- ▶ Mësuesit planifikojnë dhe vlerësojnë në bashkëpunim me njëri-tjetrin.
- ▶ Mësuesit dhe gjithë personeli bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.
- ▶ Mësuesit dhe nxënësit trajtojnë njëri-tjetrin me respekt.
- ▶ Ekziston partneriteti midis shkollës dhe komunitetit.
- ▶ Drejtoria e shkollës dhe mësuesit bashkëpunojnë.
- ▶ Nxënësit vlerësohen në mënyrë të drejtë.
- ▶ Shkolla përpiqet të minimizojë çdo formë të diskriminimit.
- ▶ Shkolla përpiqet të pranojë të gjithë nxënësit e zonës që mbulon.
- ▶ Shkolla organizon grupe të mësimit në mënyrë që të ndihmojë të gjithë nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë.
- ▶ Organizon trajnime të mësuesve që t'iu ndihmojë atyre në trajtimin e larmisë së nevojave të nxënësve.
- ▶ Praktikat e punës me fëmijët me nevoja të veçanta shfrytëzohen për zvogëlimin e pengesave në mësimit dhe pjesëmarrje aktive në procesin mësimor të të gjithë

1.3.2 Bashkëpunimi i shkollës gjithëpërfshirëse

Prindërit janë forca shtytëse për ndryshim pozitiv të shkollës, prindërit kanë kontribuar në reformën arsimore dhe gjithëpërfshirëse në Kosovë. Sot, shumë shkolla kanë prindërit si partnerë, ata së bashku kujdesen për një dimension më të gjerë të jetës së nxënësve, si në kuptimin ekzistencial edhe në drejtim të përfshirjes së tyre në shoqëri. Studimet kanë vërtetuar se angazhimi i prindërve kontribuon në cilësinë dhe në efikasitetin e shkollës. Shkollat gjithëpërfshirëse dallojnë edhe në bashkëpunimin efikas me prindër. Qëllimi i bashkëpunimit është që prindërit e nxënësve të inkurajohen më shumë të bashkëpunojnë me shkollën. Përgjegjësia për komunitetin shkollor krahas shkollës do të marrin edhe prindërit si një grup, ata do të mbështesin shkollën dhe do ta bëjnë atë më të fuqishme. Ky shkëmbim i informatave dhe ideve në bashkëpunim me shkollën i forcon prindërit, në suksesin më të madh të fëmijëve në shkollë dhe kontribuon në masë të madhe për të dyja palët, shkolla e fuqishme dhe prindërit të fuqishëm.

Rëndësia e përfshirjes së prindërve në shkollë është shumë e madhe, në dekadat e fundit kjo temë është në fokus të shumë studimeve. Bashkëpunim i mirë në mes të shkollës dhe prindërve mundëson monitorimin e vazhdueshëm në funksionimin dhe zhvillimin e nxënësve, ose, në gjetjen e shkakut të ndonjë vështirësie, duke treguar boshllëqet dhe për të inkurajuar rrjedhën normale të zhvillimit. Bashkëpunimi i ndërsjellët i shkollave dhe familjeve promovon edukimin dhe arsimin, andaj, ka një ndikim pozitiv në suksesin e fëmijëve në shkollë, por edhe në sjelljen e tyre të përgjithshme. Arritja e suksesit të fëmijëve në shkollë nuk trashëgohet por ndikimi më i madhë i suksesit vjen nga edukimi varësisht nga ajo se si fëmijët ambientohen në shkollë. Prindërit kanë ndikim edhe tek fëmijët e vegjël se në çfarë mënyre në të ardhmen këta fëmijë do të përshtaten në shkollë. Bashkëpunimi i pamjaftueshëm ndërmjet shkollës dhe prindërve ka pasoja serioze në arritjen e rezultateve në mësimnxënie dhe në mësimdhënie. Në qendër të bashkëpunimit mes shkollave dhe prindërve është mirëqenia e fëmijës. Një qëllim i rëndësishëm i bashkëpunimit midis prindërve dhe shkollës është shkëmbimi i rregullt dhe të institucionalizuar të informacioneve dhe ideve.

1.3.3 Hartimi i objektivave të Planit Individual për Arsim

Plani Individual i Arsimit (PIA) është dokument zyrtar pedagogjik, i cili hartohet për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët ekipi vlerësues komunal apo edhe ekipi në nivel institucioni ka marrë vendim për arsim me nevoja të veçanta arsimore.

Plani Individual i Arsimit shërben për planifikim sistematik të nxënies, mësimdhënies, për mbështetjen dhe ndjekjen e përparimit individual të fëmijës.

Plani Individual i Arsimit duhet të zhvillohet përmes një procesi bashkëpunues, duke përfshirë shkollën, prindërit, fëmijët (kur është e përshatashme) dhe personelin tjetër përkatës. PIA është një dokument i besueshëm (konfidencial) dhe informatat për të mund t'u jepen të tjerëve vetëm me lejen e prindërve. Ai i referohet përshtatjes së kurrikulës dhe fokusohet në nevojat me prioritet të nxënësit.

Plani Individual i Arsimit përcakton:

Qëllimet edukative, arsimore të fëmijës për periudhën që zgjat plani individual;

Rezultatet e nxënies të fëmijës, përmes të cilave realizohet qëllimi i synuar;

Metodat dhe format e punës, të nevojshme për të realizuar rezultatet e nxënies;

Burimet e nevojshme për shërbimet që duhet ofruar si dhe burimet ekzistuese;

Përmbajtjen e individualizuar të lëndëve mësimore ose të fushave të aktiviteteve;

Format e vlerësimit të fëmijës;

Personat përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e PIA-s;

Procesin e monitorimit dhe rishikimit të tij.

Cilësia e procesit për zhvillimin e Planit Individual të Arsimit në një mënyrë përcakton cilësinë dhe efektivitetin e planit. Koordinim i bashkëpunimit dhe i përgjegjësive midis aktorëve të ndryshëm është thelbësor.

1.3.4 Kush e mbështet arsimin gjithëpërfshirës?

E gjithë mbështetja dhe shërbimet që nxënësit dhe mësuesit do të kenë nevojë, si modifikimet e temave mësimore; teknologjia mbështetëse; komunikimet e vazhdueshme; mbështetje profesionale; një plan sjellje; trajnimi i stafit; bashkëpunimi i stafit; mbështetje psikologjike dhe profesionale; terapi e gjuhës dhe të folurit dhe terapi fizike, duhet të reflektohen tek Plani Individual i Arsimit. Është e nevojshme që shkolla t'i ofrojë këto shërbime ose të bëjë përpjekje të vazhdueshme që të sillen këto shërbime në shkollë, aty ku nxënësi qëndron dhe mund t'i përfitojë këto shërbime pas kryerjes së programit akademik. Arsimi gjithëpërfshirës si filozofi arsimore për t'u jetësuar kërkon edhe mekanizma mbështetës të cilët i ndihmojnë institucionet arsimore në sigurimin e gjithëpërfshirjes. Në kuadër të kësaj në Kosovë funksionojnë disa mekanizma të cilët i mbështesin institucionet arsimore në këtë fushë.

Zyrtari për arsim gjithëpërfshirës – ka për detyrë që së bashku me Drejtorinë Komunale të Arsimit të zbatojë politikën gjithëpërfshirëse për aktivitete të ndryshme, që janë në harmoni me politikën e MASHTI-it për arsimin e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Ekipi vlerësues pedagogjik komunal – është ekip vlerësues dhe përkrahës i themeluar dhe organizuar nga Komuniteti për t'ju përgjigjur kërkesave dhe nevojave të institucioneve arsimore për të siguruar arsim gjithëpërfshirës. Ekipi vlerësues është i përbërë nga ekspert të arsimit, punonjës social, psikolog, specialist tjerë, si mbështetje e jashtme për institucionet arsimore dhe aftësuese, për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe komunitetin. Ekipi vlerësues përpilon një profil të nxënësit me vlerësimin e aftësive dhe shkathtësive poseduese dhe rekomandon përmes raportit të vlerësimit për mbështetjet e nevojshme për nxënësin, si: llojin e mësimdhënies; shërbimet e mbështetjes; pajisjet dhe instrumentet e nevojshme ndihmëse; shërbimet rehabilituese; transportin e përshtatshëm, hartimin e Planit Individual të Arsimit (PIA) sipas lëndëve të individualizuara apo fushave të aktiviteteve, rekomandon për llojin e arsimit për nxënësin si: institucion parashkollor, shkollë e rregullt ose qendër burimore. Raporti i plotësuar nga ekipi vlerësues i dorëzohet prindërve, DKA-së dhe institucionit.

Edukatori mbështetës – Në bashkëpunim me edukatorët identifikon fëmijët me nevoja të veçanta sipas grup moshave. Planifikon dhe organizon aktivitete të përbashkëta me edukatorët e grupeve ku ka fëmijë me nevoja të veçanta si dhe sipas nevojës punon edhe individualisht me ata. Përpilon planin individual të arsimit bashkë me edukatorët e rregullta, prindin dhe anëtarët tjerë të ekipit të PIA dhe po ashtu ndihmon në vetëdijësimin e stafit të institucionit për procesin e gjithëpërfshirjes. Këshillon dhe ndihmon edukatorët e rregullta se si të punohet me fëmijët me nevoja të veçanta dhe si të menaxhoj punën nëpër grupë dhe s'bashku hartojnë materiale alternative. Ndhmon drejtorin e IP dhe stafin tjetër udhëheqës për akomodimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Bashkëpunon me Qendrat Burimore rreth metodave të mësimdhënies, materialeve mësimore dhe rreth mbështetjes së nevojshme për nxënësit dhe po ashtu ndihmojnë në integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nga Qendra Burimore në shkollë të rregullt dhe nga klaset e bashkangjitura në klaset e rregullta.

Mësuesi mbështetës – Brenda shkollës mësuesi mbështetës në bashkëpunim me mësimdhënësit klasor/kujdestarët identifikojnë fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Përpilon planin individual të arsimit (PIA) bashkë me mësimdhënësin e rregullt, prindin dhe anëtarët tjerë të ekipit të PIA-s dhe po ashtu ndihmon në vetëdijësimin e stafit të shkollës për procesin e gjithëpërfshirjes. Këshillon dhe ndihmon mësimdhënësit e rregullt se si të punohet me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe si të menaxhoj me klasën gjithëpërfshirëse dhe s'bashku hartojnë materiale mësimore alternative. Bashkëpunon me Qendrat Burimore rreth metodave të mësimdhënies, materialeve mësimore dhe rreth mbështetjes së nevojshme për nxënësit dhe po ashtu ndihmojnë në integrimin e fëmijëve me NVA nga Qendra Burimore në shkollë të rregullt dhe nga klaset e bashkangjitura në klaset e rregullta.

Mësuesi udhëtues – Identifikon nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e rregullta dhe institucione tjera dhe i paraqet rastet para grupit bërthamë, bashkëpunon me shkollat e rregullta, identifikon nevojat e nxënësve dhe mbështet ato me materiale dhe mjete tjera të nevojshme, mbështet mësimdhënësit e shkollave të rregullta me këshilla profesionale, koordinon punën e Qendrës Burimore me shkolla të rregullta, bashkëpunon me ekipin bërthamë dhe atë mbështetës të shkollës.

Psikologu – Psikologu që ofron shërbime psikologjike në shkollë fokusohet në promovimin dhe zhvillimin mendor e fizik të nxënësve si dhe në ndihmesën dhe mbështetjen që jep për rritjen e cilësisë së procesit të mësim nxënies dhe mësimdhënies. Psikologu bashkëpunon me personelin administrativ dhe pedagogjik për konceptimin dhe realizimin e shërbimeve që lidhen me vlerësimin e rezultateve të nxënësve, me orientimin e karrierës dhe me zhvillimin social dhe personal të nxënësve, nëpërmjet: Sigurimit të shërbimeve të drejtpërdrejta për fëmijët dhe nxënësit në nevojë. Vlerësimin dhe interpretimin të rezultateve të nxënësve, të stafit pedagogjik të shkollës dhe të prindërve. Shërbimeve këshillimore dhe trajnuese për stafin e shkollës dhe prindërit Konceptimit dhe realizimit të shërbimit psikologjik në përputhje me politikat e zhvillimit të arsimit dhe të institucionit arsimor.

Pedagogu – Pedagogu përqendrohet në zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe zhvillimin e profileve të nxënësve në bashkëpunim me mësimdhënësit duke përdorur teknika dhe metoda bashkëkohore po ashtu është bashkëpjesëmarrës në hartimin e PIA-së

2 Një nxënës me sindromë Down në shkollë

2.2 Aspektet shëndetësore dhe zhvillimore që ndikojnë në mësimnxënie

“Para së gjithash individi me sindromë Down është njeri, me të drejta dhe nevoja sikurse çdo njeri tjetër. Zhvillimi i tyre ndikohet nga cilësia e kujdesit, edukimit dhe përvojave sociale që u janë ofruar, sikurse për çdo individ tjetër”.

Nxënësit me sindromë Down janë persona me një mori të pikave të forta dhe sfidave. Të gjithë kanë aftësitë për të mësuar dhe për të vazhduar mësimin gjatë gjithë jetës. Përreth gjithë botës, personat me sindromë Down janë duke dhënë shembuj të arritjeve në shumë fusha akademike, ku ata kanë marrë arsimim të duhur përmes mbështetjes së vazhdueshme të mësimdhënësve, të cilët kanë patur pritshmëri për arritjet dhe sukseset e tyre. Janë disa karakteristika tek sindroma Down të cilat ndikojnë në procesin e mësimnxënies. Është me rëndësi të theksohet që çdo person me sindromë Down është unik dhe karakteristikat e mëposhtme paraqesin disa veçori probabilistike dhe nuk është se hasen tek secili nxënës me sindromë Down. Aty ku haset ndonjë vështirësi në të nxënë, ofrimi i mbështetjes së duhur dhe modifikimeve duhet të bëhet. Mos arritja e suksesit është si pasojë e mungesës së mbështetjes dhe modifikimeve të duhura dhe jo për shkak të mos-aftësisë së nxënësit për të mësuar.

Faktorët të cilët mësuesit duhet të marrin në konsideratë janë efektet që problemet shëndetësore kronike kanë në procesin e të mësuarit. Gjatë kohës që fëmijët kanë arritur moshën për shkollë, shumë prej tyre mund të kenë kaluar një sërë ndërhyrjesh kirurgjike. Edhe pse duken sikur rikuperohen shpejt, problemet kronike shëndetësore lënë gjurmët e tyre. Më poshtë janë disa nga karakteristikat fizike dhe kushtet shëndetësore të cilat mund të ndikojnë në suksesin dhe performancën e nxënësve me sindromë Down në klasë:

Hipotonia e muskujve – Hipotonia është një term mjekësor i përdorur për të përshkruar tonin e dobët të muskujve. Simptomat e hipotonisë përfshijnë probleme me lëvizshmërinë dhe qëndrimin, frymëmarrjen dhe probleme në të folur, përgjumje, dobësi tek ligamentet dhe kyçet, dhe reflekse të dobëta.

Fëmijët me sindromë Down i zhvillojnë aftësitë motorike me renditje të njëjtë sikurse moshatarët e tyre me zhvillim tipik motorik, por me një vonesë të caktuar. Për të kuptuar kërkesat fizike që hipotonia vendos mbi nxënësin me sindromë Down, imagjinoni të gatuar darkë ndërkohë që keni veshur çorape mbi duart tuaja. Nxënësit me sindromë Down mund të frustrohen kur aftësitë e tyre për të plotësuar një detyrë pengohen

nga hipotonia. Zhvillimi i muskujve mund të kërkojë trajtim të vazhdueshëm me fizioterapi ose përmes aktiviteteve sportive.

- ▶ Jepi kohë shtesë një nxënësi me sindromë Down për të plotësuar detyrat.
- ▶ Sigurojini rritjen e mundësive për tu praktikuar sa më shumë në aktivitete fizike.
- ▶ Kontakto dhe bashkëpunohet me fizioterapeutin e fëmijës për të identifikuar dhe përmirësuar nevojat specifike të zhvillimit të muskujve.
- ▶ Për të mbështetur zhvillimin e motorikës fine, përdorni aktivitete forcuese të gishtave dhe duarve.
- ▶ Aktivitetet që përfshijnë angazhimin e të gjitha shqisave dhe materiale të tjera mbështetëse janë një mënyrë e mirë.
- ▶ Ofroni mundësi për të praktikuar aftësitë e vetëndihmës si përdorimi i kopsave dhe zinxhirëve.

Struktura vesh-hundë-fyt - Nxënësit me sindromë Down zakonisht kanë një strukturë kompakte të kockës si dhe inde të buta të veshit, hundës dhe fytyrës. Kjo gjë rrit ndikimin e tyre nga infeksionet e kanaleve të sipërme të hundës dhe atyre të sinusit, si dhe shkallën e këtyre infeksioneve. Gjithashtu mund të ngrejë nivelin e ndjesisë ndaj tingujve dhe vibrimeve. Një nxënës me sindromë Down mund të mbyllë veshët ose të shmangë aktivitete që parashikojnë zhurma të mëdha, prandaj duhet të jeni vigjilent mbi masën e zhurmës që mund të krijohet në klasë.

Problemet e zemrës - një numër i madh i fëmijëve me sindromë Down, rreth 45%, lindin me sëmundje në zemër. Shumë nga këta fëmijë mund të duhet t'i nënshtrohen operacionit në zemër dhe duhet të marrin pjesë në mësimdhënie pa asnjë lloj pengese. Në qoftë se një nxënës i është nënshtruar, ose pret që t'i nënshtrohet një operacioni kardiak, pyesni prindërit në qoftë se është e arsyeshme t'i shpjegohet nxënësve të tjerë lloji i sëmundjes në fjalë.

Apnea - Disa studime të viteve të fundit tregojnë se 45% e personave me sindromë Down mund të vuajnë nga apnea gjatë gjumit. Ky term përdoret kur një person ndërpret frymëmarrjen për intervale shumë të shkurtra kohore, zakonisht nga 10 deri në 20 sekonda, gjatë gjumit. Apnea gjatë gjumit mund të shkaktojë humbje të memories ose dëmtime të tjera intelektuale dhe mund ta bëjë një nxënës më të lodhur dhe letargjik. Nga ana tjetër mund të shkaktojë një nivel të lartë të aktivitetit (që shpesh identifikohet në mënyrë të gabuar si një çrregullim i shkaktuar nga mungesa e vëmendjes). Në qoftë se identifikoni ndonjë nga këto probleme, do të ishte me vend të konsultoheni me prindin e fëmijës.

Dëgjimi, shikimi dhe problemet e gjëndrrës tiroide - 65% deri në 80% të fëmijëve me sindromën Down pësojnë një humbje graduale të dëgjimit si dhe 50% e tyre kanë probleme

me shikimin. Gjithashtu përqindja e atyre që vuajnë nga hipertiroidizmi është tepër e lartë dhe kjo mund të shkaktojë përtacëri, shtim në peshë si dhe luhatje emocionale.

Këshillohet që nxënësit t'i nënshtrohen vizitave okulistike si dhe ekzaminimeve të dëgjimit çdo vit. Vini re që humbja në dëgjim mund të luhatet kur janë të pranishme lëngje në vesh ose kur nxënësi vuan nga dhimbja e veshit. Mund të duket sikur një nxënës po injoron udhëzimet tuaja kur në fakt ai nuk mund t'ju dëgjojë. Informoni prindërit mbi vëzhgimet e juaja. Nëse nuk merren masa këto probleme mund të dëmtojnë seriozisht suksesin akademik dhe social të nxënësit.

Udhëzime për të përmirësuar aftësinë e të dëgjuarit në klasë:

- ✓ Vendoseni nxënësin në bankat e para (kontrolloni lartësinë e bankës për pjesën ku mbështet bërrylet dhe ulësen pasi fëmijët me sindromë Down kanë gjymtyrë më të shkurtëra se moshatarët e tyre).
- ✓ Flisni në mënyrë të drejtpërdrejtë me nxënësin duke i shtuar ligjëratës tuaj edhe shenja, gjeste, si dhe shprehje të fytyrës.
- ✓ Artikuloni qartë dhe jo shpejt.
- ✓ Përdorni ndihma vizuale si p.sh., shkrimi në dërrasën e zezë, tabela të tjera dytësore me materiale ndihmëse etj.
- ✓ Riformuloni dhe ripërsërisni pyetjen ose udhëzimet sa më shpesh.

Udhëzime për të përmirësuar aftësitë vizive në klasë:

- ✓ Vendoseni nxënësin në bankat e para.
- ✓ Përdorni shkrim sa më të madh.
- ✓ Përdorni ndihma vizuale si; shenja në dyscheme ose në mure.

Qëndroni në kontakt me prindërit për t'ju vënë vazhdimisht në dijeni për ndryshimet në shëndetin e fëmijës ose situatën e gjumit, pasi këta faktorë mund të ndikojnë në aftësinë e tyre për të zgjidhur probleme. Planifiko fushat më sfiduese akademike të fëmijës. Lodhja në fund të ditës së shkollës mund të rrisë në mënyrë të konsiderueshme kohën e kërkuar nga fëmija për të procesuar informacion ose udhëzime dhe shkakton frustrim tek fëmija dhe probleme të perceptuara të sjelljes.

Nxënësit me sindromë Down mund t'i nevojitet më shumë kohë shërimi nga sëmundjet, mendo dhe krijo aktivitete alternative dhe më shumë periudha pushimi në këto raste. Motivojini vazhdimisht nxënësit tuaj dhe shmangni situatat ku nxënësit mund të dështojnë.

Memoria dhe kognicioni – Aspektet e memories tek individët me sindromë Down janë studiuar ndër vite, duke përdorur modelin e memories së punës nga Baddeley dhe Hitch. Studimet e bëra për memorien e personave me sindromë Down kanë nxjerr këto rezultate:

- ▶ Memoria vizuo-hapësinore është një pikë e fortë. Kjo memorie është e angazhuar në ruajtjen e informacionit vizual, siç janë imazhet ose objektet dhe vendndodhja e tyre.
- ▶ Memoria verbale duket të jetë një pikë e dobët, madje dhe për ata që kanë aftësi të mira komunikuese. Përmes kësaj memorie ne ruajmë informacionin verbal apo të dëgjuar.
- ▶ Memoria afatgjatë mund të konsiderohet si një pikë e fortë.

Pra, për shkak të vështirësive të memories afatshkurtër shumë nxënës me sindromë Down e kanë të vështirë t'i qasen, të kuptojnë dhe të përpunojnë informacionin me të njëjtën shpejtësi sikurse nxënësit e tjerë, por kjo nuk i pengon ata të mësojnë të njëjtin informacion. Motivimi individual është çelësi për të mësuar.

Prezentojeni informacionin në mënyrë të qartë dhe të renditur. Shpjegoni lidhjen mes informatave në mënyrë që të ndërtoni një sistem të njohurive.

- ▶ Jepini më shumë kohë që të mësoj.

Ofroni më shumë mundësi për të praktikuar atë që ka mësuar. Mbështetjet vizuale janë një strategji efektive për të gjithë nxënësit, në veçanti për nxënësit me sindromë Down duke qenë se e kanë si pikë të fortë përpunimin e informacionit vizual.

Aftësia për të mësuar përmes imitimit është një tjetër pikë e fortë tek personat me sindromë Down. Kjo përbën përparësi sa i përket gjithëpërfshirjes në klasë, ku nxënësi me sindromë Down është i rrethuar nga bashkëmohatarët e tij të cilët shërbejnë si model sjelljeje.

Kuptueshmëria e fjalorit – Kuptueshmëria e fjalorit i referohet aftësisë së individit për të qenë i kuptueshëm gjatë të folurës së tij nga të tjerët. Kjo mund të jetë e vështirë për nxënësit me sindromë Down për shkak të tonusit të dobët muskular, vështirësive në lëvizje të nollës dhe të planifikimit të lëvizjeve motorike.

Për të kuptuar se si një nxënës me sindromë Down mund të ndihet, imagjinoni të komunikoni nevojat e juaja ndërkohë që e keni gojën e mbushur me diçka.

- ▶ Gjatë vlerësimit, shumë nxënës me sindromë Down mund të shfaqin diferencë mes gjuhës receptive (të kuptuar) dhe asaj ekspresive (të folur).
- ▶ Kini parasysh që faktorët situacional siç mund të jetë një dëgjues që nuk ka durim, ankthi, perceptimi i presionit, turpi ose mungesa e vetëbesimit mund të ndikojnë në komunikim dhe në performancën e tij në klasë.
- ▶ Përdorni pyetje të thjeshta dhe jepini kohë për përgjigje. Nëse nxënësi juaj e përdor Gjuhën Kosovare të Shenjave, mësoni disa nga shenjat bazike dhe mësojani ato klasës tuaj.
- ▶ Pranimi në grupin e bashkëmoshatarëve mund të ndikojë në zhvillim të fjalorit të kuptueshëm. Objektivat brenda klasës duhet të përfshijnë aftësimin e nxënësit me sindromë Down në komunikim si dhe mësimin e bashkëmoshatarëve të tij se si të angazhohen në ndërveprime domethënëse.
- ▶ Bashkëpunoni me qendrat e shërbimeve mbështetëse për të asistuar nxënësin me sindromë Down:
 - ▶ Një terapist i gjuhës dhe komunikimit (logoped) mund të kontribuoj në hartim të komponentës së komunikimit brenda PIA-s;
 - ▶ Një terapist okupacional (ergoterapeut) mund të punoj sa i përket kontrollit postural që është i nevojshëm gjatë të folurës;
 - ▶ Audiologu vlerëson nivelin e dëgjimit tek nxënësi;
 - ▶ Nxënësi mund të shfaq një nivel të lartë të të shprehurit verbal apo belbëzim kur është nën stres. Tentoni që ta bëni të ndihet sa më rehat.

Procesimi ndijor – Ne marrim dhe procesojmë informacionin nëpërmjet shqisave, të cilat përfshijnë të pamurit (vizive), të nuhaturit (olfaktore), të shijuarit (gustative), të dëgjuarit (auditore), të prekurit (taktile) dhe lëvizjet (vestibulare) si dhe pozicionin e trupit (proprioceptive).

Shqisat taktile, vestibulare dhe proprioceptive janë më pak të njohura nga shqisat e tjera, megjithatë, këto shqisa janë më të rëndësishmet për funksionin e përditshëm. Ato mund të ndikojnë tek aftësitë akademike, vëmendja, në vetëdijen për trupin tonë, mbrojtjen emocionale, koordinimin e përgjithshëm, aftësitë motorike, vetë inkujarimin, vetëvlerësimin, aftësitë sociale, diskriminimi në të folur dhe në të prekur.

Sfidat në këtë fushë mund të sjellin probleme në sjellje. Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për çrregullimin e procesimit ndijor në reagimet sjellore të një nxënësi në klasë me sindromën Down.

Sistemi	Karakteristikat hipo-reaktive ose hiper-reaktive të sistemit
<p>Taktil Ky sistem na ndihmon për të diskriminuar ndërmjet “kërcënimeve” dhe “jo kërcënimeve” të prekjeve të ndjeshme. Gjithashtu, përmban informacion rreth objekteve, si: cilësia, forma dhe madhësia.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Shmangia e të prekurit. ▶ Nuk pëlqehen materiale të caktuara ▶ Preferohet veshja e rrobave të lirshme. ▶ Ankohet ose i reziston përpjekjeve për të larë flokët, dhëmbët, fytyrën. ▶ Shpesh nuk përcakton dot nëse diçka po e prek në trup.
<p>Vestibular Ky sistem na ndihmon për të koordinuar lëvizjet e syve, kokës dhe trupit (Wheble & Hong, 2006). Kontrollon gjithashtu edhe trupin tonë lidhur me gravitetin.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Shfaq sjellje përsëritëse (tundje ose rrotullime). ▶ Bie shpesh dhe pengohet. ▶ Shfaq kontroll të dobët të syve dhe përqëndrimin. ▶ Shfaq ndjeshmëri të lartë emocionale.
<p>Proprio-receptiv Ky sistem konsiston në komponentë si muskujt, nyjet, tendinat që na sigurojnë ne një nënvetëdije të trupit tonë; p.sh, na mundëson të ulemi në mënyrë të duhur në karrige (Wheble & Hong,</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Shpeshherë është i ngathët. ▶ Mund të shfaqë përplasje duarsh në ajër. ▶ Mund t'i mbaj objektet shumë fort ose shumë lehtë. ▶ Përqafon fort. ▶ Ecën shumë rëndë. ▶ Kërkon presion të lartë duke veshur rroba të rënda ose mbajtur objekte të rënda.

2.3 Ndërhyrja e hershme dhe arsimimi

Programet e mira të ndërhyrjes së hershme ofrojnë një bazë të rëndësishme për rezultatet e ardhshme arsimore (Kendall, 2018). Programet që ofrojnë informacion dhe mbështetje ndaj familjes mund të inkurajojnë zhvillimin e marrëdhënive të mira dhe të kujdesshme si dhe ndihmojnë familjet që të përshtaten me aftësinë e kufizuar, në kontekstin shtëpiak dhe shoqëror. Duhet pasur kujdes që të shmangim nivelin e lartë të stresit në familje rreth pikëpamjes se prindërit janë të vetmit përgjegjës për zhvillimin e fëmijës së tyre (Paige-Smith & Rix, 2006).

Qëllimi i programeve të ndërhyrjes së hershme është të promovojnë rritjen optimale gjatë gjithë fëmijërisë në fushat kryesore të zhvillimit.

Ndërhyrja e hershme në mjedise gjithëpërfshirëse ka çuar në një mësim më të madh dhe në rezultate më të mira shoqërore sesa programet e aplikuara në mjedise veçuese. Hulumtimet gjithashtu tregojnë përparësi edhe për fëmijët me zhvillim tipik në ato mjedise (Baker-Ericzen et al., 2009).

2.4 Tranzicioni për në shkollë

Një nga rezultatet e ndërhyrjes së hershme të suksesshme është lehtësimi i rrugës për në mjediset e arsimit gjithëpërfshirës (Organizata Botërore e Shëndetësisë & UNICEF, 2012), e cila duhet të jetë e gatshme të mirëpres dhe të mbështes të gjithë nxënësit.

Prindërit, në të shumtën e rasteve, kanë mundësinë të zgjedhin se në cilën shkollë fëmija i tyre të vijojë mësimin, mirëpo ata nuk janë gjithmonë në gjendje të marrin vendime duke u bazuar në informacion të saktë dhe këshilla profesionale (Wilder & Lillvist, 2017). Prandaj, është shumë e rëndësishme që stafi profesional brenda shkollës të mbështes prindërit në këtë drejtim. Kjo mbështetje mund të përfshijë inkurajimin e familjeve për të bërë vizita fillestare në shkollë, duke patur si mbështetje ndonjë figurë e cila i njej proceset dhe të drejtat e një personi me aftësi të kufizuar.

Tranzicioni përfshinë fëmijën, familjen dhe institucionin arsimor. Secila nga këto duhet të merret parasysh. Familjet duhet të mbështeten në shqetësimet e tyre për fëmijën e tyre dhe të vlerësohen për përvojën që sjellin. Familjet gjithashtu mund të kenë shqetësime për ndikimin në familje që mund të kenë krijimi i marrëdhënive dhe rutina me shkollën e re. Vëmendja për ndërtimin e bashkëpunimit të mirë me të gjithë të përfshirët është e rëndësishme për tranzicion të lehtë në arsim. Kërkimet nxjerrin në pah vlerën e një lehtësuesi, një zyrtari të caktuar shkollor, për të mbështetur familjen të paktën vitin e parë të tranzicionit në shkollë. Shkollat nuk duhet të vendosin kërkesa arbitrare të tranzicionit për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, siç është frekuentimi gjysmë ditor, duke lejuar ndjekjen e mësimi vetëm kur është i pranishëm mësuesi mbështetës ose pjesëmarrja vetëm në disa ditë të javës, këto praktika janë një formë e përjashtimit dhe jo e githëpërfshirjes.

2.5 Shkolla

Mjedisi i dytë më i rëndësishëm në jetën e një fëmije pas familjes është shkolla. Siç u përmend më parë, provat për përfitime të shumta nga arsimi në mjediset gjithëpërfshirëse janë të qarta. Sidoqoftë, përvojat e arsimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkolla të sistemit të rregullt nuk janë gjithmonë të mira dhe kjo mund të çojë në tendosje të madhe të familjeve, të cilat mund të marrin vendim për arsimim të fëmijës së tyre në një mjedis të veçantë. Praktikata e dobëta të gjithëpërfshirjes nuk duhet t'i detyrojnë familjet të zgjedhin mjedise veçuese, e domosdoshme është të përmirësojmë cilësinë e arsimit gjithëpërfshirës.

Përgjatë mësimdhënies kërkohet qasje kreative, prej të cilës përveç nxënësve me sindromë Down mund të përfitojnë edhe nxënësit e tjerë në klasë. Strategjitë e mëposhtme janë mbështetëse për nxënësit me sindromë Down:

- ▶ vendosja dhe konstruktimi i situatave për mësim përmes imitimit;
- ▶ praktikimi ditor i shkathtësive të targetuara të cilat janë inkorporuar në aktivitetet e klasës;
- ▶ aktivitete të planifikuara të cilat janë bërë pjesë e rutinës së nxënësit;
- ▶ mbështetje për sjellje të përshtatshme dhe shoqërizim;
- ▶ përshtatshmëri në bazë të pikave të forta të mësimnxënies dhe mbështetje për fushat në të cilat ka vështirësi nxënësi;

3 Qasja dhe metodologjia pedagogjike

3.2 Qasja dhe teknika të përgjithshme pedagogjike

Në procesin mësimor, pavarësisht objektivave të caktuara, është e rëndësishme t'i kemi parasysh këto aspekte:

Raporti mësues – nxënës

Pranim i pakushtëzuar dhe vlerësim pozitiv – bashkëvepruesi ka vlerat e veta. Vlerat nuk janë rezultat i ndryshimeve, i të nxënës, i mbarëvajtjes së objektivave apo intervenimit tonë si mësues. Një mënyrë për të vënë në praktikë këtë qasje është kalimi i kohës së bashku, pa bërë plan që kjo kohë t'i dedikohet një aktiviteti konkret të planifikuar nga mësuesi.

Dëgjim aktiv – të mbash kontaktin me sy, të kërkosh konfirmim për atë që ka thënë nxënësi, përsëritje e fjalëve të shqiptuara nga tjetri.

Njohje – të shfaqësh interesim për tjetrin, ta pyesësh për gjërat jashtë shkollës të cilat i pëlqejnë...si dhe mirëkuptim, empati.

Gatishmëri për të ndihmuar dhe për të ofruar asistim përmes aktiviteteve të përditshme, përsëritëse dhe të planifikuara (rutinat e planifikuara krijojnë siguri më të madhe dhe në shumë raste janë shumë të nevojshme) të cilat duhet të jenë të strukturuar, të dakorduara dhe të ndara (nxënësi ka nevoj të punoj së bashku me mësuesin për të arritur objektivat).

Nganjëherë mund të jetë e dobishme të ri-përcaktoni objektivat së bashku me nxënësin për të rritur motivimin e tij.

Vetëvlerësimi, identiteti dhe vetëbesimi

Është e rëndësishme të përdoren fjalë motivuese, inkurajuese çdo herë kur nxënësi arrinë edhe objektivat me të vogla, duke theksuar sforcimet e bëra për të arritur këtë sukses. Edhe në rastet kur nuk arrihen objektivat është e nevojshme të jepen mesazhe pozitive, duke reflektuar së bashku me nxënësin për aftësitë personale që është duke i zhvilluar. Nëse aktivitetet shtjellohen me qëllimin e përfitimit, vetëvlerësimi do të rritet, me të do të rritet edhe vullneti për punë të pavarur, motivimi, kureshtja dhe interesimi. Aktivitetet duhet të jenë edhe një ndihmesë në procesin e zhvillimit të një autonomie për të dy pjesëmarrësit përgjatë ndërveprimit: ndihmojmë tjetrin, e tjetri na ndihmon të zhvillojmë identitetin tonë, duke na mundësuar kështu t'i përgjigjemi pyetjes "Kush jam?". Në këtë kuptim, është e rëndësishme të respektohen kufijet dhe zgjedhjet e tjetrit, parimi i mos-imponimit dhe detyra për të ndihmuar bashkëfolësin në zhvillim të autonomisë së tij. Një nxënës me nevoja të veçanta arsimore ka nevoj të ketë një mësues i cili ka një plan të qartë dhe është në gjendje ta prezentoj siç duhet. Veprimet e mësuesit duhet të nxisin tek nxënësi një besim më

të madh tek vetja, të ja ngris vetëdijen e rrezikut në kushte të sigurisë. Do të jetë e nevojshme të krijohet një bazë e sigurtë, nga e cila nxënësi do të mund të eksploroj territore të reja dhe të përballoj rreziqet, duke patur sigurinë se do të rigjej një vend të sigurtë.

Konteksti i gjithëpërfshirjes

Parakusht thelbësor për gjithëpërfshirjen është të bëni nxënësin me nevoja të veçanta arsimore të ndihet "i pranuar" brenda klasës. Nëse brenda klasës nuk është një klimë gjithëpërfshirëse, pavarësisht dallimeve individuale, nuk ka kuptim të synohet arritja e objektivave si dhe të përgatitet mjedisi në bazë të nevojave të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Të merren parasysh këto aspekte sa i përket gjithëpërfshirjes:

1. Nxënësi me nevoja të veçanta arsimore të qëndroj sa më gjatë brenda klasës;
2. Nxënësi me nevoja të veçanta arsimore të merr pjesë sa më shumë që të jetë e mundur në aktivitetet e klasës;
3. Nxënësi me nevoja të veçanta arsimore, sa më shumë që të jetë e mundur, duhet të gëzojë të njëjtat kushte arsimore që gëzojnë nxënësit e tjerë;
4. Mësuesit mbështetës më të mirë për të janë shokët/shoqet e klasës;

Plotësimi i këtyre kriterve bën që grupi i klasës të transformohet në një faktor ndihmës dhe burim i arritjeve për nxënësin me nevoja të veçanta arsimore.

Përdorimi i ndërmjetësuesve didaktik

Ndërmjetësuesit didaktik janë masat që ndërmerr mësuesi për të stimuluar të nxënit. Termi *ndërmjetësues* rrjedhë nga funksioni i tyre: gjenden mes mjedisit dhe individit për të lehtësuar të nxënit. Ekzistojnë katër tipe të ndërmjetësuesve:

- ▶ Ndërmjetësuesit aktiv – bazohen në përvojë direkte. Një shembull i një ndërmjetësuesi aktiv është eksperimenti i bërë në laborator.
- ▶ Ndërmjetësuesit ikonik – bazohen në paraqitjen figurative dhe të veçantë të gjuhës (imazhet, hartat konceptuale, fotografitë, video, harta gjeografike). Të nxënit përmes fotografive bazohen në aftësitë sensorike të individit. Pavarësisht se kanë shumë përparësi sa i përket interesimit dhe motivimit të nxënësit, ndërmjetësuesit ikonik nuk mund të konsiderohen komplet të vet-mjaftueshëm, por e kanë të nevojshëm shoqërimin me ndërmejtësues simbolik. Fjalori grafik, në të shumtën e rasteve, nuk është në gjendje të shpjegoj saktësisht domethënien e një koncepti. Shumë shpesh është i kufizuar dhe i vështirë për ta memorizuar.

- ▶ Ndërmjetësuesit analogjik – bazohen në mundësitë e të nxëniet që jep loja dhe stimulimi. Bëhet fjalë për lojëra në të cilën pjesëmarrësit riprodhojnë situata specifike dhe interpretojnë personazhe të ndryshme.
- ▶ Ndërmjetësuesit simbolik – janë ata, që në shumë raste, distancohen nga konteksti bazë dhe konsiderohen më pak valid, sidomos sa i përket mbështetjes së mësimnxënies direkte. Mësimi ballor është një shembull i ndërmjetësuesit simbolik. Në terma të rezultateve është qasja më pak efektive, për shkak të pasivitetit që krijon tek nxënësi. Sidoqoftë në terma kohor është ndërmjetësuesi që merr më pak kohë dhe pikërisht për këtë është ndër të preferuarit e shumicës së mësuesve.

Teknikat specifike të mësimdhënies

- ▶ Teknika e bazuara në alternim – kalimi nga aktivitetet “me nivel të lartë të rrezikut për gabim” në aktivitete në të cilat nxënësi mund të përgjigjet saktë pa nevojë për ndihmë (aktivitete “me nivel të ulët të rrezikut për gabim”) mundëson mbajtjen e vëmendjes së nxënësit, gatishmërinë e tij dhe bashkëpunimin përgjatë orës mësimore. Për shembull, kur bën hyrjen sa i përket një koncepti matematikor, mund ta ndash kohën që ke në dy pjesë. Në pjesën e parë mund të japësh detyrë nxënësve në lidhje me temën që sapo ke shpjeguar, me mundësi të larta gabimi, ndërsa në pjesën e dytë mund t’u japësh një detyrë që ka të bëjë me temën e cila paraqet nivel të ulët për gabim.
- ▶ Teknika e përsëritjes së përgjigjes- kur nxënësi i përgjigjet në mënyrë spontane dhe të saktë një pyetjeje me nivel të lartë për gabim, mund të stimulohet të përsërisë të njëjtën përgjigje, në mënyrë që të marrë informacion çdoherë e më të saktë. Duke bërë të njëjtën pyetje dhe duke kërkuar të njëjtën përgjigje, thellojmë dhe lehtësojmë më shumë memorizimin e përmbajtjes.
- ▶ Teknika stimul-përsëritje – bëhet fjalë për një teknikë të veçantë të prezentimit të stimullit kritik dhe diskriminativ. Aplikimi i kësaj teknike na mundëson reduktimin e gabimeve si pasojë e shpërqendrimit dhe implusivitetit të lartë për tu përgjigjur; për më shumë stimulon një formë të vëmendjes selektive dhe më të gjatë, pozitive për procesin e mësimnxënies. Për shembull, nëse detyra e kërkon të mbledh dhjetë euro duke përdorur monedhat dhe kartmonedhat, para se të filloni, mësuesi do të thotë dhe do të përsërisë: “gjeni dhjetë...dhjetë euro...euro...kuptuat? dhjetë euro”, më pas pyesni nxënësin: “çfarë duhet të kërkojë?”, duke nxitur vëmendjen drejt kërkesës.
- ▶ Teknika e të vënit në pah – konsiston në ekzagjerim të elementeve karakterizues të stimullit, duke vënë theksin në ato elemente të duhura për mësimnxënie diskriminative. Për më shumë, sugjerimi duhet të jetë i inkorporuar në stimul, në mënyrë që të dallojë nga një sugjerim shtesë (p.sh., udhëzime verbale përmes të cilave ndihma nuk është direkt e lidhur me stimulin). Sugjerimi brenda stimullit mundëson një reduktim të ngadalshëm dhe gradual. Për shembull, nëse objektivi i aktivitetit është të bëjë dallimin mes simboleve “më i madh” (>)

dhe “më i vogël” (<), ku elementi karakteristik është këndi i ngushtë kthyer në të majtë ose në të djathtë, kjo karakteristikë mund të theksohet me ngjyra të ndryshme (përfshirë sugjerimin që përmban stimuli).

- ▶ Teknika bazuar në sugjerimin e vonuar – kjo teknikë ka të bëjë me momentin e prezentimit të sugjerimeve të cilat në fazën fillestare jepen njëkohësisht me pyetjen dhe më pas prezentohen disa sekonda më vonë. Për shembull, gjatë orës së gjeografisë, nxënësi mund të gaboj gjatë identifikimit të një shteti në hartë. Mësuesi përsëritë “Çfarë vendi është? Franca” (pyetja dhe sugjerimi bëhen në të njëjtën kohë, duke eliminuar kështu rrezikun për gabim). Në testimin e mëpasshëm, mësuesi e jep sugjerimin të pakën 4 sekonda më vonë. Sapo nxënësi të përgjigjet saktë në këtë interval kohor, më nuk jepen sugjerime, por shpërblim final. Në rast se nxënësi nuk do të përgjigjet, përgjigja e saktë do t’i sugjerohet. Në rast se nxënësi do të përgjigjet gabim përgjatë kohës prej 4 sekondash, mësuesi do të përsërisë të njëjtën detyrë duke prezentuar menjëherë sugjerimin.
- ▶ Demonstrim fizik me reduktim progresiv – kjo teknikë konsiston në prezentim të udhëzimeve orale, duke demonstruar veprimin e kërkuar dhe duke udhëzuar fizikisht nxënësin drejt përgjigjes së saktë. Asistimi fizik duhet të reduktohet gradualisht, në bazë të progresit të arritur nga nxënësi. Ndihma fizike do të reduktohet gradualisht kur nxënësi dëshmon të ketë përvetësuar shkathtësitë e duhura.
- ▶ Modeli për ta imituar – demonstrimi i aftësive dhe i mësimnxënies bazuar në imitim. Për shembull: gjatë orës së kimisë në laborator, nxënësi duhet të mësojë të përgatisë xhamin për vëzhgim në mikroskop. Fillimisht mësuesi do të ia demonstroj nxënësit se si ta bëjë, i cili fillimisht do të ketë rolin e vëzhguesit. Në përfundim të kësaj faze, do të jetë nxënësi ai që do të realizoj këtë procedurë.
- ▶ Loja e rolit – recitim dhe stimulim në një lojë rolesh. Nëse përgjatë lëndës së Edukatës Qytetare prezentohet funksioni i parlamentit, nxënësi dhe shokët e tij, në përfundim të ligjërimit, të nxiten për të imituar parlamentin dhe gjoja aprovimin e një ligji.
- ▶ Dhënia e sqarimeve (Feedback) – informacione të dhëna pas përfundimit të një testi, në lidhje me saktësinë dhe korrektësinë e ekzekutimit të detyrës. Mësuesi do të jap informata në lidhje me detyrën e zgjidhur, duke dhënë sugjerime, komente dhe nëse është e nevojshme, mënyra të ndryshme të përfundimit (lëvdata).
- ▶ Përgjithësimi – ose thënë ndryshe aplikimi i aftësive të fituara në kontekste të ndryshme. Për shembull, nëse një nxënës ka mësuar të përdor llogaritësin për të kryer operacione aritmetike, mund të përdor aftësinë e arritur përgjatë blerjeve në supermarket p.sh., duke llogaritur shpenzimet e një feste me shokët bazuar në një buxhet të planifikuar. Ky aktivitet mund të strukturohet si një detyrë jashtë-shkollore.

Përdorimi i strategjive të të nxënësve përmes pjesëmarrjes së shokëve

- ▶ Ekzistojnë një seri metodash të mësimi alternativ në të cilën nxënësit luajnë rolin e lehtësuesit në proces të të nxënësve të shokëve. Mësimnxënja me ndihmë të shokëve mundëson përfshirjen aktive të nxënësve në procesin didaktik. Kjo nuk ndodh në rastet e metodave tradicionale, sidomos në rastet e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Forma më të njohura të mësimi të ndërmjetësuar nga shokët dhe më të përdorura është:
- ▶ Të nxënësve përmes bashkëpunimit i bazuar në punë të grupeve heterogjene, mbi ndërvarësinë pozitive dhe mbi njëjtat mundësi për arritje të suksesit për të gjithë pjesëmarrësit. Mjedisi edukativ që krijohet duhet të jetë gjithmonë në terma bashkëpunimi dhe asnjëherë garues. Aspektet praktike janë:
- ▶ Definimi i dimensioneve të grupit, kriteret e organizimit, kohëzgjatja e aktivitetit dhe kombinimet që do të përdoren përgjatë fazave të ndryshme. Nuk ekziston një dimension ideal por në përgjithësi të nxënësve përmes bashkëpunimit jep rezultate më të mira në grupe të vogla. Në përgjithësi, grupet e të nxënësve përmes bashkëpunimit kanë një numër komponentësh nisur nga 2 dhe 4.
- ▶ Organizimi hapësinor i klasës – anëtarët e çdo grupi duhet të jenë të vendosur ballë për ballë për të patur mundësi për t'i ndarë materialet, të mbajnë kontaktin me sy dhe të komunikojnë në mënyrë të qetë, pa penguar grupet e tjera.
- ▶ Asistimi mes kolegëve është një metodë e bazuar mbi bashkëpunimin mes nxënësve “mësues” (tutor) që angazhohen me nxënës “nxënës”, me apo pa nevoja të veçanta arsimore. Tutorët nuk janë një zëvendësim i thjeshtë i mësuesve. Roli i tyre, në fakt, ua lejon të kenë përfitim të garantuar sikurse “nxënësve”. Tutorimi jep rezultate domethënëse jo vetëm në fushën akademike, por edhe në nivel të raporteve ndërpersonale, motivimit dhe vetëvlerësimit.
- Aspektet praktike për tutorim:
Të vendos “çfarë do të mësoj për lëndë, cilit nxënës, me çfarë objektivi, si, ku, kur dhe me çfarë frekuence”.
- Të definosh objektivat e projektit tënd, të shkruash në mënyrë të qartë dhe me terma profesional rezultatet që do të arrish dhe cilat sjellje të nxënësve duhet të jenë të modifikuara para përfundimit të projektit.
- Organizimi i grupeve – zakonisht grupet e nxënësve për të bërë tutorim ndahen në çifte (tutori dhe i asistuari) edhe pse nganjëherë kemi grupe të përbërë nga tre, katër apo 5 nxënës.

- Të zgjedhim momentin e dedikuar për tutoring: gjatë gjithë ditës, jashtë shkollës ose në momente të ndryshme të këtyre dy fazave.
- Të identifikosh fushat në të cilat do të realizosh projektin.
- Të caktosh zgjatjen e secilës fazë të tutorimit individual (të paktën 15 minuta), kohëzgjatja më frekvente përkon me 30 minuta.
- Të caktosh zgjatjen e projektit, e cila duhet të jetë e përcaktuar para fillimit të projektit. Është me rëndësi që tutori dhe i asistuari të dijnë që nga fillimi se në çka do të jenë të përfshirë dhe sa do të zgjasë aktivitetit.

Tutje, hulumtimet e bëra mbi tutorimin dëshmojnë që projektet afatshkurta garantojnë rezultate më të mira. Edhe pse ky aspekt mund të jetë i ndërlidhur me efektin e “ririsë”, mësuesit i japin rëndësi efektit “Hawthorne” (thënë ndryshe përdorimi i formave të reja të organizimit për të arritur qëllimet afatshkurta). Kohëzgjatja minimale e projektit është 6 muaj. Pas një kohe të shkurtër prove, do të ishte mirë të bëhej një vlerësim fillestar për të evidentuar përgjigjen e nxënësve, rezultatet e arritura, si dhe – në bazë të të dhënave – përmirësimin ose definimin e fazave të mëtejme. Këto forma të të nxënësve të ndërmjetësuar nga shokët e klasës arrijnë që të plotësojnë nevojat e gjithë nxënësve, pavarësisht performancës së tyre shkollore. Rezultatet e hulumtimeve tregojnë që, në raport me metodën tradicionale të mësimit, nxënësit arrijnë rezultate të mira në nivel kognitiv (punojnë me një intensitet më të madh, memorizojnë më mirë, zhvillojnë një nivel më të lartë të motivimit dhe aftësi të të menduarit më të avancuar), social (miqësi dhe respekt sa i përket dallimeve), psikologjik (përmirësim i perceptimit të vetvetës, të efikasitetit, të aftësive për të menaxhuar situatat e vështira dhe stresuese).

3.3 Përshtatja e objektivave të planit mësimor

Përshtatja e objektivave të klasës

Grupi i klasës dhe nxënësi me nevoja të veçanta arsimore duhet të adaptojnë një seri modifikimesh në mënyrë që të krijojnë mundësi bashkëpunimi dhe ndihmë reciproke, duke adaptuar objektivat e klasës përkitazi me nevojat e nxënësit me nevojat e veçanta arsimore, duke i mirëkuptuar përparësitë e kësaj çështje për të dy anët, duke promovuar bashkëpunimin brenda klasës, bashkëndarjen dhe gjithëpërfshirjen.

Për shembull, nëse një nxënës me nevoja të veçanta arsimore duhet të punoj mbi identifikimin e ngjyrave, do të jetë e mundur të planifikohet mësimi mbi spektrin diellor dhe mbi ngjyrat e ylberit, e nëse është duke i mësuar sekuencën lineare të numrave, klasa duhet të punoj mbi koordinatat karteziane ose dy drejtëza numerike.

Përshtatja e objektivave didaktike për nxënësin

Ekzistojnë 5 nivele të përshtatjes së objektivave në lidhje me shkallën e vështirësisë në të nxënë (nga ajo e shkallës së lehtë tek ajo e shkallës së thellë). Sekuenca e niveleve është përpunuar në bazë të parimit të parsimonias – mos të ndryshohet asgjë nëse nuk është e nevojshme; kurdo që duhet të bëhen ndryshime, të bëhen në minimumin e mundshëm.

- ▶ **Niveli 1 – Zëvendësim:** Objektivi nuk është lehtësuar, por modifikohet qasja në komunikim (gjuha e shenjave, regjistrime audio, përdorimi i kompjuterit për të përpunuar fjalë në vend të stilolapsave klasik, pyetje me përgjigje të shumëfishta në vend të atyre me përgjigje të hapur).
- ▶ **Niveli 2 – Ndihmë:** për të garantuar arritjen e objektivave, ofrojmë një ndihmë të shkallëzuar, të cilën e ndërprejmë kur e shohim që nuk është më e nevojshme.
- ▶ **Ndihma e parë:**
kontesktualizimi, puna në kontekstin e të nxënësit, detyra për t'i bërë në mjedise që lidhen me jetën e përditshme (p.sh., llogaritja e kusurit në supermarket), përdorimi i teknologjive në mënyrë që të rrisim nivelin e motivimit (p.sh., software edukativ), situata të të nxënësit të cilat janë ndërvepruese dhe operative (tutorim nga ana e shokëve, grupe të të nxënësit bashkëpunues, laboratore, stimulim, shëtitje).
- ▶ **Ndihma e dytë:**
lehtësoni menaxhimin e kohës dhe të hapësirës, definimi i periudhave të punës më të gjata për të arritur objektivat, më shumë modifikime të kontekstit, numër më të madh të pushimeve (pauzave), shmangni shpërqëndruesit, të kontrolloni ndriçimin etj.
Ndihma e tretë: të pasuron situatën didaktike me masa ndihmëse të ndryshme.
- ▶ **sugjerime dhe stimuj të finalizuar për të lehtësuar fazat e tjera të procesit (ngjyra, imazhe/fotografi, harta kognitive, shpjegime shpesh, ndihma të ndryshme për memorien etj.).**

Niveli 3 – Thjeshtëzimi: Thjeshtëzimi i leksikut redukton kompleksitetin e koncepteve, llogaritjet bëhen duke përdorur llogaritësin, kriteret për një ekzekutim të saktë të një detyre janë modifikuar (duke pranuar më shumë gabime dhe pasaktësi).

Niveli 4 – Copëzimi i njësive themelore: Në programin e mësimit, është e nevojshme të identifikohen njësitë themelore të disiplinës të cilat mund të transmetohen përmes objektivave të qasshme. Në këtë mënyrë do të jetë e mundur të përqëndroheni në proceset kognitive, në vend të nocioneve dhe aftësive në vete. Për shembull, në mësimet e gjeografisë, dallimi mes ndryshimeve natyrore dhe atyre që sjell njeriu mund të shpjegohet në mënyrë domethënëse por të qasshme, duke mbledhur fotografi të mjedisve natyrore dhe artefakte, dhe ta klasifikoni të gjithën në një karton.

Niveli i 5 – Pjesëmarrje në klimën e detyrës për ta zgjidhur: Ky intervenim i ofron nxënësit mundësinë për të jetuar klimën e detyrës që ka për të zgjidhur (emocione, sforcim kognitiv, rezultatet për të arritur etj). Në jetën e përditshme marrim pjesë në një numër të madh të situatave të këtij lloji, edhe pse nganjëherë nuk i kemi shkathtësitë e kërkuara. Ka çështje të cilat ne nuk i njohim mirë, por fakti që marrim pjesë në atë klimë na mundëson të zhvillojmë motivim personal. Në një klasë gjithëpërfshirëse, zënë vend dinamika të ngjashme.

Për ta përmbledhur, intervenimet e fazës së zëvendësimit janë të nevojshme, sidomos, kur ka vështirësi zhvillimore sensorike dhe/ose motorike. Niveli i thjeshtëzimit përdoret në ato raste kur vështirësia e zhvillimit nuk është e shkallës së thellë, janë specifike dhe i takojnë një sektori të mirë definuar. Sidoqoftë, kur problemet e kuptimit, përpunimit dhe të prodhimit janë të rënda, është e rëndësishme të aplikohen intervenime të ndryshme të thjeshtëzimit dhe në rastet kur vështirësia në të nxënë është e shkallës së thellë, na imponohet nevoja për të copëzuar lëndët në njësi bazë. Mësuesit mund të zgjedhin nivelin e thjeshtëzimit të objektivave më të përshtatura për nxënësin me nevoja të veçanta arsimore.

Nxënësit me sindromë Down kanë shkallë të ndryshme të aftësive dhe shkathtësive, aftësi të ndryshme në zhvillimin fizik dhe në sjellje. Vështirësitë e tyre në të nxënë rezultojnë nga mënyrat e ndryshme të të mësuarit dhe jo nga pengesa që ata kanë për të mësuar. Si rregull i përgjithshëm, nxënësit me sindromë Down kanë nevojë për aktivitete të cilat janë të mirë strukturuar dhe të renditura, ekspozimi me sasi të vogla informacioni të paraqitur në një kohë dhe një sistem të organizuar mirë. Mësuesit mund të përdorin disa teknika si më poshtë në klasat e tyre për të maksimizuar përvojën e nxënësve me sindromë Down në klasa gjithëpërfshirëse.

Fusha e ndërhyrjes	Profili i të nxënësve	Teknikat për mësim
Informacioni i dhënë në klasë dhe plani mësimor.	Nxënësi me sindromë Down është nxënës vizual.	<ul style="list-style-type: none"> - Përdor metoda të të mësuarit që përfshijnë grupime të objekteve. - Bashkoni figurat me fjalë të njëjta. - Prezantoheni informacionin vizualisht si p.sh me projektor, karta, postera, dërrasë të zezë.
	Vështirësi në përpunim të informacionit verbal. Vështirësi në mbamendje të udhëzimeve ose informacionit që është i përpunuar vetëm verbalisht.	Jepi kohë për të dhënë përgjigje.
	Më shumë kohë për të përvetësuar aftësitë e reja që kanë mësuar para se të mësojnë një aftësi tjetër të re. Ritëm më i ngadaltë i të nxënësve krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre.	<ul style="list-style-type: none"> -Caktoji më pak detyra në një faqe. - Jepi më shumë liri për të zgjedhur aktivitetet e tyre për në kohën e punës. - Nxite për të qenë i pavarur dhe të ketë vetëbesim duke balancuar nevojat zhvillimore dhe kronologjike si pritshmëri më të larta akademike që janë vendosur në klasë. - Kur prezanton një punë të pavarur përpiku ta ndash në segmente të vogla, p.sh ndaje një test në dy pjesë. - Jepi kohë shtesë për të përfunduar detyrat. - Reduktoi detyrat.

Përgatitja dhe metodat mësimore	Nxënësi me sindromë Down punon më mirë kur punohet me të individualisht ose në grupe të vogla.	- Shmangni grupet e mëdha dhe udhëzimet e gjata pasi këto janë më pak efektive për të.
	Punoni me mësues mbështetës që ata të jenë më efektiv në mësimnxënie.	Ndërkohë që mësuesit mbështetës mund të jenë efektiv, disa prindër mendojnë se ata mund ta izolojnë dhe dekurajojnë një nxënës në ndërveprimin me bashkëmoshatarët e tyre. Paraprakisht jepi mësuesit mbështetës planin mësimor për t'i dhënë atyre më shumë besim gjatë mësimdhënies, dhe tu lejojë atyre kohë për të zhvilluar idetë e tyre për materiale të përshtatshme praktike dhe zhvillimore.
	Udhëzimet ndihmëse nëpërmjet kompjuterit mund të jenë efektive për shkak se janë ndërvepruese dhe krijojnë besim në vetvete tek nxënësi.	Duhet të jeni të vetëdijshëm se disa nxënës mund të mos kenë koordinim të mirë të motorikës fine për të përdorur tastierën dhe mausin në mënyrë efektive. Mund të përdoren edhe mjetet përshtatëse ose ndihmëse, si psh., tastierat e përshtatura.

	Bashkëmoshatarët që kujdesen për ta mund të jenë efektive për mësimnxënien.	Nxënësit me sindromë Down mund të punojnë më shumë për të qenë të pavarur dhe të pranuar nga moshatarët e tyre.
	Komunikimi me prindërit është i nevojshëm për të patur sukses.	Përdorni fletore të përditshme për të komunikuar me prindërit.
Materialet që duhen përdorur	Materiale konkrete dhe të krijuara vetë janë më efektive për nxënësit me sindromë Down.	<ul style="list-style-type: none"> - Fletoret në përgjithësi nuk janë shumë efektive ose praktike. - Fletat dhe lapsat, kompjuteri dhe librat mësimorë janë më efektive. - Objektet e manipulueshme janë më të dobishme. - Përdorni materiale kreative dhe të krijuara vetë p.sh., hidhini një top të butë nxënësit që doni që t'ju përgjigjet një pyetje që i drejtoni. - Ndhimoheni nxënësin me ushtrime përpara se ai të shkruajë p.sh., luani me duar së bashku, bëni lëvizje të vështira të duarve drejt kompjuterit, bëni duart grusht dhe relaksohuni. - Duhet të keni libra të niveleve të ndryshme të vështirësive të të lexuarit në klasën tuaj. - Detyrat e shtëpisë janë shumë efektive: 1. për të informuar prindërit se

		<p>çfarë ka bërë në shkollë fëmija i tyre; 2. për të siguruar më shumë praktikim me konceptet themelore të mësuara.</p>
Tranzicioni		<p>Ndryshimi i vendit dhe i mësuesve të lëndëve të ndryshme mund të jenë shumë efektive për nxënësin me sindromë Down.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Një pushim në mes të orëve mund të lejojë një ndërveprim të vlefshëm social me moshatarët, si një ushtrim i mirë. - Kur nxënësit janë gati vetë ose me kërkesën tuaj, ata duhet të lejohen të ndryshojnë klasën në mënyrë të pavarur, të takojnë fëmijët e klasave të tjera dhe të kalojnë kohë të pavarur me moshatarët e tyre. - Nëse nxënësit kanë nevojë për asistencë ose ndihmë, është e preferueshme ta ndihmojë një bashkëmoshatarë i tij sesa stafi apo mësuesja që e asiston gjatë kohës së mësimt.
Vëmendja	<p>Vëmendja është shumë e rëndësishme për mësimin nxënie. Studiuesit kanë zhvilluar një teori me dy faza për vëmendjen:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Qëllimi në fëmijërinë e hershme është që vëmendja të arrihet për 15–20 minuta. Vëmendja mund të trajnohet. - Minimizoni stimujt

	<p>Faza 1. Aftësia për të marrë pjesë në një detyrë. Faza 2. Aftësia për të identifikuar një stimul të përshtatshëm për problemin.</p>	<p>shpërqëndruar.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kur të zgjidhni stimuluesin ose objektin motivues sigurohuni që të ketë dimensione të qarta dhe të dukshme nga dimensionet reale p.sh ngjyra, shkrimi, madhësia. - Përdorni nxitje, shenja dhe ndriçim për të tërhequr vëmendjen e nxënësve. - Përpuni të përdorni ngjyra dhe shkrime të ndryshme për një punë sa më efektive. - Mundohuni të eliminoni humbjen e vëmendjes duke vendosur sa më pak fotografi ose piktura në mur, apo sa më pak ushtrime në fletë. - Shmangni pozicionimin e nxënësit me sindromë Down pranë një dore, dritare ose afër vendeve ku ndjehen zhurmat e rrugës apo makinave. - Jepini në mënyrë të menjëhershme reagimin apo shpërblimin tuaj për ta siguruar se po shpërblehen për përpjekjet e tyre.
<p>Vështirësitë ndijore/motorike</p>	<p>Nxënësit me sindromë Down kanë vështirësi në përpunimin e informacionit nga shumë burime në të njëjtën kohë, kanë vështirësi për të bërë shumë gjëra në të</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Mundohuni të përqëndroheni në një gjë të caktuar për një pjesë të kohës ose/dhe për një kohë të caktuar përqëndrohuni vetëm në një detyrë tjetër.

	<p>njëjtën kohë dhe për tu përgjigjur shpejt në disa situata.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgoje nxënësin kur i jep një udhëzim ose kur i kërkon të bëjë diçka, dhe shikoje nga larg sesi ai po e kryen kërkesën që i ke dhënë. - Nxënësi mund të mos jetë në gjendje të ulet vetë, përdorni një karrige ose mbështetëse. - Sigurohuni që nxënësi të ulet në një tavolinë të përshtatshme për gjatësinë e trupit të tij, me këmbët mbështetur dhe në një kënd 45 gradë dhe me të ndenjura plotësisht të mbështetura.
<p>Kujtesa</p>	<p>Nxënësit me sindromë Down kanë kujtesë të dobët për tre arsye: 1. ata kanë vështirësi të kujtesës afatshkurtër për shkak të vonësës gjuhësore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorni karta të prekshme dhe situata verbale të kuptueshme. - Ndajeni informacionin në grupe të vogla dhe idetë transmetojani me sekuenca. - Çdo detyrë bëjani sa më interesante dhe me kuptim. - Mësoji mënyrën e të mësuarit nëpërmjet përsëritjes. - Jepi mundësinë për ti praktikuar gjërat e mësuara në kontekste të ndryshme. - Paraqiti modele të ndryshme dhe mësoji mënyra sa më efektive për ti mbajtur mend gjërat. - Përsëritja është çelësi i të mësuarit!

Përvetësimi i koncepteve

Tek nxënësit me sindromë Down mosha mendore nuk përputhet me moshën kronologjike, ata kanë një zhvillim mendor më të ngadaltë se mosha e tyre kronologjike.

Fillimisht ju duhet të kuptoni se në çfarë stadi të zhvillimit mendor është nxënësi në mënyrë që të përcaktoni si të përshtatni programin e tij mësimor dhe të shfrytëzoni pikat e tij të forta që ai të arrijë rezultatet e duhura në mësimnxënie.

Përvetësimi i koncepteve përshkruan dallimin mes zhvillimit mendor dhe moshës kronologjike.

2. ata kanë një sasi të kufizuar të strategjive të kujtesës.

3. ata kanë tendencë të jenë nxënës "jo aktiv" kur bëhet fjalë për kujtesën.

– Gjej mënyrën e duhur të të nxënët duke u bazuar tek zhvillimi mendor i nxënësit dhe jo tek mosha e tij kronologjike:

1. Faza sensomotorë: mjedisi përjetohet nëpërmjet elementeve shqisorë dhe motorikë. Nxënësi fillon të ndajë veten e tij nga pjesa tjetër e botës.

2. Faza përgatitore: Konceptet përvetësohen dhe klasifikohen me anë të gjuhës dhe mendimit. Nxënësit kujtojnë ngjarjet e kaluara dhe krijojnë pritshmëritë ose presin që ngjarjet të ndodhin sërish.

3. Operacionet konkrete: objektet janë të përcaktuara dhe klasifikohen sipas rëndësisë dhe aftësisë së nxënësit për t'i përdorur. Nxënësi e ka të nevojshme të manipulojë objektet për të zgjidhur një detyrë si dhe të arrijë të mësojë marrëdhënien shkak-pasojë.

4. Operacionet formale: Në këtë fazë zhvillohet arsyeja abstrakte. Nxënësit mund të arrijnë të lidhin konceptet mendore, të përdorin simbolet, të formulojnë një situatë të supozuar dhe të parashikojnë pasojat

		<p>ose një ngjarje.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në qoftë se nxënësi është në fazën konkrete të të mësuarit përdorni objekte dhe sende të tjera për ta ndihmuar me detyrat konceptuale. - Të mësuarit është në vazhdimësi. - Ndaji detyrat në pjesë të vogla dhe në sekuenca në mënyrë të vazhdueshme. - Nxënësi mbështetet mbi njohuritë që di. Përpara se të mësojë koncepte të reja, sigurohuni që ato që ka mësuar më parë t'i ketë të mësuar mirë në mënyrë që të mund t'i përdorë për të mësuar njohuritë e reja.
<p>Strategjitë ndërmjetësuese dhe të mësuarit nëpërmjet bashkimit të situatave ose objekteve</p>	<p>Të mësuarit me rend (serik) përshkruan mësimin e koncepteve nga shkaku A tek konkluzioni C: p.sh., " nëse e prek stufën, do të digjem". "Bashkimi i objekteve/ situatave" është aftësia për të lidhur konceptet, idetë dhe fjalët. "Strategjitë ndërmjetësuese" janë nxitja dhe dhënia e sinjalit në kohën e duhur. Duke marrë shembullin e mësipërm, nga koncepti A në konceptin B kemi "stufa është e nxehtë", dhe kalimi nga koncepti B në</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Për konceptet të cilat janë shumë abstrakte përcaktoni një ndërmjetës për situatën në mënyrë që të bëhet më e kuptueshme. - Përdorni materiale që për nxënësit janë të njohura dhe bëjnë kuptim. - Shkëpusni marrëdhëniet që fëmija mund të ketë vendosur vetëm me konceptet bazë si numrat, ngjyrat, format. - Ndajini aktivitetet nga më e thjeshta tek më e vështira. - Jepini më shumë kohë për tu përgjigjur.

	<p>C është "nëse unë prek një gjë të nxehtë, mund të më digjen duart".</p> <p>Nxënësit me sindromë Down kanë më shumë nevojë për ndihmë në mësimin e koncepteve abstrakte, por mund t'ua mësojmë duke i ndarë konceptet ose veprimet në hapa të vegjël dhe t'ua kombinojmë me situata të ndryshme dhe të kuptueshme për ta.</p> <p>2. ata kanë një sasi të kufizuar të strategjive të kujtesës.</p> <p>3. ata kanë tendencë të jenë nxënës "jo aktiv" kur bëhet fjalë për kujtesën.</p>	<p>– Verbalizoni dhe përsërisni ndërmjetësuesin që mund të jetë ndërmjet 2 koncepteve.</p>
Përgjithësimi (ose transferimi i njohurive)	<p>Përgjithësimi i referohet aftësisë për të aplikuar njohuritë apo aftësitë e fituara në mjedise apo situata të ndryshme.</p> <p>Mësueset referojnë se nxënësit me sindromë Down i harrojnë aftësitë e reja, prandaj për këtë kërkohet që t'i përsëriten vazhdimisht edhe aftësitë e mësuara më parë.</p>	<p>– Mësojini dhe praktikojini konceptet e reja në mjedise të ndryshme dhe përdorni materiale dhe individë të ndryshëm.</p> <p>– Nxirrni në pah ngjashmëritë dhe dallimet.</p> <p>– Materialet duhet të jenë të kuptueshme për nxënësin.</p> <p>– Përdorni shpjegime verbale.</p>
Motivimi	<p>Nxënësit me sindromë Down kanë nevojë për më shumë motivim dhe inkurajim sesa pjesa tjetër e nxënësve.</p> <p>Gjatë kohës së qëndrimit në klasë ata me shumë</p>	<p>– Jepini detyra që janë të përshtatshme për moshën mendore të nxënësit.</p> <p>– Materialet duhet të jenë me kuptim dhe të njohura për fëmijën.</p> <p>– Lejoje nxënësin në</p>

gjasa kanë marrë reagime të ndryshme negative nga më të rriturit, kritika të shpeshta ose korrigjime. Përpiquni t'i tregoni të kundërtën.

Ata kanë zhvilluar metoda të ndryshme përballje si psh., sjellje pasive, kanë zhvilluar shmangien për shkak të pafuqisë për të mësuar p.sh., ngrihen dhe presin që dikush tjetër të përgjigjet për ta.

vendosjen e rregullave në klasë ose në mënyrën e zhvillimit të mësimi.

- Përdorni fjalë pozitive dhe jo të ashpra p.sh., mos i thoni e ke bërë gabim por thuaj provoje dhe njëherë.

- Inkurajojeni të krijojnë miq si një shpërblim social.

- Shpërbleni punën e pavarur të nxënësit.

- Ndhimoheni nxënësin që të ruajë motivimin dhe të zhvillojë një sistem motivimi të brendshëm në mënyrë që motivimi i jashtëm të zbehet me kalimin e kohës.

3.4 LEXIMI

3.4.1 Aftësitë e të lexuarit tek fëmijët me sindromë Down

Në fazat e hershme të leximit, zakonisht fëmijët me sindromë Down mësojnë të lexojnë përmes qasjes logografike; leximi i fjalës nëpërmjet të pamurit ose modeleve të tyre vizuale. Më pas synohet të lexuarit përmes qasjes alfabetike ose fonologjike – të mësuarit përmes dëgjimit të tingullit dhe fillimi për të përdorur shkronjat/tingujt për t'i deshifruar apo ndarë fjalët në tinguj të ndarë në mënyrë që t'i lexoj dhe shqiptoj. Si nxënës të mirë vizual, fëmijët me sindromë Down arrijnë përparim të konsiderueshëm në njohje vizuale ose logografi dhe shpesh janë të gatshëm të krijojnë një fjalor vizual me fjalë, por kanë vështirësi për të kaluar në fazën alfabetike ose fonologjike, prandaj shpesh mbesin në strategjitë e memories vizive me qëllim që të ruajnë progresin e arritur në lexim.

Aftësia e të lexuarit dhe lavdërimi nga të tjerët rrisin vetëvlerësimin dhe një shkallë më të madhe pavarësie tek fëmijët me sindromë Down. Të lexuarit është me përfitim për të zhvilluar funksione dhe aftësi që kërkojnë një zhvillim personal, të jetës në komunitet, një karrierë dhe argëtim.

Mësuesit duhet të përpiqen që të përfshijnë udhëzime efektive për të lexuarit për pjesën e aftësive praktike dhe funksionale së bashku në programin e të lexuarit (Deutch Smith, 2006).

Më poshtë gjeni disa aftësi që mund të përgatisin nxënësin për të qenë i suksesshëm në procesin e të mësuarit të leximit:

Pjesëmarrja e përshtatshme- aftësia për të patur një sjellje të përshtatshme në një situatë të dhënë, p.sh., qëndrimi në tavolinë ose brenda një rrethi ose shikimi nga mësuesi/ja.

- ▶ Minimizoni shpërqëndrimet;
- ▶ Mësojini dhe praktikojini aftësitë e kërkuara;
- ▶ Uleni nxënësin me sindromë Down afër jush;

Diskriminimi vizual- aftësia e diferencimit ndërmjet objekteve në bazë të disa kritereve si ngjyra, forma dhe madhësia. Nxënësit duhet të jenë të aftësuar në kuptimin e koncepteve të njëjta dhe të ndryshme.

- ▶ Thjeshto zgjedhjet;
- ▶ Përdor materiale vizuale që të kenë kuptim si: foto ose mjete që i interesojnë nxënësve;
- ▶ Fillo me probleme të lehta dhe gradualisht rrisni nivelin e vështirësisë me kalimin e kohës;

Memoria- aftësia të rikujtosh tingujt dhe fjalët dhe imitimi i tyre spontanisht ose me kërkesë nga dikush. Nxënësit me sindromë Down piren të mësojnë me ngadalë se fëmijët me zhvillim tipik. Ata mund të harrojnë aftësi të mësuara më parë.

- ▶ Vendosi nxënësve muzikë dhe tinguj që i kanë dëgjuar më parë;
- ▶ Inkurajoni të këndojnë, të duartrokin apo të kërcëjnë;
- ▶ Përsërit lojrat, vjershat për fëmijë dhe këngët që t'i ndihmojnë me ruajtjen dhe përvetësimin e fjalorit;
- ▶ Kërko mënyra kreative që të ndërtosh fjalorin e nxënësve me fjalë kuptimplota;
- ▶ Përdor mënyrat vizuale si bashkëveprimi me fjalë apo gjeste;
- ▶ Përdor qasje taktile si: shkrimi dhe leximi i fjalëve në rërë ose pikturimi me gisht në fleta vizatimi ose në rërë;
- ▶ Përsërit udhëzimet ose ndaji në hapa më të vegjël kur vëren se nxënësi nuk po e kupton;
- ▶ Rikujto dhe praktikoj aftësitë e mësuara më parë;

Diskriminimi auditiv- aftësia për të identifikuar dhe diferencuar ndërmjet shumë zhurmave.

- ▶ Mësoji të bëhet një dëgjues i mirë;
- ▶ Përdor shenja vizuale dhe taktile (të prekshme);
- ▶ Përdor germëzimin për të përforcuar diskriminimin auditiv;

Gjithashtu, pritshmëritë e mësuesit, aftësitë, metodat dhe fleksibiliteti kontribuojnë në suksesin e përgjithshëm të nxënësit për të lexuar. Është e rëndësishme të themi se mundësitë për udhëzime për të mësuar leximin në klasa gjithëpërfshirëse janë të pafundme. Udhëzimet e përdorura për të lexuar mund të ndërliken apo të përdoren edhe me lëndë të tjera si matematika, lëndët shoqërore ose shkencore.

Strategji për në klasë:

1. Përdorni materiale dhe aktivitete që nxënësi me sindromë Down të jetë i interesuar dhe të jenë të përshtatshme për moshën e tij, p.sh., materialet që janë të përshtatshme për moshën e fëmijës duhet të reflektojnë rritjen dhe zhvillimin real të tij.
2. Zhvillo një plan mësimi që identifikon mundësitë që ka vetë fëmija për të lexuar gjatë kohës së qëndrimit në shkollë.
3. Përfshini pjesën vizuale dhe të prekshme gjatë mëimit.
4. Jepi mundësinë nxënësit të praktikohet.
5. Rikthejeni shpesh në konceptet e mësuara më parë për të nxitur mirëmbajtjen e tyre.
6. Mbani pritshmëri të larta për nxënësit tuaj me sindromë Down.

3.4.2 Leximi i hershëm dhe zhvillimi i të lexuarit

Nxënësit me sindromë Down shfaqin vonesa të konsiderueshme në zhvillimin gjuhësor dhe në përvetësimin gjuhësor krahasuar me aftësitë e tyre joverbale (Rondal & Bucklay, 2003). Problemet me dëgjimin, procesimi auditiv dhe vështirësia për të memorizuar mund të ndikojnë në vonesat gjuhësore dhe mund të prekin artikullimin. Prandaj është e vështirë për nxënësit me sindromë Down që të mësojnë të folurën verbale vetëm nëpërmjet të dëgjuarit.

Leximi i mundëson të mësojnë gjuhën nëpërmjet pamjes vizuale. Librat dhe tekstet e shtypura i japin nxënësve me sindromë Down sinjale të vazhdueshme. Si rrjedhojë nxënësit kanë më shumë kohë për të përpunuar informacionin dhe më shumë mundësi për të mësuar. Kur leximi fillohet në moshë të hershme 2-3 vjeç, nxënësit me sindromë Down janë në mënyrë të konsiderueshme më të avancuar në ligjëratë, në gjuhë, lexim dhe aftësi për të memorizuar gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës (Rondal & Bucklay, 2003). Prandaj është shumë e rëndësishme të fillohet leximi i hershëm përpara se fëmija të frekuentojë kopshtin ose sistemin parashkollor.

Ndërhyrja e hershme dhe strategjitë që duhet të përdoren në klasë:

- ▶ Ekspozojeni fëmijën me sa më shumë libra dhe lojëra me fjalë të shkruara që në moshë të hershme.
- ▶ Nxitini prindërit t'i lexojnë fëmijëve në mënyrë të vazhdueshme si pjesë e rutinës së përditshme të familjes.
- ▶ Nxitini fëmijët të dëgjojnë aktivisht.

Nevojiten disa aftësi paraprake të cilat janë:

- ▶ Të qëndrojnë ulur dhe të ketë interes për librin.
- ▶ Të tregojë figurat.
- ▶ Të kërkojë një libër dhe të lexojë në mënyrë të pavarur.
- ▶ Të mbajë një libër drejt përpara dhe ta lexojë nga e majta në të djathtë.
- ▶ Të parashikojë çfarë do ndodhë më vonë.
- ▶ Të përmbledh për çfarë flet libri.

3.4.3 Leximi logografik (leximi përmes pamjes vizuale)

Udhëzimet për të lexuarit tek fëmijët me sindromë Down zakonisht duhet të fillojnë me fjalë të shkruara ose aktivitete automatike të njohjes së fjalës. Kërkimet tregojnë se nxënësit e moshës parashkollore me sindromë Down mund të mësojnë leximin nëpërmjet pamjes vizuale njësoj si fëmijët e tjerë parashkollorë që nuk manifestojnë vështirësi në zhvillim (Appleton, Buckley & MacDonald, 2002). Nxënësit me sindromë Down mund të mësojnë të lexuarin nëpërmjet pamjes vizuale përpara se ata të mësojnë të komunikojnë verbalisht. Duke mësuar për të lexuar, ata janë në gjendje të zgjerojnë aftësitë e gjuhës së shprehur dhe gjuhës së kuptuar.

Udhëzimet e të mësuarit të fjalëve nëpërmjet mësimin vizual përfshijnë të mësuarin e lidhjes nëpërmjet një fjale dhe idesë që ajo fjalë përfaqëson, p.sh., bashko fjalën "molla" me një figurë ku është e paraqitur molla. Fjalët e mësuara me pamje vizuale duhet të jenë të kuptueshme dhe lehtësisht të përdorshme për fëmijën. Filloni me fjalë dhe koncepte të cilat fëmija i kupton. Gradualisht përfshijni fjalët në fjali dhe nxiteni fëmijën të përsërisë fjalët dhe fjalinë.

Strategjitë në klasë për leximin përmes pamjes vizuale:

- ▶ Herë pas here jepini si detyrë nxënësit që të kombinojë fjalët e mësuara më parë në fjali të shkurtra me dy-tre fjalë.
- ▶ Me fjalët dhe fjalitë që ata po mësojnë krijoni një libër dhe jepja që ta lexojë shumë shpesh (Copeland & Calhoon, 2007).
- ▶ Bëni lojëra ku të përdoren fjalët që ka mësuar.
- ▶ Praktikoni fjalët e mësuara në mjedise të ndryshme. Të mësuarit nëpërmjet pamjes vizuale në pjesën më të madhe të rasteve bëhet nëpërmjet kartave dhe i duhen dhënë shumë mundësi që të praktikohet. Vendosini nga një tabelë sendeve dhe objekteve që janë në klasë në mënyrë që të përsërisë fjalët e vendosura.
- ▶ Formoni fjali që të përmbajë fjalën në figurë dhe jepi si detyrë nxënësit që të krijojë një fjali tjetër me po të njëjtën fjalë.
- ▶ Mësojini se si të përdorin fjalët lidhëse: dhe, ose, por etj.
- ▶ Mësojeni të lidhë fjalët me figurën dhe të krijojë fjali, të kuptojë sekuencat dhe të parashikojë situata. Po ashtu të fillojë të përdorë fjalë të tjera si: mua më pëlqen.... Ose dua një...

Metodat e të mësuarit të emrave të objekteve që shikon

- ✿ *Lidh fjalët me figurat* – Kjo është teknika më e përhapur për mësimin e fjalëve. Ka evidenca që tregojnë se nxënësit lidhin më mirë objektin me një fjalë të artikuluar sesa me fjalën e shkruar (Copeland & Calhoon, 2007). Gradualisht lidhim fjalën e shkruar me objektin dhe më pas dalëngadalë largojmë figurat dhe lëmë vetëm fjalët. Kur nxënësi të arrijë të bashkojë fjalët me objektet, kalojmë në bashkimin e fjalëve të njëjta. Filloni me 2-4 fjalë të cilat janë të njohura për fëmijën dhe me kuptim për të.

✿ *Bashko, përzgjidh dhe emërto*

Hapi 1: Bashkimi i fjalëve të njëjta

Hapi 2: Përgjedhja e fjalëve duke ja kërkuar, p.sh., “më jep lulen”.

Hapi 3: Emërtimi, p.sh., merr një kartë dhe pyete :“çfarë është shkruar këtu?”

Fillo me dy-tre fjalë që i njeh mirë dhe shto fjalë të reja herë pas here.

✿ *Kopjo, mbulo dhe krahaso*

Nxënësit i jepet një letër e ndarë në tre pjesë. Në pjesën e parë ndodhet fjala. Në pjesën e dytë fjala është e ndarë në rrokje dhe pjesa e tretë lihet zbrazët. Pasi nxënësi sheh fjalën tek pjesa e parë nxitet që të lexojë fjalën e ndarë në rrokje tek pjesa e dytë. Pasi nxënësit të mësojë të shkruajë fjalën e gërmëzuar duke e kopjuar mbulohet me një letër tjetër pjesa e parë dhe dytë e letrës dhe në pjesën e tretë nxënësi duhet të shkruajë fjalën që ka memorizuar, gjithmonë duke e parë figurën e objektit. Në fund letra hiqet dhe nxënësi dhe mësuesi krahasojnë punën e bërë.

✿ *Nxitja e përgjigjeve*

I referohet ndihmës që mësuesi i jep nxënësit që ai të përgjigjet saktë (Copeland & Calhoon, 2007). “Zhvendosja progresive e kohës” është një tjetër metodë e përdorur për nxitjen ndaj përgjigjeve. Herë pas here nxitet nxënësi që të japë një përgjigje të caktuar të saktë dhe gradualisht kjo ndihmë zbehet dhe duke praktikuar nxënësi nuk ka më nevojë për ndihmën që të japi përgjigjen e duhur.

Ndërkohë që fjalori i nxënësit pasurohet është e rëndësishme të inkorporojmë në këtë proces edhe kuptimin e fjalëve. Ky proces përforcon të mësuarin dhe siguron që nxënësi njeh kuptimin e çdo fjale që lexon.

Strategjitë në klasë:

- ▶ Bëj pushime të vogla që të sigurohesh që nxënësi të ka kuptuar deri në atë moment p.sh., bëji pyetje, kërkoji përmbledhje të ngjarjes, kërkoji që ta parashikojë ai se si vazhdon ngjarja dhe qartësoja gjërat që ai nuk i ka kuptuar.
- ▶ Nxite nxënësin të bëjë pyetje kur nuk di diçka.
- ▶ Nxënësit më të rritur nxiti më pak dhe përdor fjalë kyçe. Kjo gjë i ndihmon ata të përforcojnë aftësinë për të kërkuar ndihmë kur diçka nuk e kuptojnë.

3.4.4 Të mësuarit e shkronjave

Alfabeti është lidhja e shkronjës me tingullin. Mësimi i artikulimit të shkronjave e ndihmon nxënësin të formojë edhe fjalë të panjohura (Copeland & Calhoun, 2007). Artikulimi mund të jetë i vështirë për nxënësit me sindromë Down sepse përgjithësisht kanë vështirësi të memories auditive dhe mund të kenë probleme në dëgjim dhe dallimin midis tingujve. Shumë nxënës me sindromë Down i arrijnë aftësitë e tyre të të lexuarit të shkronjave kur arrijnë moshën e zhvillimit sa një 7 ose 8 vjeçar me zhvillim tipik ose kur nxënësi arrinë të lexojë përmes pamjes vizuale mbi 50 fjalë.

Janë dy metoda të mëimit të fonemave: fonemat analitike/implicite dhe fonemat sintetike/eksplicite. Fonemat analitike/implicite kanë në fokus të analizimit të shkronjave dhe tingujve brenda fjalëve të njohura për të. Nxënësi do të shohë të gjithë fjalën dhe më pas të analizojë çdo tingull dhe shkronjë. Fonemat sintetike/eksplicite kanë në fokus të mësuarin e izoluar të marrëdhënies ndërmjet shkronjës dhe tingullit.

Strategjitë në klasë:

- ▶ Shfrytëzo mundësitë për praktika ditore.
- ▶ Përdor pjesën vizuale p.sh të shohë alfabetin në një linjë, nëpërmjet gjuhës së shenjave, nëpërmjet prekjes dhe mënyrën e artikulimit nëpërmjet lëvizjes së buzëve, dhëmbëve dhe gjuhës.
- ▶ Praktikohuni sa më shumë përpara pasqyrës.
- ▶ Përdorni edhe shqisat e tjera si p.sh., pyete çfarë forme merr goja ime kur them shkronjën <O>, ose çfarë tingulli dëgjon?
- ▶ Nxënësve më të rritur duhet t'u japësh çdo ditë për të shkruar sepse leximi dhe shkrimi janë të lidhur me njëra tjetrën. Shkrimi i jep mundësinë nxënësit të fillojë të memorizojë fjalët dhe të lexojë tekstin e shkruar disa herë. Pjesëmarrja në aktivitete ku përfshihet shkrimi e lejon nxënësin të zhvillojë një të kuptuar më të madh të fjalëve dhe përdorimit të tyre (Copeland, 2007). Shkrimi nuk do të thotë që nxënësi duhet të shkruajë me shkrim dore; ai mund të përdor simbole ose piktura.

Vlerësimi i progresit

Vlerësimi i progresit të nxënësit është thelbësor dhe duhet të fokusohet në pikat e suksesit dhe nevojat për ndryshim. Metodatat e standardizuara jo gjithmonë janë efektive me nxënësit me sindromë Down. Kështu që mësuesi duhet të përdor metoda alternative si p.sh të fokusohet vetëm tek një nxënës dhe të krahasojë arritjet e tij me pjesën tjetër të klasës, gjithashtu, të krahasojë nivelin e tij të tanishëm me atë të mëparshëm. Një nga metodatat për ta bërë këtë është krijimi i një dosjeje me gjithë të dhënat e fëmijës për të pasqyruar progresin e nxënësit dhe punën gjatë vitit shkollor.

Mësuesit duhet të kenë pritshmëri të larta për zhvillimin e nxënësit por duke e përshtatur me aftësitë e tij. Sigurohuni që modifikimet dhe thjeshtëzimet që i keni bërë pritshmërive gjatë rrugës të mos çenojnë arritjen e qëllimit final. Si përfundim bëje leximin të këndshëm. Qëllimi për të cilin ti e aftëson nxënësin në komunikim, gjuhë, lexim dhe shkrim është që ai të ndjehet i arrirë dhe të ketë një jetë sa më gjithëpërfshirëse.

3.5 SHKRIMI

Shkrimi është një proces kompleks që përfshinë shumë aftësi të lëvizjes dhe të koordinimit të syve dhe dorës, dhe është rezultat i procesve të përbashkëta motorike, sensoriale, perceptive dhe njohëse.

Vështirësitë që hasin fëmijët me sindromë Down në procesin e shkrimit janë:

- ▶ Radhitja e duhur e mendimeve, ngjarjeve dhe informacioneve;
- ▶ Radhitja e fjalëve sipas rendit gramatikor;
- ▶ Mbamendja e informacionit në mënyrë që ta shkruaj më pas;
- ▶ Marrja e shënimeve dhe diktimi;
- ▶ Kompletimi i detyrave të gjata të shkrimit;
- ▶ Përshkrimi i tekstit nga dërrasa e zezë;

Ndihmat vizuale, nxitjet dhe mjetet e tjera për regjistrim janë të domosdoshme për të nxitur zhvillimin e gjuhës, strukturën e fjalisë dhe memorien.

Inkurajoni shkrimin e pavarur sa më shumë të mundeni sesa përshkrimin e fjalëve. Nxisni fëmijën të shkruaj për një qëllim, për shembull, të shkruaj një letër, të shkruaj një libër dore për një tjetër fëmijë në moshë më të vogël.

Fëmijët me sindromë Down do të kenë nevojë për shumë mbështetje për ta bërë këtë mirëpo më me vlerë është të shkruaj një fjali në mënyrë të pavarur, sesa të përshkruaj një tekst të gjatë duke e kopjuar.

3.6 GJUHA DHE KOMUNIKIMI

3.6.1 Aftësitë e komunikimit tek nxënësi me sindromë Down

Komunikimi efektiv ka ndikim të madhë në zhvillimin e nxënësve me sindromë Down. Ndikon në aftësitë e tyre për të kontribuar si anëtarë të klasës apo komunitetit ku ata bëjnë pjesë. Nxënësit me sindromë Down ndihen mirë kur të tjerët vlerësojnë kush janë dhe çfarë kanë për të thënë. Aftësia dhe rrjedhshmëria në komunikimin verbal "do të përcaktojë në një masë të madhe mundësitë dhe opsionet e tyre në shoqëri" (Deutsch Smith, 2006). Fatkeqësisht, për shumë individë me sindromë Down vështirësia për të komunikuar më të tjerët, mund të ketë një efekt "shkatërrues" në aftësitë sociale dhe personale.

Shumë studime kanë vërtetuar se aftësitë e gjuhës së kuptuar tek individët me sindromë Down janë pothuajse gjithmonë më mirë sesa gjuha e tyre e shprehur, me fjalë të tjera, ato i kuptojnë mesazhet që i referohen atyre, por nuk mund të prodhojnë mesazhe të cilat i referohen kontekstit. Mësuesit mund të ndihmojnë nxënësit me sindromë Down të komunikojnë duke promovuar motivimin e duhur, duke mbajtur pritshmëri të larta dhe duke i lënë mundësinë kështu nxënësve me sindromë Down të kuptojnë se gjithë komunikimi është i vlefshëm "pasi kjo gjë është në rregull, ndërhyrja specifike dhe përkrahja mund të prodhojnë rezultate të shkëlqyeshme" (Downing, 1999).

3.6.2 Vlerësimi dhe planifikimi

Qëllimet duhet të jenë të arritshme, të matshme dhe kuptimplotë. Para përcaktimit të qëllimeve, megjithatë, ju duhet në fillim t'i përcaktoni ato që të jenë të kuptueshme nga aftësitë e fëmijës në komunikim, duke përfshirë sesa suksesshëm nxënësi bashkëvepron në klasë, ose në një kënd lojërash dhe në publik. Mësuesi duhet fillimisht të vlerësojë aftësitë e komunikimit duke lidhur gjuhën dhe të folurën e nxënësit për të kuptuar aftësitë e tij. Nxënësit me sindromë Down nuk përgjigjen mirë ndaj testeve të standardizuara, të cilat dështojnë t'u provojnë mësuesëve informacione praktike të cilat mund të përdoren si qëllime për ndërhyrje (Downing, 1999).

Mësuesit duhet të vlerësojnë përgjigjet e nxënësve kundrejt direktivave, komandave, pyetjeve dhe ndërveprimeve sociale. Përveç kësaj, mësuesit duhet të pyesin prindërit p.sh., për gjuhën e kuptuar në shtëpi dhe udhëzimet që nxënësi mund t'i kuptojë, ose të pyesin mësuesin mbështetës që të ndjekin të folurën dhe aftësitë e nxënësit për të ndjekur udhëzimet gjatë orëve të mësimit.

- Në çfarë shkalle është duke e përdorur komunikimin nxënësi p.sh., me anë të të folurës verbale, simboleve, gjeesteve, të shkruarit etj?
- A mundet nxënësi të nis vetë komunikimin me të tjerët?
- Si i përgjigjen të tjerët nxënësit?
- A mundet nxënësi të ruaj (të vazhdojë) bisedën me të tjerët?

3.6.3 Komunikimi i plotë

Komunikimi i plotë i referohet përdorimit të të gjitha mjeteve të nevojshme për të përcjellë informacionin. Kjo përfshin sinjalet, gjuhën e shenjave, ndihmat vizuale (fjalët e shkruara) ose pajisjet shtesë komunikuese për plotësimin e të folurit. Tek shumica e nxënësve do të zbehet përdorimi i sinjaleve dhe me kalimin e kohës ata do të përdorin produktin e tingullit dhe të fjalës.

Metodat e komunikimit të plotë dhe këshillat për në klasë

Nxitja me gjeeste

Nxitja me gjeeste është term i cili përdoret kur mësuesi ose terapeuti tregon (prek) gojën e tij/saj kur ai flet. Kjo bën që fëmija të jetë vigjilent për të parë gojën e personit që po flet kur ai modelon tingullin ose fjalën. Përdoret në fillim, kryesisht kur synohet të mësohen tinguj ose fjalë.

Nxënësi duhet fillimisht të përdorë "nxitjen me gjeeste" për të folur dhe të zbehë teknikën derisa ai të ndjehet i sigurt për të folur spontanisht.

Tregimi me gisht

Tregimi me gisht i referohet të përdorurit të gishtit në një kohë të caktuar për të modeluar sekuencën e tingujve, rrokjeve ose fjalëve. Kjo teknikë lajmëron nxënësin për të përshpejtuar ose për t'u ngadalësuar. Përdoret në fillim, kryesisht kur synohet të mësohen tinguj ose fjalë. Përmes përsëritjes, nxënësi mund të memorizojë sekuencën e saktë dhe të fitojë besimin për t'a përdorur atë në bisedë.

Nxënësi mund t'a përdorë tregimin me gisht për t'a ndihmuar atë për të artikuluar fjalë më shumë rrokje apo fjali të gjata.

Gjestet

Disa nga gjestet më të zakonshme janë të përshëndeturit, të treguarit me gisht ose simboli "ok". Nxënësi mund të lidhë këto gjeeste me të folurin për të ndihmuar dhe për t'u siguruar që ai është kuptuar.

Gjuha e shenjave

Gjuha e shenjave shërben për të ndërtuar gjuhën receptive dhe komunikimin e hershëm në mënyrë vizuale dhe mund të përdoret si një sistem komunikimi tranzitor derisa fëmija të komunikojë përmes fjalëve.

Shenjat mund të shoqërohen me fjalë verbale, kështu që kur nxënësi të këtë përvetësuar komunikimin verbal, shenjat duhet të fillojnë të zbehën.

Të lexuarit

Siç u diskutua dhe në kapitullin e të lexuarit, nxënësit me sindromë Down mësojnë vizualisht. Të lexuarit mund të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e të folurit dhe është shpesh një katalizator për rritjen e kuptueshmërisë dhe kohëzgjatjen e fjalive. Të lexuarit mund të nxisë një sugjerim vizual për të artikuluarin, ritmin dhe të përdorurit e fjalive më të gjata. Të

lexuarit mund të përmirësojë korrigjimin e fjalës, kujtesën dëgjimore dhe të vendosurin sipas rradhës (duke siguruar përsëritjen e nevojshme për të memorizuar dhe për të rikujtuar rendin e fjalisë dhe strukturën gramatikore e cila do të zgjasë fjalitë e tyre gjatë fjalimit), ritmin e fjalës dhe aftësinë për të ndjekur udhëzime.

Muzika

Muzika është me shumë vlerë për prodhimin e të folurit. Nuk është vetëm një motivues i fuqishëm për shumë nxënës me sindromë Down, por ajo rrit aftësinë e tyre për t'u fokusuar në stimuj dëgjimor (e cila është zakonisht një dobësi). Intonacioni dhe ritmi i muzikës japin sinjale për korrigjim, ndjekjen e rradhës dhe memorien. Kur nxënësit në mënyrë të përsëritur këndojnë këngën që pëlqejnë, ata po praktikojnë dhe shtojnë fjalorin e tyre perceptues dhe shprehës. Për nxënësit më të rinj, përdorni muzikën gjatë hapjes dhe mbylljes së ditës dhe gjatë rutinave të ditës. Nxënësit më të vjetër mund të përdorin himnin ose përhëndetjet ose të praktikojnë këngë për performanca sezonale.

Disa strategji të dobishme klase janë si më poshtë:

- ▶ Këndoni me ngadalë, dhe shqiptoni ose theksoni fjalët kyçe.
- ▶ Bashkoni fjalët me veprimet ose sinjale vizuale, psh., foto, kafshë pellushi.
- ▶ Zgjidhni këngë me fjalor kuptimplotë.
- ▶ Inkurajoni të ecurin me hapa me duartrokitje.
- ▶ Flisni për kuptimin e këngës.
- ▶ Përdorni sinjale.
- ▶ Përdorni muzikën në mënyrë kreative gjatë ndërrimit të orëve ose për të dhënë udhëzime.

Ju mund t'i mësoni nxënësve me sindromë Down strategji për t'a bërë komunikimin të duket më pak si punë dhe më shumë si lojë. Qëllimi i shumë prindërve është që fëmijët e tyre me sindromë Down të jenë të aftë të flasin dhe të krijojnë shoqëri me shokët e tyre të klasës; të kërkojnë ndihmë; të jenë pjesë e diskutimeve dhe aktiviteteve të klasës; të bëjnë prezantime; të komunikojnë nevojat e tyre, ndjenjat dhe idetë.

Qëllimi fillestar për klasën tënde duhet të jetë motivimi i nxënësve me sindromë Down për të folur në mënyrë spontane. Kjo mund të jetë e vështirë fillimisht, sepse ata duan kohë më të gjatë për t'iu përshtatur ndryshimeve dhe të mësojnë rutinat. Është e zakonshme për ata që të jenë të rezervuar kur bëhen pjesë e një grupi të ri. Nëse ata nuk ndjejnë besim për të folurën e tyre, ata mund të kenë tendencën për t'u mbyllur në vetvete.

Fokusohuni tek përpjekjet më shumë se tek rezultati. Lavdërimi dhe përfocuesit pozitiv janë mjete të fuqishme për nxënësit me sindromë Down. Ju mund të dalloni kur një nxënës po tregon përpjekje nëse ai kryen ndonjë nga kombinimet e mëposhtme:

- ▶ Fillon dhe mban kontakt me sy.
- ▶ Përballet me dëshirë me folësin.
- ▶ Shikon fytyrën e folësit me qëllim.
- ▶ Imiton fjalët e folësit dhe frazat në mënyrë spontane.
- ▶ Shfaqin krenari kur lavdërohen nga të tjerët, psh., buzëqesh, përplas duart.

Nxënësit me sindromë Down kanë nevojë për më shumë kohë, praktikë, konsistencë dhe përforsim për të mësuar aftësitë e komunikimit. Pranimi nga grupi është një motivues i madh për të gjithë nxënësit. Mësuesit mund të lehtësojnë këtë marrëdhënie për nxënësit me sindromë Down duke kultivuar tolerancë dhe të kuptuarit në klasë, gjithashtu duke refuzuar të lejojë ngacmimin ose imitim.

Përforsimi pozitiv është çelësi, pasi lavdërimi është më i fuqishëm kur ai është një kujtesë e asaj që nxënësi ka arritur, psh., "Më pëlqen mënyra si ti____" është më kuptimplote sesa "e folur e bukur". Kujtohuni që t'i bëni aktivitetet e të folurit argëtuese.

Synimi	Teknikat për në klasë
Fillon dhe ruan kontaktin me sy.	<ul style="list-style-type: none"> - Modeloni sjelljen që doni të shikoni duke u ulur në nivelin e nxënësit dhe filloni kontaktin me sy. - Përdorni nxitje ose sinjale, psh., "Më shiko mua," ose "mjekrën lart." - Përdorni mjete vizuale, psh., mbajeni objektin e bisedës deri në nivelin e fytyrës tuaj. - Prisni për nxënësin që të pushojë nga aktiviteti tjetër dhe jepni një sinjal vizual, psh., drejtojeni drejt syve tuaj.
Të ketë vëmendjen tek fytyra e folësit dhe për t'i përgjigjet sinjaleve vizuale ose auditive.	<ul style="list-style-type: none"> - Modeloni sjelljen që ju doni të shikoni, dhe mësojini klasës një "pozicion dëgjimi," psh., duart mbi gjunjë, mjekrën lart; ose "teknikat e dëgjimit," psh., "Ndalo, shiko, dëgjo" bashkë me gjeste vizuale. - Nisni kontaktin me sy me nxënësin dhe prisni për kontaktin me sy mbrapsht. - Përdorni strategji gjatë kohës së ndryshimit të objektit të punës, psh, ndryshim dritash. - Bëni përshtatjet p.sh., konsideroje vendosjen e nxënësit pranë personit që flet. - Përsërit udhëzimet.
Të ketë vëmendjen tek fytyra e folësit dhe për t'i përgjigjet sinjaleve vizuale ose auditive.	<ul style="list-style-type: none"> - Modeloni sjelljen që ju doni të shikoni, dhe mësojini klasës një "pozicion dëgjimi," psh., duart mbi gjunjë, mjekrën lart; ose "teknikat e dëgjimit," psh., "Ndalo, shiko, dëgjo" bashkë me gjeste vizuale. - Nisni kontaktin me sy me nxënësin dhe prisni për kontaktin me sy mbrapsht. - Përdorni strategji gjatë kohës së ndryshimit të objektit të punës, psh, ndryshim dritash. - Bëni përshtatjet p.sh., konsideroje vendosjen e nxënësit pranë personit që flet. - Përsërit udhëzimet.

<p>Të shikojë dhe të imitojë veprimet dhe fjalët e të tjerëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Modeloni sjelljen që ju doni të shikoni. - Përfshini shokët e klasës (atë më të afërmin me fëmijën) dhe kujtojini nxënësit me sindromë Down të ndjekë udhëzimet e shokëve p.sh., " Shiko shokun tënd. Çfarë duhet të bësh ti?" - Përforcojini imitimet spontane me anë të lavdërimit. - Përdorni këngë të shoqëruara me veprime. - Inkurajoni nxënësin kur ai pyet për sqarime. - Ripërsërit. - Përdorni shenja dhe kur të përdorni mjete vizuale, bëni që nxënësi të bëhet vetë korrigjues i punës së tij p.sh., "A i keni bërë të gjitha hapat?" - Kur jepni udhëzime, nxiteni fëmijën që të përsërisë ose të thotë atë që ju sapo thatë.
<p>Të ketë vëmendjen tek fytyra e folësit dhe për t'i përgjigjet sinjaleve vizuale ose auditive.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Modeloni sjelljen që ju doni të shihni duke krijuar fjalët dhe rutinat që ju doni të shihni në përshëndetjet e përditshme, dhe përdorini ato në kohën e duhur p.sh., përplasni duart ose bëni 'cake' dhe thoni "Tung, si je sot?" - Punoni me personelin e shkollës që të inkurajojnë përshëndetjet e përshtatshme p.sh., nëse ju i keni mësuar nxënësit të përshëndesë nëpërmjet të bërit "cake" atëherë nuk do të ishte e përshtatshme që të tjerët t'a përshëndesin atë duke e përqaftuar. - Mësojini nxënësit emrat e shokëve të tjerë të klasës duke përdorur metoda të ndryshme p.sh., një libër me foto të shokëve të klasës.
<p>Të ketë vëmendjen tek fytyra e folësit dhe për t'i përgjigjet sinjaleve vizuale ose auditive.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Modeloni sjelljen që dëshironi të shikoni, dhe mësoni sjelljen e të mbajturit të radhës në grupe të vogla, p.sh., "radha ime", "prit për radhën tënde", "ngrij dorën". - Përdorni sinjale, p.sh., bëjini thirrje nxënësit të mbaj radhën.

<p>Të zhvillojnë fjalorin për të rritur pjesëmarrjen në klasë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Shqyrtoni një grup fjalësh dhe jepjani prindërve një grup prej tyre për ta përforcuar në shtëpi. - Përdorni strategjitë vizuale, p.sh., listë fjalësh, fjalor personal. - Caktoni të lexuarit që ka lidhje me temën.
<p>Të kujtojnë fjalorin e mësuar më parë, kur sugjerohet.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorni nxitje, p.sh., "Më thuaj/trego mua", me tingull/pjesën e parë të fjalës, ose thoni fjalën pa tingull. - Përdorni sinjale ose shenja vizuale. - Përdorni fjalët e shoqëruara, p.sh., "Nuk është natë, është___." - Rimoni, p.sh., "Tingëllon si mace."
<p>Flisni qartë dhe kuptueshëm.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kujtojeni nxënësin që të flasë ngadalë ose argumentoni të folurin me shenja apo gjeste. - Kërkojini nxënësit të përsërisë veten. - Modeloni të folurin e ngadaltë dhe të qartë. - Përdorni metodat e të caktuarit të ritmit, p.sh., gishtat ose duartrokitjet.
<p>Zgjasni fjalitë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorni metodat e të caktuarit të ritmit, p.sh., thoni dhe duartrokisni "Unë dua të ha." - Përdorni sugjerime, p.sh., "Më thuaj më shumë/në një fjalë." - Përdorni nxitje, p.sh., "Dhe pastaj unë___." - Praktikoni dhe përsërisni. - Siguroni mjete vizuale, p.sh., modelet e fjalisë.
<p>Rregulloni volumnin e zërit dhe të folurit në mënyrë të përshtatshme në situata të ndryshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Modeloni sjelljen që ju doni të shihni. - Mësoni konceptet e të folurit me zë të ulët dhe të lartë p.sh., zëri "brenda" dhe "jashtë" në kontekste të ndryshme p.sh., në klasë, në pushim, në librari. - Përdorni shenjat ose nxitjet p.sh., vendoseni gishtin tek goja dhe thoni "Shhh...unë të dëgjoj" ose "Zërin brenda të lutem".

Flisni normalisht ose rrjedhshëm.	<ul style="list-style-type: none"> - Modeloni sjelljen që ju doni të shihni duke: (1) lejuar nxënësin të mbarojë së foluri; (2) t'i kushtoni vëmendje dhe të mbani kontaktin me sy gjatë kohës që ai është duke folur. - Inkurajoni aftësitë e kthimit të përgjigjeve dhe
Shprehni emocionet dhe ndjenjat.	<ul style="list-style-type: none"> - Modeloni sjelljen që ju doni të shihni duke përdorur fjalë "të ndjera" p.sh., "Oo ti dukesh i mërziur. Më trego përse?" - Sugjerojini nxënësve që të përdorin fjalë në vend që t'i shprehin emocionet përmes veprimeve. - Zgjidhni problemet p.sh., "Çfarë të ka mërziur ty? Çfarë mund të bësh herën tjetër?" - Përdorni aparate digjitale, p.sh., "karta (figura) me emocione"
Qëndro në temë gjatë bisedave sociale.	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorni sugjerime p.sh., "Përgjigju pyetjes" - Ridrejtoni komunikimin p.sh., "Ishe tek kjo pjesë...tani vazhdo.." - Përdorni shenja vizuale për të nisur bisedën. - Praktikoni dhe përsërisni një sërë pyetjesh sociale dhe përgjigje të përshtatshme sociale p.sh., "Si po ja kalon sot?", " Çfarë do të bësh këtë fundjavë?", "Çfarë muzike pëlqen?"

3.6.4 Gjuha dhe sjellja

Aftësitë për komunikim efektiv dhe sjelljet e përshtatshme sociale janë të ndërlidhura. Plani individual i arsimit duhet të adresoj pritshmëri sjellore sa i përket dëgjimit dhe vëmendjes sepse këto dy elemente janë thelbësore për zhvillimin e gjuhës. Nxënësit me sindromë Down mund të mësojnë shkathtësi sjellore kur udhëzohen në mënyrë të qartë dhe përforcohen vazhdimisht. Është shumë me rëndësi që mësuesit dhe prindërit të punojnë së bashku për çështjen e komunikimit dhe sjelljes, sepse problemet me këto do të ndikojnë negativisht në aftësitë e nxënësit për të mësuar dhe për të ndërvepruar me bashkëmoshatarët.

3.7 MATEMATIKA

3.7.1 Aftësitë matematikore tek nxënësit me sindromë Down

Aftësitë matematikore janë esenciale nga dita në ditë për pavarësinë e të jetuarit. Nxënësit kanë mësuar matematikën përmes aftësive bazë të cilat i referohen "mirëmbajtjes dhe zhvillimit personal, detyrave të shtëpisë dhe të jetës komunitare, punës dhe karrierës, aktiviteteve argëtuese dhe të udhëtuarit brenda komunitetit". Për shembull, udhëzimet matematikore do të përfshijnë gjërat më kryesore si të treguarit e kohës, të bërit e ndryshimeve, njohjen e monedhave etj.

Gjithsesi, shumë mësues kanë shfrytëzuar këtë qasje dhe kanë patur tendencën për të lehtësuar rëndësinë e koncepteve themelore të matematikës të cilat duhen mësuar, psh., në vend që nxënësit të mësojnë konceptet bazë të matematikës si, mbledhja, zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi, mësimi shpesh fokusohet në udhëzimet sesi të pjekim një tortë apo të mbjellim një pemë për të kuptuar konkretisht elementët e sipërpërmendur. Nxënësit me sindromë Down mund të mësojnë konceptet matematikore. Në fakt, të mësuarit e këtyre koncepteve mund të motivojnë nxënësit me sindromë Down për t'i aplikuar këto aftësi në situata të ndryshme jo vetëm të demonstruara në klasë por dhe më gjërë.

Mësuesit duhet të provojnë mundësinë e këtyre nxënësve për t'i praktikuar këto aftësi në situata të ndryshme për të promovuar të mësuarit e tyre deri në gjeneralizim. Është e rëndësishme për të ditur se vështirësitë në të mësuarit të matematikës shpesh pasqyrojnë një mungesë të të nxënësve, në vend të mungesës së aftësisë për të zotëruar konceptet matematikore.

3.7.2 Vlerësimi matematikor

Testet e standartizuara të vlerësimit jo gjithmonë ju tregojnë mësuesëve informacionin e plotë përsa i përket aftësive specifike që nxënësi ka ose që duhet të përvetësojë dhe as nuk tregojnë se cila metodë është më efektive për të. Mësuesit duhet të ndërmarrin hapa shtesë që të vlerësojnë performancën e nxënësit duke analizuar çdo nxënës në bazë të nevojave të tyre individuale:

- A është funksional formati i udhëzimeve të dhëna?
- A është nxënësi duke përvetësuar aftësitë në shkallën e duhur?
- A është nxënësi duke mirëmbajtur aftësitë e zotëruar më parë?
- A është nxënësi duke i aplikuar konceptet matematikore edhe në lëndë të tjera mësimore?

Pasi ka mbledhur informacionin e domosdoshëm, mësuesi mund të zhvillojë një program efektiv arsimimi individual që i adresohet nevojave të nxënësit. Plani i arsimimit duhet ndërtuar mbi pikat e forta dhe të zhvillohen strategji për të kapërcyer apo kompensuar pikat e dobëta.

3.7.3 Pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve me sindromë Down në matematikë

Nxënësit me sindromë Down mund të mësojnë matematikë në çdo moshë. Ato shpesh ndihmohen duke mësuar me metoda të cilat përfshijnë metodat kërkimore të bazuara në trajtimin e pikave të tyre të forta për shembull, të kuptuarit dhe bashkëveprimi social, procesimi vizual dhe memoria vizuale, përdorimin e gjeleve për të komunikuar dhe pikat e dobëta, psh., vonesat në aftësitë motore, vonesat në të folur, vështirësi në të dëgjuar dhe vështirësitë e kujtesës.

Vështirësitë dhe pikat e forta në listën e mëposhtme janë vëzhguar në shumë nxënës me sindromë Down. Është e rëndësishme për t'u theksuar se shumë nga nxënësit të cilët shfaqnin vështirësi ishin në gjendje për t'i kapërcyer apo kompensuar ato me udhëzimet e duhura (Martiney, 2002).

Pikat e forta	Pikat e dobëta
<p>Procesimi vizual- Nxënësit me sindromë Down mund të zgjidhin më mirë problemet dhe të ndjekin më mirë procedurën nëse informacioni prezantohet vizualisht.</p> <p>Strategjitë në klasë</p> <ul style="list-style-type: none">- Mësoje nxënësin që të skicojë problemet dhe të shkruajnë në mënyrë aritmetike zgjidhjen që vjen më pas.- Vizato një grafik/ tabelë/ pikturë.- Bëj një video hap-pas-hapi.- Përdor numrat rendor.	<p>Kujtesa - Nxënësit me sindromë Down shpesh kanë vështirësi me kujtesën afatshkurtër, procesimin dhe organizimin, krahas kujtesës afatgjatë. Ato mund të shfaqin vështirësi të të mësuarit përmendësh të koncepteve matematikore, p.sh., tabelat e shumëllojshme të fjalorit matematikor; të numëruarit mbrapsh; hapat e zgjidhjes së problemit. Gjithashtu ato mund të shfaqin mospërputhshmëri në konceptet e të mësuarit p.sh., "të harruarit" e aftësive që ato kanë mësuar një ditë më përpara".</p> <p>Strategjitë në klasë</p> <ul style="list-style-type: none">- Fillojeni çdo orë mësimi me një përsëritje të koncepteve që janë mësuar më parë.- Përdorni pyetje të drejtpërdrejta të gjërave që janë mësuar tashmë, për t'i kërkuar përgjigjet nga nxënësit. Kur është e përshtatshme, ofroni feedback

Praktika të bën perfekt- Praktika të çon në ruajtje të informacionit dhe sa më shumë praktikë (përsëritje) të çon në automatizimin. Në këtë pikë, aftësitë kërkojnë përpjekje më pak të vetëdijshme dhe kujtesa e punës bën përpunimin mendor gjatë kryerjeve të detyrave.

Strategjitë në klasë- Të praktikuarit e aftësive në kontekste të ndryshme dhe me llojllojshmëri materiale.

- Përdorni metoda të ndryshme për të përcaktuar mundësitë për mësimin e koncepteve matematikore jashtë klasës së matematikës.

- Praktika duhet të jetë argëtuese, e larmishme dhe e përshtatshme për jetën e përditshme.

Praktika të bën perfekt- Praktika të çon në ruajtje të informacionit dhe sa më shumë praktikë (përsëritje) të çon në automatizimin. Në këtë pikë, aftësitë kërkojnë përpjekje më pak të vetëdijshme dhe kujtesa e punës bën përpunimin mendor gjatë kryerjeve të detyrave.

Strategjitë në klasë

- Të praktikuarit e aftësive në kontekste të ndryshme dhe me llojllojshmëri materiale.

korrigjues për të nxitur performancën e nxënësve.

- Praktikoni konceptet që përmirësojnë rikthim e kujtesës dhe shumën e përpjekje për të përmbushur detyrat (Nye & Bird, 1996).

Procesimi i informacionit- Për shkak të vështirësive të procesimit dhe të të kujtuarit e informacionit, zgjidhja e ushtrimeve në kohën e duhur mund të jetë e vështirë për fëmijët me sindromë Down.

Strategjitë në klasë

- Përdorni pak artikuj dhe jepni pak më shumë kohë.

- Ripërsërisni udhëzimet në grup.

- Përdorni mjete vizuale.

- Praktikoni fjalorin dhe hapat matematikorë dhe ripërsërisni konceptet sa më shpesh.

- Kur prezantoni materiale të reja, fillimisht qartësoni qëllimet dhe objektivat kryesorë (Mastropieri & Scruggs, 2002).

Procesimi i informacionit- Për shkak të vështirësive të procesimit dhe të të kujtuarit e informacionit, zgjidhja e ushtrimeve në kohën e duhur mund të jetë e vështirë për fëmijët me sindromë Down.

Strategjitë në klasë- Përdorni pak artikuj dhe jepni pak më shumë kohë.

- Ripërsërisni udhëzimet në grup.

- Përdorni mjete vizuale.

- Praktikoni fjalorin dhe hapat matematikorë dhe ripërsërisni

- Përdorni metoda të ndryshme për të përcaktuar mundësitë për mësimin e koncepteve matematikore jashtë klasës së matematikës.
- Praktika duhet të jetë argëtuese, e larmishme dhe e përshtatshme për jetën e përditshme.

Përshtatjet sipas nxënësit

Strategjitë në klasë

- Jepni sa më pak detyra.
- Jepi më shumë kohë për realizimin e detyrave.
- Minimizoni zhurmat dhe shpërqëndrimet.
- Përdorni sa më shumë fjalë të interesit dhe përvojës së nxënësit.
- Shfrytëzoni materialet e prekshme gjatë të mësuarit, psh., manipuloni ose thjeshtëzoni artikujt në klasë.
- Përdorni numrat rendor për të treguar vijimësi dhe për t'ja mësuar atë.
- Përdorni modelimin në klasë, psh., tregoji nxënësit sesi do të duket projekti i përfunduar dhe bëni gabime të qëllimshme në mënyrë që të modelojë strategjitë e zgjidhjes së problemeve.
- Inkurajo nxënësit e tjerë të klasës.

konceptet sa më shpesh.

- Kur prezantoni materiale të reja, fillimisht qartësoni qëllimet dhe objektivat kryesorë (Mastropieri & Scruggs,2002).

Të menduarit abstrakt- Të mësuarit konkret është zakonisht një nga pikat e forta të nxënësve me sindromë Down, por aftësitë e të menduarit abstrakt si p.sh., zbritja, llogaritjet komplekse, vlerat e shifrave janë më të vështira. Shumë nxënës shfaqin dhe vështirësi në renditjen e hapave dhe zgjidhjen e problemit.

Strategjitë në klasë

- Përdorni aktivitete të qëllimshme që çojnë drejt imitimit dhe kopjimit.
- Mësojuni nxënësve se çfarë përfaqëson numri në të vërtetë.
- Ofroni mundësi të ndryshme për të dalluar ndryshimet në madhësi, formë dhe sasi.
- Nxënësit me sindromë Down performojnë më mirë kur atyre iu paraqiten udhëzimet e procedurave matematikore vizualisht.
- Mësojini ato t'a skicojnë fillimisht problemin dhe t'a shkruajnë zgjidhjen në skicën e krijuar tashmë.

Të mësosh nxënësit

Strategjitë në klasë

- Mësoji jetën e përditshme, aftësitë për një jetesë të pavarur p.sh., përdorimin e monedhave, të treguarit e kohës, të bërit pazar, të gatuarit.
- Të punuarit me memorizimin e numrave të rëndësishëm, për shembull fjalëkalimet e kartës së bankës, numrin e telefonit etj.
- Nxënësit me sindromë Down mund të mësojnë kur dhe si të përdorin teknologjinë për matematikën, p.sh., kompjuterat, makinën llogaritëse.

Fjalori- Ka shumë terma që nxënësit duhet t'i përdorin në fjalorin e tyre për të patur sukses në matematikë, p.sh., madhësia, pesha, njësitë e matjes, numra, thyesa, ora, monedhat, forma

Strategjitë në klasë

- Nxënësit me sindromë Down duhet fillimisht të mësojnë fjalorin e matematikës.
- Të mësojnë renditjen e numrave përmes një shumëllojshmërie metodash p.sh., bashkimit, klasifikimit të aktiviteteve dhe supervizimit nga bashkëmoshatarët.
- Renditja e numrave nuk duhet mësuar fillimisht me të kuptuarit e tyre, por do të mësohet me kalimin e kohës derisa nxënësi t'i thotë ato sa më mirë. Edhe pse në fillim disa nxënës gjithmonë do të fillojnë numërimin nga nr.1, ju mund t'a ndihmoni që t'a nisë numërimin më efektivisht duke i kujtuar të fillojnë numërimin edhe nga numrat e tjerë që i janë kërkuar.
- Konsideroni të numëruarin në gjuhën e shenjave si një qasje multi-sensoriale.
- Mos supozoni se nxënësit me sindromë Down do të kuptojnë fjalorin e numrave. Ju mund të zhvilloni një fjalor më të thjeshtëzuar dhe të ripërsërisni konceptet e tij kur ato janë të nevojshme.
- Mësojini ato që të lexojnë numrin në të njëjtën kohë që koncepti është mësuar. Ripërsëritja e koncepteve mund t'i ndihmojë ato që t'i kuptojnë sa më mire.

Manipulimet

Strategjitë në klasë

- Aftësitë mund të mësohen përmes manipulimeve, duke përfshirë këto udhëzime:
 - Renditjen dhe klasifikimin p.sh., zgjidhjen e puzzle-ve me kompleksitet në rritje; bashkimin e objekteve dhe figurave; klasifikim në bazë të ngjyrave, formave, madhësive, ose funksioneve; renditje në bazë të të kundërtave apo të përjashtimit.
 - Sekuencat dhe modelet, p.sh., rruazat ose gotat, karta të sekuencave që mësojnë - në fillim - pastaj dhe në fund; piktura që të mund të tregojnë një histori ose të përshkruajnë ngjarjet e kaluara të cilat duhen renditur siç duhet.

Aftësitë e motorikës fine- Për shkak të hipotonisë (tonus i ulët muskular) të shkruarit e numrave mund të jetë frustruese dhe e lodhshme, duke e kthyer kështu orën e të mësuarit të matematikës në një orë shkrimi.

Strategjitë në klasë

- Sigurohuni që ora e të mësuarit të matematikës është vetëm për të mësuar konceptet matematikore.
- Lejoni nxënësit me sindromë Down që të qarkojnë përgjigjet e sakta ose të përdorin pulla, karta të numrave etj.
- Prezantoni sa më pak artikuj dhe lejoni pak më shumë kohë në përgjigje.
- Përdorni kompjutera për nxënësit që janë më të rritur në moshë.

Motivimi- Nuk ka dëm më të madh për motivimin sesa "dështimet" e përsëritura kur kryejnë detyra të cilat perceptohen si shumë të vështira. Mbani mend se edhe nxënësit më të mirë të klasës do t'a humbisnin motivimin e tyre dhe do të ndalonin së kryeri detyrën nëse ajo mbi-korrigjohet.

Strategjitë në klasë

- Fokusohuni në proces dhe jo në rezultatin në fund, p.sh., "Uuaauu! Ti ke bërë 3 ushtrime shumë saktë! Le të punojmë për një tjetër!" në vend të "ti nuk i ke mbaruar të gjitha".
- Praktikoni konceptet matematikore në vende dhe në subjekte të ndryshme.

Aktivite praktike për të zhvilluar këto parime të cilat duhet të hartohen duke ndjekur sekuencat vijuese:

1. Zgjidhni dhe bashkoni objektet në bazë të ngjyrave, masave dhe formave.
2. Shkruajini duke numëruar objektet nga 1 deri 10.
3. Numëroni deri në dhjetë objekte njëherësh.
4. Të lidh numrat me fjalët e shkruara, fjalët e thëna dhe shumat e duhura.
5. Përzgjidhni 5 objekte nga një set prej 10 objektësh.
6. Bashko numrat nga 1 deri në 5.
7. Të përzgjedhë numrat nga 1 deri në 5 duke iu kërkuar.
8. Rendit numrat nga 1 deri në 5 në formën e duhur.
9. Rendit shumat nga 1 deri në 5 në formën e duhur.
10. Identifiko dhe selekto numrin e saktë që është kërkuar.
11. Etiketo shumat nga 1 deri në 5 sipas kërkesës së dhënë.
12. Kopjo numrat nga 1 deri në 5 sipas kërkesës.
13. Përsërit artikullin (sendin) duke përdorur numërimin nga 1 deri në 10.
14. Numëro nga e majta në të djathtë duke i thënë një nga një numrat.
15. Organizo materialet që ato të mund të numërohen me saktësi.
16. Kryej mbledhje me numra 1 shifror p.sh., 3+4.
17. Numëro objektet deri në 20.
18. Kryej zbritje me numra 1 shifror p.sh., 4-2

3.7.4 Programet matematikore

Ekziston një numër i madh i programeve matematikore të cilat lehtësojnë kuptimin e koncepteve matematikore tek fëmijët të cilët kanë vështirësi në të nxënë, duke bërë më të thjeshtëzuar kuptimin e abstraktes.

Numicon është një qasje multi-sensorike, e cila është krijuar bazuar në pedagogji të verifikuar për të nxitur arritjet matematikore në të gjitha nivelet. Imazheria e Numicon përdor modele të caktuara të cilat paraqesin secilin numër. Modelet janë të strukturuar në atë formë që lejon kombinimin dhe lidhjen e numrave, të cilët shihen dhe eksplorojnë. Ky program inkurajon kuptimin e numrave dhe lidhjen mes tyre. Kuptimi i numrave përfordhet përmes bisedës dhe përdorimit të tyre në jetën e përditshme, në kontekstin real. Kjo e gjeneralizon të nxënë dhe domethënien e koncepteve matematikore. Aktivitetet inkorporojnë detyra të pasura me shumë sesa fleta pune ose detyra nga librat. Numrat janë ide abstrakte – e gjitha çfarë mund të bëjmë është reprezentimi i tyre. Format e Numicon mund të shihen si "fotografitë e numrave".

Qasja e Numicon inkurajon përdorimin e gjithë materialeve konkrete, të strukturuar apo jo. Fëmijët me sindromë Down mund të përfitojnë nga imazheria vizuale e Numicon dhe aparaturo motivuese.

3.8 TRANZICIONI NGA CIKLI FILLOR NË CIKLIN E MESËM TË ULËT

Tranzicioni në ciklin e mesëm të ulët mund të jetë i vështirë për shumë nxënës, veçanërisht për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Për dallim nga cikli fillor, nxënësit duhet të mësohen me më shumë mësues dhe të ambientohen me klasa të ndryshme.

Nxënësit me sindromë Down ka të ngjarë që të hasin në vështirësi me përshtatjen në mjediset dhe pritshmëritë e reja, prandaj shumica e tyre kanë nevojë për përgatitje shtesë dhe ndihmë. Gjatë vitit të fundit të ciklit fillor është e rëndësishme që të planifikohet tranzicioni, që të bëhet sa më mirë dhe më pozitiv i mundshëm për të gjithë ata që janë të përfshirë. Elementet thelbësore për një tranzicion të suksesshëm janë qëndrimet pozitive dhe një plan tranzicioni i përgatitur me kujdes.

Hapi i parë është përzgjedhja e shkollës. Në të shumtën e rasteve shkollimi vazhdon në të njëjtën shkollë, prandaj ky rast është më i mirë për shkak se nxënësi me nevoja të veçanta arsimore do të mbështetet nga shokët me të cilët njihet. Por sidoqoftë, duhet parë në rast se shkolla nuk i përmbush kërkesat për gjithëpërfshirje, prindërit duhet të gjejnë ndonjë shkollë tjetër.

Për të përpiluar një plan të mirë tranzicioni është e rëndësishme të filloni sa më herët të jetë e mundur në mënyrë që të koordinoni mirë kohën e lirë mes shkollës dhe shërbimeve mbështetëse.

Planifikimi mes arsimimit të ciklit fillor dhe atij të ciklit të mesëm të ulët konsideron thelbësore përfshirjen e prindërve dhe të gjithë atyre që janë të përfshirë në edukim të fëmijës.

Diskutojeni se si familja dhe stafi i shkollës mund të komunikojnë haptazi. Diskutoni mënyrat me të cilat fëmija mund t'i qaset kurrikulës dhe kur është mirë të bëhet punë individuale apo grupore.

3.9 PËRSHTATJA E PLANIT MËSIMOR PËR LËNDË NË CIKLIN E MESËM TË ULËT

Në krahasim me ciklin fillor, në ciklin e mesëm të ulët situata bëhet më komplekse, sepse rritet distanca mes objektivave të klasës dhe potencialit të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Sidoqoftë, mund të identifikojmë elementë të përbashkët: në klasën e 6 (apo në klasën e parë në ciklin e mesëm të ulët) janë të parapara aktivitete të ndryshme për bashkëbisedim. Bëhet fjalë për mundësi të mira për të punuar me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore dhe për të identifikuar objektivat e duhura për nivelin e tij: të shqiptoj emrin e tij kur e pyesin, të mësoj të kërkoj një stilolaps hua, të shpreh mendimin e tij dhe të pranojë pikëpamjen e tjetrit.

Për sa i përket mësimit të historisë, në ato raste kur nxënësi me nevoja të veçanta arsimore nuk arrinë të lexoj, objektiva mund të jetë renditja e fakteve dhe ngjarjeve në mënyrë kronologjike. Kjo mundëson paraqitjen e fakteve dhe ngjarjeve në mënyrë kronologjike si dhe mundëson që të ia mësojmë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore konceptin e para dhe pas.

Në gjeografi, objektivi mund të konsistoj në leximin e hartave dhe grafikeve. Edhe në këtë rast, ka nivele të ndryshme të ndërlikueshmërisë: disa mund të përdorin hartat për të organizuar një udhëtim, ndërkohë disa të tjerë mund të mësojnë se si të bëjnë rrugën nga shtëpia për në shkollë.

Lëndët shkencore

Brook & Solomon (2001) studiuar dobinë e aktiviteteve praktike në një mjedis eksplorues për mësimit të koncepteve shkencore nga nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Në bazë të rezultateve të studimit të tyre nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (aftësi të kufizuar intelektuale, p.sh., sindromë Down), të cilët ishin të angazhuar në detyra ndërvepruese, me kohë të mjaftueshme dhe me vetëm disa udhëzime, treguan një nivel të caktuar të përqëndrimit dhe madje kërkuan shkakun e fenomenit që vëzhguan.

Meqenëse kufizimet kognitive² në zgjidhjen e problemeve dhe përgjithësimin e njohurive të mëparshme zakonisht lidhen me vështirësinë e të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, studiuesit kanë studiuar strategjitë kognitive që mund të përmirësojnë performancën e këtyre nxënësve dhe të rrisin rezultatet e tyre. Në fushën e zgjidhjes së problemeve matematikore, Chung dhe Tam (2005) zbuluan se strategjitë kognitive, poashtu udhëzimet nga shembujt e punuar, kishin një efekt pozitiv në performancën e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore (aftësi të kufizuara intelektuale, shkalla e lehtë) në krahasim me udhëzimet e zakonshme. Scruggs et al. (1995, f. 242) theksuan se aplikimi i aftësive të caktuara në lidhje me praktikën ose metodat në fushën e arsimimit shkencor, të tilla si vëzhgimi, krahasimi, konkluzioni etj., mund të kontribuojnë në rritjen e aftësive të të menduarit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Qasjet aktuale arsimore mbështesin faktin se mësimit shkencor i bazuar në kërkime promovon kuptimin më të mirë të ideve dhe koncepteve shkencore, si dhe arsyetimit shkencor. Një fakt i tillë sjell sfida për arsimim shkencor në mjediset gjithëpërfshirëse. Dy çështje specifike në lidhje me këto sfida janë zgjedhja dhe përshtatja e praktikave që mund të rrisin të mësuarit shkencor nga nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, në lidhje me kërkesat e të mësuarit të bazuar në kërkime, si dhe sigurimin e mbështetjes së duhur për ta në mënyrë që t'i përgjigjen me efikasitet këtyre kërkesave.

Ndihma nga bashkëmoshatarët në kontekstin e të mësuarit kërkimor është sugjeruar si një metodë e suksesshme për lehtësimin e aktiviteteve shkencore, megjithëse lehtësimi i arsyetimit shkencor mbetet sfidues (Scruggs & Mastropieri, 1995a).

²njuhëse

Në një studim pilot (Farlow, 1994) mësimi bashkëpunues është treguar të jetë një metodë efikase për promovimin e aftësive komunikuese dhe për rritjen e mundësive për njohuri të përmbajtjes në një orë biologjie.

Sidoqoftë, përdorimi i teknologjisë dhe multimedia mund të kontribuojë gjithashtu në mësimin shkencor.

Mësim shkencor i bazuar në të mësuarit përmes aktiviteteve mund t'u siguroj nxënësve me nevoja të veçanta arsimore njohuri të vlefshme për botën dhe të përmirësojnë funksionimin e tyre në botën që i rrethon. Nga ana tjetër, mund të përbëjë një rrugë të rëndësishme për rritjen e aftësive të tyre për zgjidhjen e problemeve (Scruggs et al., 1995). Këto përfitime janë të lidhura fuqimisht me kontekstin arsimor dhe të të nxënësve, brenda të cilit sigurohet mësimi shkencor bazuar në aktivitete. Ekziston gjithashtu një lidhje e fortë e atyre përfitimeve me metodat dhe strategjitë me të cilat afrohet dhe sigurohet mësimi i shkencës. Kërkime të mëtejme, të bazuara në studime dhe të dhëna empirike, mund të sigurojnë prova shtesë mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e metodave të mësimdhënies bazuar në aktivitete specifike, siç janë ato që lidhen me mësimin e bazuar në kërkime. Në çdo rast, duhet të merret parasysh heterogjeniteti që karakterizon aftësinë e kufizuar.

Praktika udhëzuese për të nxitur mësimin shkencor

Udhëzimet memorizuese

Mësimi shkencor kërkon përvetësimin e fjalorit të panjohur dhe në të shumtën e rasteve abstrakt. Sa më herët që fjalori tipik për lëndën të jetë i përvetësuar, më shumë kohë mund t'i përkushtohet përvetësimit të koncepteve. Një metodë për të promovuar përdorimin e fjalorit të panjohur dhe terminologjive është metoda e fjalëve kyçe. Përdorimi i kësaj metode nënkupton që një fjalë kyçe, konkrete dhe akustikisht e ngjashme përdoret si përfaqësim i fjalës së panjohur apo të pamësuar.

Kuptimi dhe organizimi i tekstit

Shumica e lëndëve shkencore kërkojnë një autonomi të caktuar të mësimin shkencor prej teksteve dhe kjo kërkesë paraqet vështirësi për nxënësin me nevoja të veçanta arsimore. Strategjitë për të kuptuar tekstin, siç është përmbledhja (ku nxënësit i kërkohet të ofroj një përmbledhje me fjalët e tij) janë treguar efikase tek nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Një metodë e kuptimit të tekstit mund të jetë diferencimi mes idesë kryesore, listimi dhe struktura sekuenciale e tekstit. Struktura e idesë kryesore ofron një ide qendrore brenda një paragrafi (p.sh., erozioni) dhe formulimet mbështetëse. Struktura e listës ofron një numër të shembujve të fenomenit (p.sh., llojet e maleve); ndërsa struktura e rendit ofron një numër të elementeve sipas një rendi të caktuar (p.sh., renditja e planetëve duke filluar nga Dielli).

Praktika direkte

Duke patur parasysh profilin e të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, në veçanti vështirësitë sa i përket aftësive të shkrim–leximit dhe të përfitimeve nga përfaqësimet konkrete, përbën më shumë kuptim fakti që këta nxënës kuptojnë më mirë nga

praktika direkte, ku mësimi arrihet përmes të bërit sesa të lexuarit. Të dhënat kërkimore mbështesin faktin se kur nxënësve u jepen mësimet të cilat janë të përshtatura për praktikë direkte niveli i të nxënësve është më i lartë. Përshtatja nënkupton monitorim dhe lehtësim të të menduarit të nxënësve përmes përsëritjes, mbështetjes vizuale të teksteve si dhe fuqizimit të funksionimit të grupeve të vogla përmes monitorimit dhe përgjigjeve të dhëna.

Përpunimi dhe kërkimi

Sipas studimeve nxënësve me nevojat të veçanta arsimore përfitojnë nga të mësuarit kërkimor, i cili është i strukturuar mirë. Tutje, të dhënat kërkimore mbështesin se nxënësve me nevojat të veçanta arsimore përfitojnë edhe nga pyetësimi i mirë renditur, por mësimi duke përdorur këto metoda duhet të jetë i strukturuar mirë.

Çfarë është e rëndësishme për arsimin efektiv gjithëpërfshirës në shkencë?

Nga mbledhja e të dhënave shkencore (Scruggs & Mastropieri) arritëm në përfundim të 7 variablave të cilat janë signifikante për promovim të arsimit efektiv gjithëpërfshirës në shkencë, të renditura mëposhtë:

1. Një mjedis klasor i hapur dhe i pranueshëm;
2. Mbështetje administrative për gjithëpërfshirje;
3. Shkathësi të përgjithshme efektive të mësimdhënies nga mësimdhënësit;
4. Mbështetje të nevojave të veçanta arsimore, në formë të konsultimeve ose asistimit direkt;
5. Ndërmjetësim i bashkëmoshatarëve, në formë të asistimit klasor ose mësimi bashkëpunues;
6. Kurrikulë të përshtatshme (mbështetje përmes praktikës direkte për mësim të shkencës);
7. Mësim të shkathëtësive specifike sipas llojit të vështirësisë ose fushës në të cilën has vështirësi nxënësi;

Lëndët shoqërore

Së pari, mësimet e lëndëve shoqërore kanë përmbajtje dhe ide nga disiplina që ndryshojnë në përmbajtjen e tyre, qëllimet dhe metodat e kërkimit. Si pasojë, lëndët shoqërore ofrojnë një fushë të pasur në të cilën nxënësve mund të bëjnë më shumë sesa të mësojnë faktet – ata mund të mësojnë dhe të zbatojnë aftësitë për zgjidhje të problemeve, të shqyrtojnë çështje dhe ngjarje nga këndvështrime të ndryshme, të angazhohen në veprimtari autentike të shkrim–leximit dhe të mësohen me mënyra të ndryshme të kërkimit dhe të shprehive mendore. Së dyti, udhëzimet e lëndëve kanë një qëllim social – të përgatisin nxënësve për pjesëmarrje në vendimet dhe veprimet që mund të përmirësojnë shoqërinë në të cilën ata jetojnë. Së treti, rëndësia e shumë lëndëve shoqërore për jetën e përditshme është mbase më e drejtpërdrejtë sesa është rasti në lëndë të tjera, duke lehtësuar zbatimin e mundshëm dhe përgjithësimin e mësimi nga lëndët shoqërore.

Kurrikula e lëndëve shoqërore dhe karakteristikat e nxënësit

Në lëndët shoqërore, teksti shkollor në një nivel të lartë formëson dhe kufizon mësimet dhe ndërvepron me vështirësitë e shkrim–leximit që janë tipike për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Për më tepër, përmbajtja e lëndëve shoqërore paraqet kërkesa specifike të aftësive kognitive të nxënësit.

Udhëzime praktike për të promovuar të nxënët nga lëndët shoqërore

Mësimdhënia e lëndëve shoqërore mund të konceptualizohet si operim në 4 nivele të ndryshme.

Të mësuarit faktik – Në nivelin më bazik, qëndron të mësuarit faktik ose zhvillimi i njohurive deklarative me fjalor të specializuar, figura të rëndësishme, evente kyçe dhe data. Mësimi në këtë nivel gjithashtu përfshinë asocimet e fakteve. Në lëndët shoqërore, mësimi i fakteve shpesh është i ndarë në disiplina të ndryshme. Mësimi i bazuar në fakte nuk është i mjaftueshëm për mësim të lëndëve shoqërore. Nxënësit duhet të mësojnë edhe kuptimin e koncepteve shoqërore siç është migracioni, tregtia e lirë ose kapitalizmi.

Të mësuarit konceptual – rezulton në një kuptim të karakteristikave kryesore të objekteve, ngjarjeve ose ideve dhe asaj që dallon një koncept nga një tjetër (Bruner, Goodnow & Austin, 1967). Të mësuarit konceptual ofron më shumë mundësi për integrim të ideve nëpër lëndë, periudha kohore dhe perspektiva.

Të mësuarit procedural – i referohet njohurive se si të kryejmë një detyrë ose proceseve të përdorura për të kryer një detyrë. Shumë aspekte të të mësuarit të lëndëve shoqërore kërkojnë njohuri procedurale. Për shembull, përcaktimi i vendndodhjes absolute të një vendi ose njohja e procesit të shkrimit të një eseje bindëse, të gjitha këto kërkojnë njohuri procedurale përveç njohurive faktike dhe konceptuale.

Të mësuarit kërkimor – një qëllim i rëndësishëm i mësimdhënies në lëndët shoqërore është të mësuarit kërkimor, në të cilin nxënësit përfshihen në aktivitete disiplinore, të tilla si kërkimi historik ose eksplorimi gjeografik. Të mësuarit kërkimor i thellon rrënjët e mësimet faktik, konceptual dhe procedural në lëndët shoqërore dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë njohuri të ndërlidhura, aftësi për zgjidhje të problemeve dhe zbatim të njohurive në situata të jetës reale.

Ky konceptualizim 4 pjesësh i mësimet të lëndëve shoqërore nuk nënkupton që njëri nivel i të mësuarit është më i rëndësishëm se tjetri. Njohuritë faktike janë bazë thelbësore mbi të cilën mund të ndërtohet një kuptim i koncepteve dhe kërkimi nuk do të ishte shumë produktiv pa themelin e fakteve, koncepteve dhe procedurave. Më poshtë do të listojmë disa ide për mësim të lëndëve shoqërore për secilin prej këtyre niveleve.

Të mësuarit faktik

Fjalori i njohurive – siç u diskutua më lartë, është një element kritik në lëndën e cila ka grupin e saj të caktuar të termave dhe parimeve gjuhësore. Të dhënat kërkimore mbështesin se mësimi i fjalorit të shkencave sociale në një nivel konceptual është i panevojshëm. Mësimdhënësit duhet të bëjnë zgjedhje për fjalët të cilat ata do t'i mësojnë në nivelin faktik – përmes asocimit të fjalës me definicionin e saj dhe cilat fjalë t'ua mësojnë në një mënyrë më të elaboruar (p.sh., diaspora, qytetaria). Termet që janë më qendror në një njësi mësimore ose që përfaqësojnë konceptet kryesore ose “ide të mëdha” në një fushë mësohen më së miri në një nivel konceptual.

Disa metoda efektive për të mësuar asocimet e fjalorit janë:

- ▶ Shikoni paraprakisht fjalorin së bashku me nxënësit para se ta lexoni, ligjëroni ose diskutoni.
- ▶ Krijoni ndihma për mësim siç janë kartat;
- ▶ Lidhni fjalorin e ri me ide dhe përvoja të njohura;
- ▶ Praktikoni fjalët që duhen mësuar në grupe të vogla prej 3–5, deri në përvetësim;
- ▶ Përdorni seanca të shkurta praktike, të shpërndara në kohë;
- ▶ Shmangni mësimin në të njëjtën kohë të fjalëve të cilat mund të krijojnë konfuzion;
- ▶ Ofroni rishikim të shpeshtë dhe sistematik, të ndërthurur me praktikimin e fjalëve të reja.

Mësimi nga ligjërimi dhe udhëzuesit

Ligjëratat janë një karakteristikë e mësimin të lëndëve shoqërore. Kërkimet kanë treguar që nxënësit me nevoja të veçanta arsimore mësojnë më pak nga ligjërimi në krahasim me bashkëmohatarët me zhvillim tipik. Praktikrat udhëzuese të cilat përmirësojnë sasinë e informacionit që nxënësit mësojnë dhe përfitojnë nga ligjëratat përfshijnë rishikimin e informacionit të mëparshëm, marrjen e shënimeve dhe pauzat e shpeshta me qëllimin e të bërit pyetje dhe të bëjnë përmbledhje të informacionit.

Udhëzuesit studimor, të cilët e bëjnë informacionin më eksplisit që nxënësi pritët të mësojë për teste ose vlerësime të aktiviteteve, e lehtësojnë mësimin në lëndët shoqërore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Të mësuarit konceptual

Mësimi i fjalorit

Mësuesit duhet të përmbledhin fjalët kyçe që përfaqësojnë ide të rëndësishme ose të cilat përsëriten në njësi të ndryshme, për një mësim më të gjerë. Mësimi i fjalorit për të zhvilluar të mësuarit dhe të kuptuarit konceptual kërkon më shumë kohë dhe përkushtim, por i mundëson nxënësit kuptimin e tekstit dhe përgjithësimin e kuptimit të fjalëve në kontekste.

Të kuptuarit konceptual arrihet më së mirë përmes elaborimit të thellë të fjalëve përmes teknikave siç janë praktikatat memorizuese.

Mësimi i fjalëve në kontekst dhe demonstrimi dhe diskutimi i situatave të ndryshme në të cilat ndodhin, përfshirë ato jashtë lëndëve shoqërore, zgjeron të kuptuarit e studentëve për nuancat e kuptimit të fjalës dhe i ndihmon ata të përgjithësojnë kuptimin e fjalorit të tyre në materialin e ri.

Organizimi i përmbajtjes – Organizimi i informacionit rreth ideve të mëdha i ndihmon nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfitojnë nga të mësuarit konceptual. Në lëndët shoqërore, për shkak të integritimit të informacionit nga disiplinat e ndryshme, ekziston një rrezik më i lartë që informacioni të duket si i fragmentuar dhe kjo paraqet sfida për të kuptuar dhe për të memorizuar informacionin.

Rutina e përmirësimit përmbajtësor – kjo praktikë përfshinë një gamë të aktiviteteve të cilat e inkurajojnë angazhimin dhe ndërveprimin e nxënësit, përdorimin e organizuesve grafik dhe tjera mënyra për të shfaqur dhe për të konsoliduar informacionin, dhe për të mësuar qasje strategjike dhe metakognitive të të mësuarit.

Kulturore dhe universale – janë një tjetër grup i ideve për të organizuar lëndët shoqërore dhe për të promovuar të kuptuarit konceptual. Kulturore dhe universale janë nevojat dhe përvojat e përbashkëta njerëzore, si ushqimi, struktura familjare, paratë ose ekonomia, dhe komunikimi. Kjo praktikë i ofron nxënësit me nevoja të veçanta arsimore një kornizë e cila e mbështet të kuptuarit social por gjithashtu i ofron edhe mprehtësi sa i përket lidhjes shkak-efekt, ndryshim dhe vazhdimësi, dhe motivim për veprime të ndryshme dhe reagime.

Organizatorët grafik – janë një tjetër mjet i cili paraqet fakte, koncepte dhe lidhje në mes të ideve të cilat e mbështesin të mësuarit konceptual.

Ekzistojnë katër lloje të organizatorëve grafik:

- Organizatorët supozues dhe parashikues – janë të dobishëm në fillim të një mësimi për të ndihmuar nxënësit të aktivizojnë njohuritë e tyre paraprake dhe të kenë një themel për atë që do të mësojnë në vazhdim.
- Organizatorët pozicional dhe model – siç janë diagramat kohor, i ndihmojnë nxënësit të rendisin ngjarjet dhe të mësojnë lidhjen shkak-pasojë.
- Organizatorët grupor dhe organizativ – siç janë hartat konceptuale, i ndihmojnë në sqarimin e strukturës dhe marrëdhënieve midis ideve.

- Organizatorët krahasues dhe dallues – siç është diagrimi i Venit, i ndihmon nxënësit të koordinojnë perspektiva të shumta ose ide të ngjashme.

Personalizimi – Duke pasur parasysh abstraksionin e shumë koncepteve në lëndët shoqërore, praktikat udhëzuese shpesh përqipen të lidhin përmbajtjen me jetën personale dhe përvojat e nxënësve. Për shembull, korniza e mjedisit në zgjerim angazhon nxënësit në hulumtim të jetës dhe komuniteteve të tyre dhe me pas kërkon zbatimin e këtyre përvojave në një kontekst më të gjerë. Edhe metoda kulturore dhe universale nxit lidhjen mes përvojave personale të nxënësve me konceptet e mëdha shoqërore, politike, ekonomike dhe historike.

Personalizimi mund të jetë veçanërisht i dobishëm për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, të cilët mund të kenë përvojë më të kufizuar me ose të kuptuarit e koncepteve kryesore në lëndët shoqërore.

Personalizimi mund të lehtësohet përmes diskutimeve në klasë dhe nga aktivitete të tjera, duke i angazhuar nxënësit në aktivitete aktuale ose të stimuluar.

Sidoqoftë, personalizimi mund të kufizojë të kuptuarit, veçanërisht në klasat e historisë. Jeta dhe përvojat e përditshme të nxënësve janë shumë të ndryshme nga shumica e ngjarjeve historike dhe personazheve që ata mësojnë. Interpretimi i historisë përmes lenteve të përvojës sonë vetjake çon në paragjykim (Ashby & Lee, 1987; Judd, 1915; Wineburg, 2000), duke kufizuar kështu aftësinë tonë për të kuptuar njerëzit dhe ngjarjet në kontekstin e kohërave dhe situatave në të cilat ato ndodhën. Prandaj, mësuesit duhet t'i tërheqin nxënësit drejt lëndëve shoqërore duke e bërë historinë më personale dhe më pas t'i ndihmojnë ata të qëndrojnë prapa dhe të shqyrtojnë ndryshimet midis atëherë dhe tani.

Të mësuarit procedural

Udhëzimet strategjike kognitive – Udhëzimet e qarta strategjike kognitive të përdorura në shtjellim të detyrave akademike janë një nga ndërhyrjet më të dobishme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (Vaughn, Gersten, & Chard, 2000). Udhëzimet strategjike kognitive adresojnë të mësuarit procedural dhe konceptual duke u siguruar nxënësve me nevoja të veçanta arsimore mjete procedurale të cilat ata mund t'i përdorin për të thelluar kuptimin e njësisë. Veçanërisht metoda e fjalës kyçe e diskutuar më parë, i ka ndihmuar nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të zotërojnë faktet dhe fjalorin në lëndët shoqërore. Strategjia e gjenerimit të pyetjeve përmes së cilës nxënësi mëson të bëjë pyetje specifike dhe të kërkojë përgjigjet e tyre në tekst para, gjatë dhe pas leximit, është përdorur me sukses për të përmirësuar kuptimin e tekstit të lëndëve shoqërore. Kjo strategji i ndihmonë nxënësit të gjejnë idenë kryesore, identifikimin e temave, përmbledhjen e informacionit dhe parashikimin (Wong, Wong, Perry, & Sawatsky, 1986).

Leximi strategjik bashkëpunues dhe mësimdhënia reciproke kanë dhënë rezultate të mira në përmirësim të arritjeve në lëndët shoqërore. Secila prej këtyre strategjive i çon nxënësit në një seri hapash procedural që përfshijnë:

1. Paraqitjen;
2. Monitorim të të kuptuarit;
3. Gjetjen dhe zgjidhjen e vështirësive në të kuptuar;
4. Përmbledhjen;
5. Parashikimin;

Të mësuarit kërkimor

Të mësuarit përmes kërkimit mbledh së bashku njohuritë faktike, konceptuale dhe procedurale në një performancë ose produkt që ofron një përvojë autentike në lëndët shoqërore. Kërkimi ofron mundësinë për të integruar temat e lëndëve shoqërore në mënyrë që të promovojnë mirëkuptimin ndërdisiplinor.


Të dhënat kërkimore mbështesin përfitimet në njohuri të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore të krahasueshme me ato të nxënësve pa nevoja të veçanta arsimore dhe të favorshme, kur krahasohen me nxënësit që merren me mësim tradicional i bazuar në tekste shkollë. Gjithashtu qëndrimet e nxënësve ndaj lëndëve shoqërore janë më pozitive kur të nxënët është i bazuar në projekte dhe rezulton që nxënësit mund të transferojnë njohuritë e tyre në ngjarje bashkëkohore dhe të përfshihen në arsyetime dhe argumentime më të gjera gjatë diskutimit në grup. Megjithatë, ndikimi i qasjes bazuar në projekte për të mësuar lëndët shoqërore ndërmjetësohet nga aftësitë e mësuesit për menaxhim efektiv të klasës.

3.10 MATERIALET

Plani Individual i Arsimit duhet të përmbajë, sa më shumë që të jetë e mundur, të gjitha lëndët e programit të rregullt të klasës, duke i dalluar secilën veçmas për nivelin e vështirësisë. Në të shumtën e rasteve, materialet didaktike nuk janë të përshtatura për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Më poshtë i gjeni disa lloje të materialeve që mund t'i përdorni.


Diagramet shkak-pasojë

Paraqesin raportin shkak-pasojë në veprimet e një personazhi në histori, në shfaqjen e një fenomeni, në ngjarjet historike. Për shembull, për të kuptuar ngjarjet historike nuk kufizohet vetëm në memorizim të datave. Çdo ngjarje është pasojë e një seri ngjarjesh të vogla që i kanë paraprirë. Është e mundur të vizualizohet ky cikël i ngjarjeve kronologjike përmes diagramit shkak-pasojë. Diagramet shkak-pasojë ndryshe njihen edhe me emrin shpina e peshkut (forma e tyre ngjason me skeletin e një peshku).



Diagramat kohor

Linja e kohës është një mënyrë e duhur për të paraqitur elementët kyç të një rendi kronologjik. Në shkencat natyrore përdoret për të treguar procedurat e eksperimenteve shkencore. Për shembull, nëse një nxënës për të mësuar mësimin e historisë duhet të kuptoj sekuencën kronologjike të ngjarjeve mes të shekullit XVI dhe XVII, është e nevojshme të bëhet një linjë kohore sikurse kjo.



i/e vogël



i/e madh/e



Milingona




Flutura



Pinguini




Ariur



Elefanti


Bashkësitë

Paraqesin një sistem të mirë për të evidentuar grafiksht ngjashmëritë dhe dallimet, si dhe për të bërë krahasime. Forma më e njohur është diagrami i Venn. Për shembull:




Linjat kohore

Linjat kohore përdoren shpesh për të paraqitur një sekuencë në bazë të një aspekti karakteristik (p.sh., "dimensionet e kafshëve").



Hartat konceptuale

Përdoren për të ilustruar tematikën kryesore e për të listuar një numër të caktuar të detajeve më të vogla të cilat janë të nevojshme për ta shpejuar. Për shembull, në shkencat natyrore, tema “materia” mund të strukturohet në këtë mënyrë



4 SJELLJA

Kur flasim për sjellje dhe personalitet tek individët me sindromë Down duhet të dimë që ata ndryshojnë po aq shumë sa edhe bashkëmoshatarët e tyre. Pjesa më e madhe e tyre janë socialë dhe kanë sjellje të përshtatshme shoqërisht.

Nxënësit me nevoja të veçanta në fushën e sjelljes shumë rrallë ndryshojnë nga sjelljet e shfaqura nga bashkëmoshatarët e tyre dhe rregulloret e sjelljes së shkollës duhet të jenë të aplikueshme për të gjithë nxënësit. Në qoftë se një nxënës me sindromë Down vazhdimisht përfshihet në sjellje problematike është e rëndësishme të ekzaminojmë arsyet themelore, sepse shpesh herë disa aspekte të jetës së shkollës nuk përmbushin nevojat e tij. Kërkimet referuar kategorive dhe tipeve të sjelljeve problematike të shfaqura nga nxënësit me sindromë Down tregojnë që këto sjellje mund të jenë informuese veçanërisht nëse shoqërohen me plan mbi sjelljen. Kërkimet kanë treguar që sjelljet e papërshtatshme mund të kenë një funksion të rëndësishëm për një individ me aftësi të kufizuar. Sjellja nëse është ose jo shoqërisht e pranueshme, shërben për të treguar nevoja, kërkesa ose preferenca. Kjo është veçanërisht për individët që nuk mund të kenë një sistem efektiv të komunikimit verbal.

Në një studim të NDSS (National Down Syndrome Society) në vitin 1996, prindërit dhe mësuesit sugjeruan disa këshilla për menaxhimin e sjelljes në klasë. Teknika më me shumë rezultat për menaxhimin e sjelljes rezultoi lavdërimi apo shpërblimi. Më poshtë po rendisim disa nga metodat të cilat kanë rezultuar si më efektivet në menaxhimin e sjelljes tek fëmijët me sindromën Down:

- Shpërblim me materiale të prekshme (lodra, libra, ushqime etj).
- Pushim nga koha e punës.
- Nxitja nga bashkëmoshatarët.
- Humbja e privilegjeve.
- Kontakt i vazhdueshëm me prindërit.

Shkaqet e sjelljeve të papërshtatshme:

Forma më e papërshtatshme e sjelljes tek të gjithë fëmijët, duke përfshirë këtu dhe ato me sindromë Down, është sjellja për të tërhequr vëmendjen. Fëmijët me sindromë Down mund të jenë veçanërisht me kërkues vëmendje sepse:

- ▶ Ata kënaqen kur janë në qendër të vëmendjes dhe nuk pëlqejnë të injorohen.
- ▶ Ata janë mësuar që të kenë vëmendjen e të rriturit gjithmonë për vete.
- ▶ Ata janë mësuar të trajtohen gjithmonë si individë specialë.
- ▶ Kanë patur sukses në tërheqjen e vëmendjes me parë dhe vijojnë me të njëjtat metoda edhe tani për të arritur qëllimin e tyre ose për të shmangur punën.
- ▶ Ndonjëherë nxënësit me sindromë Down do të sillen në mënyrë të papërshtatshme sepse janë të mërzitur apo të frustruar.
- ▶ Ata mund të provojnë të bëjnë të njëjtat detyra ose aktivitete me të tjerët por do të shohin se nuk mund t'ja dalin pa një ndihmë të vogël.
- ▶ Ata mund të pretendojnë se detyra që ju është dhënë është e vështirë dhe jo interesante për ta.
- ▶ Ata mund të mërziten kur të tjerët nuk i kuptojnë dhe nuk i japin kohë për të kuptuar atë që ata përpiqen të thonë.
- ▶ Ndonjëherë fëmijët me sindromë Down mund të shfaqin sjellje të papërshtatshme kur janë të pasigurtë apo konfuzë në atë se çfarë duhet të bëjnë.
- ▶ Ata nuk kanë arritur të kuptojnë udhëzimet e dhëna për të gjithë klasën.
- ▶ Ata mund të kenë harruar atë që ju tha.
- ▶ Ata mund të kenë vështirësi të mësohen më rutinën dhe rregullat e reja dhe vazhdojnë t'i bëjnë gjërat sipas mënyrës së vjetër.
- ▶ Ata mund të bëhen konfuzë nga mesazhe të ndryshme që ja japin individë të ndryshëm.
- ▶ Fëmijët me sindromë Down shpesh janë subjekt i supervizimeve dhe i mbikqyrjes dhe si pasojë ata mund të ndihen të bezdisur mbi kontrollin që i bëhet jetës së tyre.
- ▶ Ata mund të refuzojnë bashkëpunimin me mësuesit e tyre qoftë edhe për çështje parimi (shmangia nga kontrolli i vazhdueshëm).
- ▶ Ata mund të shfaqin kokëfortësi nëse kuptojnë që nuk ju është dhënë mundësi për të zgjedhur vetë aktivitetin e tyre.
- ▶ Ata mund të ndihen në presion dhe kanë nevojë për pak pushim.
- ▶ Ata nuk e pëlqejnë të qenit të tërhequr nga klasa dhe të ndarë nga shokët e tyre.

4.1 Menaxhimi i sjelljes

Menaxhimi i sjelljes tek nxënësit vijon me progresionin nga "lokusi i jashtëm i kontrollit" në "lokusin e të brendshëm të kontrollit". Këto janë shprehje për të përshkruar procesin e kalimit nga të rriturit si të përgjegjshëm për kontrollin e sjelljes të tyre, në nxënës gjithmonë e më tepër të përgjegjshëm për kontrollin e sjelljes së tyre. Ky është një progresion në të cilin kalojnë të gjithë individët. Kështu, kur një fëmijë nuk po sillet në mënyrë të përshtatshme pyesni veten: "ku është lokusi i kontrollit, është tek personi apo në burime të jashtme"? Qëllimi i menaxhimit të sjelljes duhet të jetë kalimi nga lokusi i jashtëm tek lokusi i brendshëm i kontrollit.

Forma më e mirë e menaxhimit të sjelljes është parandalimi. Të rriturit që punojnë me fëmijët fillojnë t'i kuptojnë më heret se kur fillon një sjellje e papërshtatshme. Cilido i rritur ka mundësitë e mëposhtme për të parandaluar këtë sjellje pa u shfaqur mire.

- Modifiko qasjen e fëmijës
- Modifiko mjedisin
- Modifiko ndërveprimin

Secila nga këto tre mundësi është efektive kur bëhet fjalë për menaxhimin e sjelljes por një nga pikat kryesore është që parandalimi bën që sjellja të mos kthehet në problem. Supozojmë se nuk arritët të parandaloni një sjellje nga përshkallëzimi i saj, si të procedoni më pas?

Metoda e dytë më e mirë në menaxhimin e sjelljes është ridrejtimi. Ridrejtimi realizohet thjesht duke parë ecurinë e fëmijës dhe duke e drejtuar atë drejt një aktiviteti tjetër. Kjo mund të bëhet me një përqaftim, buzëqeshje dhe një sigurim se ka diçka tjetër më të mirë për të bërë. Nuk është e nevojshme të përdoren fjalët. Nuk ka nevojë për shpjegime të detajuara të asaj se çka është jo e pranueshme për ty, thjesht drejtoheni fëmijën në një tjetër vend më të mirë. Ridrejtimi kërkon ngrohtësi dhe siguri, kjo mundësohet edhe kur ju nuk jeni shumë i/ e njohur për fëmijën. Kurrë mos e nënvlerësoni fuqinë e një përqaftimi. Kalimi nga parandalimi dhe ridrejtimi joverbal në teknikën tjetër të menaxhimit të sjelljes ku përfshihet si mundësi për të thënë "JO" ose t'i jepet mundësi fëmijës për të gjetur një aktivitet më të mirë. Kjo përfshin përdorimin e dialogut me fëmijën. Gjithsesi kjo nuk do të thotë se ju duhet të vini rreth e rrotull klasës ose të uleni në një vend dhe të bërtisni "JO". Kjo do të thotë të ndërveprosh aktivisht me fëmijën dhe të bëhesh një me të (edhe fizikisht) dhe të përpiqesh t'i tërheqësh vëmendjen sa më qetësisht. Sigurohu se ai po të ndjek, po të shikon dhe thuaj "jo ne nuk e bëjmë këtë...le të bëjmë këtë tjetër..." . Ju duhet t'i ofroni fëmijës vetëm një zgjedhje jo një seri zgjedhjesh ose zgjedhje të pa orientuara. Kur një fëmijë i ofrohet një zgjedhje duhet të jetë jo më tepër se me dy mundësi. Lëreni fëmijën të vetë kontrollohet dhe të zgjedhë një nga dy mundësitë. Zgjedhje e mirë do të ishte t'i ofrohen mundësi që njihen se i ka të preferuara.

Burimi i fuqisë personale është ndjesia që ti ke një mundësi.

Shpesh një fëmijë kur nuk po bën atë që i kërkohet ose atë që pritet të bëjë ndodh sepse ndihet jo i fuqishëm për të marrë pjesë në atë se çfarë po ndodh. Kalimi në veprim ose mospërfillja është shembull konkret i një personi që ndihet i pa fuqishëm. Ju duhet të tregoheni më të zgjuar sesa vetë problemi. Merrni fëmijën në një vend më të qetë, ku nuk ka shumë mundësi të shpërqëndrohet dhe flisni me të me zë të ulët rreth mënyrës të të bërit një zgjedhje të mirë. Kyç për të bërë këtë për shumicën e fëmijëve është të pyesësh nëse nga sjellja e shfaqur do të bëjë një shok. Çdokush i do shokët. Njerëzit e pafuqishëm ndihen sikur nuk kanë shokë, prandaj përdore këtë moment si mësimdhënie për të folur se si të bëjmë shokë. "Çfarë na bën të zëjmë një shok, mbase kur ndan gjëra, mbase kur pret radhën tënde, mbase kur respekton një person tjetër"? Mundohu të zbulosh se çfarë mendimi ka fëmija se si mund të bësh një shok.

Procesi i reaktivitetit ndodh kur një nxënës i kërkohet të këtë sjellje të mirë ka gjasa që kjo sjellje të rritet. Për këtë, mbajtja e të dhënave të shkruara është një qasje menaxhimi e fuqishme e sjelljes. Mbaj mend që sjelljet që shpërblehen do të përsëriten. Reaktiviteti

shpërblen sjelljen që ti kërkon. Ju mund të filloni duke mbajtur një tabelë me sjelljet e përshtatshme të vendosura në tavolinën e nxënësit dhe vazhdimisht të shënosh sjellje të reja të përshtatshme. Kjo mund të përforcohet dhe me lavdërime verbale të tilla si; më pëlqen shumë kur ti rri në vendin tënd dhe dëgjon mësuesin dhe mësimet me vëmendje, shoqëruar kjo me një notë në tabelë. Pastaj gradualisht zbeh vlerësimet dhe tërhiqe nxënësin për të praktikuar reaktivitetin.

Përdor tabela në mënyrë që nxënësi të ketë hapat e detyrave të ditës. Mundohuni të përdorni pjesën e sipërme të tavolinës së punës së nxënësit për të vendosur një tabelë që përmban programin e ditës ose të orës. Vendosja e qëllimeve ose e një vlerësimi në tabela të tilla për një detyrë është një tjetër mënyrë për të rritur kontrollin e brendshëm të sjelljes.

Vetëvlerësimi është qasja më e fuqishme që kemi në menaxhimin e sjelljes.

Ti thuash nxënësit BRAVO kur arrin të përmbushë një detyrë është një tjetër mënyrë për të rritur kontrollin e brendshëm. Duke thënë shpesh bravo/ të lumtë/ shkëlqyeshëm/ fantastike/ ja dole shumë mire etj., jep vlerësime pozitive mbi sjelljen. Zbuloj se çfarë pëlqen nxënësi juaj, çfarë dëshiron dhe jepja mundësinë të zgjedhë vetë shpërblimin e tij. Mbjaj mend se vlerësimet kalojnë nga të prekshmet dhe vlerësimeve sociale deri tek vetëvlerësimi. Qëllimi final i menaxhimit të sjelljes është që nxënësi të njohë rregullat dhe t'i vendosë vetë ato për t'i respektuar më pas.

5 PROCESIMI NDIJOR DHE MENAXHIMI I TIJ

5.2 Karakteristikat e çrregullimit të procesimit ndijor

Çrregullimi i procesimit ndijor ndodh kur truri i individit përpunon në mënyrë jo efçente mesazhe që vijnë nga mjedisi. Individët me çrregullim të procesimit ndijor e kanë të vështirë t'i përgjigjen përvojave ndijore. Një fëmijë mund të ketë të dhëna ndijore që në mënyrë të papërshtatshme mund të jenë shumë të larta ose shumë të ulëta. Fëmijët mund të luhaten midis dy ekstremeve. Fëmijët me çrregullim të procesimit ndijor zakonisht shfaqin simptoma me frekuencë të caktuar, psh., disa herë në ditë; me intensitet të caktuar, psh., shkalla e reagimit apo shmangies; dhe kohëzgjatje të caktuar, psh., periudha e simptomave.

Karakteristikat e fëmijëve me çrregullim të procesimit ndijor

TEPËR TË NDJESHËM	PAK TË NDJESHËM
<p>Prekja:</p> <ul style="list-style-type: none">• Fëmija shmang kontaktin me njerëzit dhe objektet.• Reagon negativisht dhe emocionalisht ndaj të prekurit.• Është selektiv rreth higjenës personale, veçanërisht në lidhje me rrobat.• ëllimisht shmang disa materiale dhe temperatura.	<p>Prekja:</p> <ul style="list-style-type: none">• Fëmija është i pavetëdijsëm që po preket ose goditet• Mund të jetë i pavetëdijsëm për papastërtitë që mund të ketë në fytyrë nga ushqimi ose hundët me sekrecione
<p>Lëvizjet:</p> <p>§Fëmija eviton lëvizjet Mund të evitoj aktivitetet që nuk janë të lidhura me tokën, p.sh, vrapimi, alpinizmi, lëkundjet</p>	<p>Lëvizjet:</p> <p>§Fëmija është në lëvizje konstante Dëshiron lëvizje të shpejta dhe lëkundëse, p.sh, fëmija mund të rrahë krahët</p>

<p>Pozicionimi i trupit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fëmija është i pasigurt me lëvizjet e trupit 	<p>Pozicionimi i trupit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fëmija është zakonisht i ngathët • Tregon një mungesë të koordinimit
<p>Pamjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fëmija ka mungesë të kontrollit ndaj lëvizjeve të syve • Mund të ketë vështirësi për tu fokusuar tek objektet • Mund të mbireagojë ndaj dritës 	<p>Pamjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fëmija shpesh humbet shenja të rëndësishme vizuale, p.sh, shprehitë e fytyrës, gjestet, shenja, udhëzime të shkruara
<p>Tingujt:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fëmija preferon qetësinë • Zakonisht ankohet për zërat e lartë 	<p>Tingujt:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fëmija ka vëmendje të ulët • Ka një të kuptuar të dobët auditiv

5.2.1 Çrregullimi i procesimit ndijor dhe edukimi i përgjithshëm në klasë

Fëmijët me çrregullim të procesimit ndijor zakonisht e kanë të vështirë në fillim të përshtatën me edukimin e përgjithshëm në klasë. Gjithsesi, janë disa strategji që një mësues mund të përdor për ta përfshirë nxënësin me çrregullim të procesimit ndijor në edukimin e përgjithshëm në klasë.

Vlerësimi është vendimtar për menaxhimin e problemeve ndijore në klasë. Vlerësimi i standartizuar mund të përdoret, por vlerësimi i mirëfilltë, i cili kërkon që nxënësit të performojnë detyrat e botës së vërtetë, është më eficient. Mësuesit fillimisht duhet të identifikojnë një detyrë sa më afër reale dhe më pas të identifikojnë ose të vendosin një set me standarte për performancën e saktë të detyrës. Më pas, e ndan detyrën në detyra më të vogla. Për shembull, nxënësi duhet të mësojë orën dhe për ta realizuar këtë proces është e përshtatshme që t'i referoheni aktiviteteve të përditshme si, orari i ardhjes në shkollë, orari i mbarimit të mësimit etj. Pra, nevojitet që aftësitë e mësuara në shkollë të aplikohen apo të jenë sa më afër konkretes dhe jetës së përditshme të nxënësit.

Ndërhyrja e zakonshme terapeutike:

- ✓ Identifiko problemet e procesimit ndijor tek fëmija, p.sh: regjistrimi, modulimi, përgjigjet emocionale dhe sjelljore.
- ✓ Zhvillo një grup për procesimin ndijor të përbërë nga individë të afërt të fëmijës, p.sh: prindërit, kujdestarët, stafi i edukimit, terapistët e shkollës.

- ✓ Zhvillo një rutinë që i përshtatet problemeve ndijore, p.sh: orar i aktiviteteve të përditshme që promovojnë integrimin ndijor dhe sigurimin e një feedback-u të nevojshëm.
- ✓ Përdor aktivitete që qetësojnë ose nxisin sistemin.
- ✓ Përdor mjete të jetës së përditshme, p.sh: kuti qirinjsh, kufje, trampolinë.
- ✓ Herë pas here vlerëso ecurinë e nxënësit.

5.2.2 Menaxhimi i problemeve ndijore

Nëse keni dyshime që nxënësi juaj mund të ketë vështirësi të procesimit ndijor, ju lutem konsultohuni me prindërit e nxënësit dhe me profesionistë të fushës për ndjekje të mëtejshme.

Aktivitetet e përgjithshme për të qetësuar apo nxitur		
Sistemi ndijor	Për të qetësuar	Për të nxitur
Taktil	<ul style="list-style-type: none"> • Presion i lartë i të prekurit • Mbështjellje me rroba të buta • Përkëdhelje ritmike (masazh) • Përqaftime • Të bërit një banjo 	<ul style="list-style-type: none"> • Prekje e lehtë (sidomos në fytyrë, pëllëmbë dhe në stomak) • Prekje që përfshin lëvizjet • Të bërit një dush
Vestibular	<ul style="list-style-type: none"> • Lëvizje ritmike • Lëkundje e ngadaltë • Mbjtja e pozicionit të kokës ose të trupit • Lëvizje të pandërprera 	<ul style="list-style-type: none"> • Lëvizje jo ritmike • Tundje, kërcime ose hedhje • Pozicionim vertikal
Proprioreceptiv	<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitete rezistente • Aktivitete motorike ritmike 	<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitete rezistente • Ndryshim i vazhdueshëm i aktiviteteve motorike
Vizual	<ul style="list-style-type: none"> • Ngjyra të mbytura, të lehta ose natyrale • Ndarëse të ambienteve të dhomës • Të dhëna të vazhdueshme dhe të qëndrueshme 	<ul style="list-style-type: none"> • Ngjyra të ndritshme dhe të hapura • Lëvizja e objekteve në pozicionin e fytyrës • Fokusimi i ndriçimit mbi objekte • Lëvizja e objekteve me shpejtësi të çrregullt
Auditiv	<ul style="list-style-type: none"> • Zhurma të lehta • Gumëzhima të ulëta • E folur ose e kënduar në mënyrë monotone • Përdorimi i ritmit të ngadaltë 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimi i intensitetit të tingujve • Muzikë të lartë
Gustativ	<ul style="list-style-type: none"> • Thithje • Përdorimi i shijeve të lehta • Temperaturë e qëndrueshme dhe qëndrueshmëri e ushqimeve dhe lëngjeve • Lavdërime të vazhdueshme gjatë aktiviteteve 	<ul style="list-style-type: none"> • Agrume, shije të kripura ose të tharta • Lëngje të ftohta • Larmishmëri në temperaturën dhe strukturën e ushqimit • Përtypja përpara ose përgjatë fokusimit në një detyrë

Shënim: Nëse vëreni që nxënësi juaj paraqet probleme ndjesore konsultohuni me prindin dhe profesionistë të tjerë të cilët punojnë me fëmijët, për të siguruar një mjedis të përshtatshëm për të. Informohuni dhe sigurohuni që keni marrë informacion të saktë dhe të vulltshëm për punën tuaj të përditshme.

6 PËRFSHIRJA E BASHKËMOSHATARËVE

E dimë që kërkesat që vijnë nga bashkëmoshatarët janë mundësi të mira për rritje dhe përforsim pozitiv për gjithë: e njëjta vlenë tek fëmijët me sindromë Down dhe për të nxënëit tek ata.

Si t'u përgjigjemi pyetjeve të bashkëmoshatarëve?

Në shtator kur fillon shkolla, nëse jemi në fillim të një cikli shkollor, nxënësit janë kureshtar të dijnë se çfarë do të ndodh në këtë rrugëtim të ri ditor, të kuptojnë se si do të funksionoj, por mbi të gjitha të njohin shoqërinë e këtij rrugëtimi.

Me kalimin e ditëve vendi bëhet më familjar, krijohen miqësi të reja, njihen me njerëz të ri, e në mes të këtyre, kemi dhe një mik me sindromë Down. Sa i përket pyetjeve rreth shokëve të tjerë në klasë, për shembull *cila skuadër i pëlqen; çfarë lloj muzike pëlqen* marrim përgjigje të shpejta dhe të kënaqshme. Ndërsa për shokun me sindromë Down, para se të bëhen këto pyetje, kemi pyetje tjera që shprehin më shumë pasiguri.

Mësuesit dhe nxënësit mund të provojnë të identifikojnë këto pyetje dhe t'u japin përgjigje!

Më poshtë janë listuar disa pyetje të fëmijëve deri në moshën 10 vjeç, më pas të fëmijëve 11 deri në 14 vjeç dhe në fund të adoleshentëve nga 15 vjeç e sipër, sepse disa pyetje apo aspekte janë të ndërlydhura më moshën.

Ajo çfarë ka rëndësi, gjithmonë, është të jepni përgjigje të vërteta dhe të kuptueshme për atë që bën pyetjen. Pra, mos të shmangni pyetjen dhe mos të kufizoheni në një shpjegim shkencor.

Pyetjet që mund të parashtrohen nga nxënësit e ciklit fillor

Përse i ka sytë kështu?

Përse nuk flet mirë?

Përse nuk kupton rregullat e një loje?

Është i sëmure?

Përse nuk luan me mua?

Zakonisht stereotipat e parë fillojnë të shfaqen në vitet e para të shkollës fillore dhe disa kureshtje apo ndjesi kundërthënëse rezultojnë nga sjellja joverbale e shokëve, si zëvendësim ose kompletim i asaj që është thënë verbalisht.

Fëmijët janë kureshtar për disa karakteristika të shokut të tyre dhe mund të jenë pyetje të thjeshta rreth karakteristikave fizike, por janë pyetje që vënë në siklet më shumë të rriturin

sesa ata. Është mirë të përgjigjeni me një shpjegim të thjeshtë por të vërtetë. Përgjigja duhet të jetë në përputhje dhe koherente me pyetjen, pa ndonjë hezitim, pa mendime të dyta dhe modifikime. Për shembull *Përsa i ka sytë kështu?*, përgjigja mund të jetë sepse ka një kromozom më shumë i cili bën që t'i ketë kështu. Edhe pse fëmija mund të mos e dijë se çfarë është një kromozom, më shumë gjasë përgjigja do t'i mjaftojë "sepse është një përgjigje" dhe jo një shmangie e pyetjes.

Fëmijët më në moshë do të jenë kureshtar për kromozomin, e nëse duan të dinë më shumë, do të pyesin se çfarë është kromozomi, e kështu do të kalojnë nga pyetja në pyetje. Do të jetë e nevojshme të jepni informacion dhe shpjegime rreth përbërjes dhe formimit të trupit tonë, si funksionojnë dhe në atë rast të flisni për sindromë Down. Nga kjo mund të flisni për dallimet, duke zgjeruara diskutimin në nivel klase. Shpjegoni që sindroma Down nuk është një sëmundje por një karakteristikë me të cilën fëmija lind, për të cilën nuk dijmë cili është shkaku dhe që sjell vështirësi. Tutje, shpejgohet se meqë nuk është sëmundje nuk ofrohet kurë mjekësore dhe nuk është ngjitëse.

Duke parë një shok me vështirësi, në përgjithësi fëmijët në këtë moshë e pranojnë si një gjë normale që ai të ketë asistencë dhe lehtësira, madje ata vet ofrojnë asistencën e tyre, për shembull në ekzekutim të një detyre.

Nganjëherë mund të vini re qëndrime hiperprotektive të cilat, me qëllimin e "ofrimit të ndihmës" tentojnë të zëvendësojnë shokun e tyre në kryerje të detyrave që janë në funksion të autonomisë ditore, të cilat ai do të mund t'i kryente vet (ta vesh/zhvesh pallton, të lajë duart, të rregulloj gjërat e veta, etj.). Pra, "e bëj unë për ty" në vend të "ta tregoj unë se si ta bësh!". Është me rëndësi që mësuesit të mirëpresin dhe t'i trajtojnë mirë këto qëndrime prej "zemërgjerësie" dhe të bëhen model ekuilibri për atë fëmijë, derisa edhe fëmijët të mësojnë të njëjtën gjë.

Mund të ndodh që ndonjë fëmijë të mos i pëlqej që shokut të tij po i ofrohet asistencë, të cilën do të dëshironte ta kishte edhe ai. Në këtë rast duhet të shpjegohet arsyeja dhe nevojat e shokut të tij.

Në këtë moshë, fillohet me dhënien e hapësirës dhe kohës për njohje reciproke të kapaciteteve të secilit, duke stimuluar lidhjet dhe ndihmën reciproke por, në të njëjtën kohë, duke ia kujtuar që në disa momente për të ndihmuar me të vërtetë shokun me sindromë Down, duhet ta lëmë t'i bëj gjërat vet.

Është thelbësore që të gjithë fëmijët (përfshirë fëmijën me sindromë Down!) ta dinë që rregullat sociale dhe të sjelljes janë të njëjta për të gjithë, përfshirë atë. Do të filloj kështu që nga fillimi të përshtatet me rregullat e grupit dhe të shoqërisë së vogël në të cilën jeton dhe mbi atë platformë të themelohet përfshirja e vërtetë. Nëse nuk fillohet që tani, në vazhdim do të jetë e vështirë, por jo e pamundur, zhdukni një shprehje të gabuar për të ndërtuar një sjellje sociale të përshtatshme.

Pyetjet që mund të parashtrihen nga nxënësit e ciklit të mesëm të ulët

A do të shkruaj me shkronja shkrimi?

Përse gjithmonë e ndihmojnë?

Përse ndihet i ofenduar kur bëjmë shaka?

Përse i bëjnë pyetje më të lehta sesa neve?

Në këtë moshë pyetjet janë që me fillim dhe më eksplicite. Do të kishte qenë mirë t'i kushtoni më shumë kohë edukative, ndoshta një njësi ndër-disiplinore, për të kërkuar përgjigjet së bashku.

Mund të parashtroni pyetjen: me siguri keni pyetur veten përse pyetje që ia bëjmë shokut tuaj janë më të thjeshta sesa ato që ua bëjmë juve; e keni parë që nuk shkruan me shkronja shkrimi por përdor shkronjat e shtypit; e keni vënë re që shoku juaj nuk arrinë të lexoj një tekst të plotë ose e lexon me shumë vështirësi, ose nuk arrinë të shkruaj fjali. Jo për këtë është një shok i klasës i kategorisë së dytë ose që vlen më pak ose që ka më pak dinjitet. Për këto gjëra është më ndryshe nga ne sepse ka vështirësi që sjellë sindroma Down dhe tani do ta shpjegojmë se çfarë është.

Nëse e mendojmë për një moment e vëmë re që të gjithë ne, në krahasim me njëri-tjetrin, jemi pak a shumë të mirë në diçka dhe më pak të mirë në diçka tjetër. Secili nga ne është i ndryshëm nga tjetri, kjo na bën unik dhe të veçantë.

Shoku me sindromë Down do të ketë nevojë për ndihmë dhe më shumë kohë për të mësuar. Programi i mësimeve të tij do të jetë më i thjeshtëzuar, i menduar dhe i përgatitur për të nga të gjithë mësuesit. Për të do të ishte shumë e vështirë dhe e ndërlikuar të mësonte, të pyetej dhe të bënte detyrat në klasë si gjithë ju tjerët. Por edhe ky vjen në shkollë për të mësuar dhe duhet të angazhohet. Askujt nuk i pëlqen të bëjë gjëra të vështira, kjo do të na bënte të ndihemi keq sepse nuk arrijmë të kuptojmë atë që duhet bërë. E njëjta vlen për të, mund të mësoj gjëra nëse arrinë të kuptoj sensin dhe qëllimin e asaj që i kërkohet të bëjë.

Në detyrat shkollore mund ta ndihmoni por nuk duhet ta ekzagjeroni, sepse mënyra më e mirë për ta ndihmuar është t'ia tregojmë se si t'i bëj gjërat vet por jo ne të ia bëjmë në vend të tij. Për shembull mund të verifikoni që e ka shkruar mirë në fletore, jo të ia shkruani ju; mund të i jepni sugjerime të ia dal vet dhe ta jetoni së bashku sforcimin që kërkohet për të ia dal, por edhe kënaqësinë e arritjeve.

Një paragjykim shumë i përhapur është se një fëmijë me sindromë Down ka gjithmonë nevojë për ndihmë. Në fakt, edhe ai është rritur dhe nëse ne të gjithë vazhdojmë ta ndihmojmë duke i bërë gjërat gjithmonë në vend të tij, ia krijojmë idenë për vetën të një personi i varur nga të tjerët. Në këtë mënyrë edhe ai vet do ta perceptoj veten dhe do të ndihet si një person jo i shkathët dhe nevojtarë, ndërsa ne duhet të ia rrisim mundësinë për autonomi.

Mund të ketë situata ku do të keni shumë dëshirë që ta ndihmoni, për shembull ta përgatisë çantën, të vendos në rend gjërat e veta, të mbërthej xhaketën, por janë gjëra që ai di t'i bëjë ose mund t'i mësojë shpejt dhe nëse me të vërtetë dëshironi ta ndihmoni mos i bëni në vend të tij, por mësojeni t'i bëjë më mirë dhe vet.

Një gjë që duhet ta kemi parasysh kur jemi me të janë pikërisht "stereotipet" dhe "paragjykimet". Çfarë janë? Janë bindje të gabuara dhe të pavërteta, afirmime, mbi njerëzit të cilat janë formuluar në mënyrë të përgjithshme, por ne i marrim si të vërteta thjeshtë sepse kështu jemi mësuar dhe i kemi pranuar pa ndojnjë kritikë. Nuk na lënë të shohim karakteristikat individuale dhe na bëjnë t'i atribuojmë një personi që nuk e njohim karakteristikat e një grupi personash që janë të ngjashëm. Atëherë ne fillojmë të mendojmë që personat me sindromë Down janë të gjithë njësoj, janë simpatik, të dashur dhe gjithmonë të lumtur. Në fakt nuk ekzistojnë personat me sindromë Down, por ekziston Hana, Genci, Beni, Bora të cilët kanë sindromën Down, por janë persona me karakteristika unike dhe të ndryshme nga njëri tjetri, sikurse gjithë personat.

Stereotipet dhe paragjykimet e ndryshojnë raportin mes njerëzve. Nëse mendërisht e paraqesim dikë sipas një skeme të para-dhënë, ndodh që sillemi me të në mënyrë stereotipike e mbase e nxitim pa qenë të vëmendshëm për sjelljet që presim.

Nëse ndalemi për një moment dhe shohim aspektet e tjera, zbulojmë se shoku ynë mund të jetë një partner i mirë në lojë, është i mirë në sporte, është një shok i mirë me të cilin mund të ngasim së bashku biçikletën apo të hamë një akulllore. Gjatë kohës së lirë mund të hamë diçka së bashku ose të flasim për ekipin e zemrës dhe filmin e parapëlqyer. Pra, ta kemi parasysh që një person është shumë më shumë se sa aftësia e tij për të lexuar rrjedhshëm apo të për shkruar me shkronja shkrimi.

Mbase do të na duhet të jemi të vëmendshëm edhe për mënyrën se si i flasim dhe vëmë re që nganjëherë nuk arrinë t'i kuptoj disa diskutime që i bëjmë ose që papritur ofendohet për disa shaka që ne bëjmë. Nëse e shohim mirë ai përdor një fjalor të thjeshtë, me fraza të shkurta dhe pak të artikuluar. Kjo për shkak se prania e një kromozomi shtesë sjell vështirësi gjuhësore, në të kuptuar e në veçanti, në të shprehur. Për këtë ne duhet ta dimë që ai kupton më shumë se sa që na e shpreh me fjalë dhe që ka vështirësi të kuptoj një fjalor shumë abstrakt dhe të ndërlikuar. Nganjëherë nuk arrinë të kuptoj humorin dy-kuptimësh, shakatë apo metaforat, apo diskutime shumë të artikuluar, sepse ndalet në domethënien tekstuale të fjalëve dhe lodhet për të ndjekur sensin e një fjalie shumë të gjatë. Për ta bërë të kuptoj më mirë atëherë flitini duke përdorur frazat e shkurta, me fjalë të thjeshta dhe duke iu referuar gjërave konkrete ose përvojave që mund t'i përjetoj, në vend të koncepteve abstrakte.

Mund të flisni me bashkëmoshatarët edhe për sjelljen dhe të pyesin:

Edhe ai merr vërejtje kur nuk sillet mirë?

Është dashuruar në mua! Nuk e di se çfarë të bëj!

A vlejnë të njëjtat rregulla që duhet të respektojmë edhe ne?

Sa i përket temës së sjelljes, për dallim prej të nxëniet akademik, ky është një diskutim pak më ndryshe. Nëse për leximin, shkrimin dhe llogaritjet është e nevojshme rrugëtim i ndryshëm, për sa i përket sjelljes i parashtrijmë të njëjta kërkesa sikurse për të tjerët.

E dimë se bashkëmoshatarët i kanë mësuar rregullat implicite, por mund të tentojnë të ju shmangen, ndoshta edhe duke përdorur shokun me aftësi të kufizuar intelektuale. Prandaj, është e rëndësishme që rregullat sociale (të cilat vlejné për të gjithë!) të iu thuhet në mënyrë eksplicite të gjithëve, me një gjuhë të qartë, të kuptueshme dhe pa metafora, pa prituri apo episodin thumbues.

Grupi i bashkëmoshatraëve është një burim i pazëvendësueshëm për të mësuar rregullat sociale dhe mund të i përfshini me një sugjerim eksplicit të këtij lloji: për të qenë mirë me të tjerët edhe shoku juaj duhet të mësoj rregullat sociale, e më shumë se sa fjalët e një të rrituri, këtë mund të ia mësoni ju me sjelljen tuaj, të cilën do ta ketë model, por mbi të gjitha me përgjigjet e juaja dhe reagimet e menjëhershme në situatat që i përjetoni së bashku. Është e mjaftueshme të silleni me të sikurse do të silleshit me një shok tjetër, për shembull, kur krijohen situata konfliktuale, duke i dhënë aty për aty udhëzime për të kuptuar atë që është e pranueshme dhe atë që nuk është.

Pra, ju mund të bëni shaka së bashku me të, të pranoni shakatë e tij por mos ta nxisni atë të bëjë shaka të këqija. Mund ta ndihmoni të kuptoj kufijtë kohor të momentit të lojës (kur është koha për mësim dhe kur është koha për lojë) pa e instrumentalizuar për t'i humbur më shumë kohës mësuesit, pa e nxitur për të bërë shaka apo veprime të cilat ju nuk keni kurajo t'i bëni apo e dini që nuk duhet bërë. Duhet poashtu ta ndihmoni ti kuptoj kufijtë relational se kur bëhet shaka: me kë mund të bëjmë shaka dhe me kë jo, duke ruajtur gjithmonë respektin për tjetrin.

Nganjëherë mund të ketë qëndrime që ju bezdisin apo nuk janë të mira, por ju mund (në fakt duhet!) të keni një qëndrim të vetpërbajtur kur bën një gjë që për ju nuk është e mirëpritur. Mund të ja thoni me qetësi por jo me vrazhdësi, duke e bërë të kuptoni se vazhdoni të jeni miq, por që atë që ka bërë ju nuk e pranoni. Nëse kur përshëndeteni në arritje, ia zgjatni dorën njëri-tjetrit apo përqafoheni, natyrisht këtë duhet ta bëni edhe me të, mirëpo nëse ai/ajo gjatë ditës vjen dhe bën të njëjtën gjë, duke u sjellur sikur një fëmijë i vogël dhe i dashur, mos ia lejoni. Bëjani me dije që askush nuk po e bën dhe qartësojani edhe njëherë rregullën që po ndjekin të gjithë, pra që përshëndetemi kështu kur arrijmë dhe kur shkojmë nga shkolla. Nëse ju përqafohet për t'ua dëshmuar afeksionin e vet, me qetësi i thoni që po ju bën të ndiheni keq dhe që për të dëshmuar miqësinë mund ta bëjë edhe përmes një "cake!" ose një të rënë përkëdhelëse sipër supeve. Provoni të i jepni një alternative për sjelljen e papërshtatshme ose ta pyetni përse është sjellur në atë mënyrë ose të analizoni së bashku mënyra më të përshtatshme për të shprehur zemërimin, trishtimin, mërzitjen ose lumturinë. Kjo do ta ndihmonte atë të kuptonte njohjen dhe menaxhimin e emocioneve në mënyrë më të maturuar dhe të duhur.

Natyrisht nëse bën diçka e cila është shumë e bezdisshme, e rrezikshme apo e turpshme

dhe nuk ia dilni që ta ndaloni, atëherë mund të i drejtoheni mësuesit mirëpo nëse është e mundur ta rregulloni mes vete bëjeni, ashtu siç bëni me shokët e tjerë.

Sikurse ju, do të dojë të jetë pjesë e grupit prandaj do të ju dëgjoj nëse ia thoni gjërat qartë dhe ashtu siç janë. Kjo do t'i duhet edhe në të ardhmen me persona të ndryshëm ose të cilët nuk i njeh. Por një përgjigje e dhënë me vrazhdësi dhe me një ton të ashpër nuk duhet dhënë, sepse mund ta perceptoj jo vetëm si refuzim të sjelljes së tij por edhe si refuzim të atij si person, duke e shtyrë akoma më shumë në atë sjellje për të tërhequr vëmendjen.

Më pas vëmë re që edhe ai/ajo, si gjithë të tjerët, fillon dhe dashurohet në një shok/ shoqe të klasës (mbase në atë më të kërkuarin/kërkuarën në shkollë!). Janë ato përvëlimet e para por zhgënjime afektive universale, e dimë mirë. Edhe në këtë rast mund ta ndihmoni ta përballoj realitetin: kur një ndjenjë nuk ka një kundërpërgjigje, nuk duhet të gënjejmë tjetrin me sjellje të turpshme dhe dykuptimëshe. Kjo bën tjetrin të ushqejë shpresa të kota dhe bindjen që është duke jetuar një histori e cila në fakt nuk është e vërtetë, ndërkohë që është mirë t'i thoni në mënyrë të qartë që nuk jeni të interesuar për të në cilësinë e të dashurit/dashures, por që e doni vetëm si shok/shoqe.

Të mos kemi një përgjigje që duam na ndodh të gjithëve, na bën të ndihemi keq dhe të mërzitemi, por më pas do të kaloj dhe do të na ndihmoj të rritemi. Dikur do të takojmë personin i cili do tu përgjigjet ndjenjave tona dhe shoku ynë do të mund ta takoj.

Më pas nëse bashkëmoshatarët do të pyesin:

- *Çfarë është sindroma Down?*

- *A e din që e ka sindromën Down?*

Atëherë, përtej diskutimeve të bëra mbi karakteristikat dhe vështirësitë e secilit, mbi veçantinë e çdo personi dhe dallimet si një pasuri dhe llojllojshmëri, mund të dedikojmë më shumë kohë dhe të shpjegojmë se çfarë është sindroma Down.

Ndoshta dikush do të na pyes, duke iu referuar shokut të pranishëm në klasë, se a është i vetdijshëm për gjithë këtë. Mund të konstatojmë së bashku që ai është ballafaquar me vështirësitë e tij çdo ditë, sidomos që kur ka filluar frekuentimin e shkollës dhe ka bashkëjetuar ndër vite me sforcimin për arritjen e objektivave. Ndoshta nuk e di mirë nga se i vjen dhe si quhet e gjithë kjo ose ndoshta e din, por nuk i ndryshon asgjë. Ajo çfarë ka rëndësi tani është se ka eksperimentuar bërjen e gjërave mirë (mbase të skijoj ose të kalëroji!). E gjitha kjo mund ta bëj konfuz ose ta bëj të irritohet, e në këtë moshë për të është edhe një problem me të cilin ai duhet të përballlet.

Korniza ligjore për Arsim Gjithëpërfshirës në Kosovë

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji Nr. 05/L-021 Për Mbrojtje nga Diskriminimi;
- Ligji Nr. 06/L-084 Për Mbrojtjen e Fëmijës;
- Ligji Nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës
- Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2012 Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta edukativo-arsimore
- Udhëzimi Administrativ Nr. 26/2012 Kualifikimet për personelin që punon me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore
- Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2013 Përdorimi i Planit Individual të Arsimit
- Strategjia Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikë e Kosovës (2013 -2023)
- Plani strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë 2016-2021

Bibliografia

(Italia), S. (s.d.). Manuale sulle strategie di insegnamento .

Association, E. D. (s.d.). Udhëzuesi i Kujdesit Shëndetësor për Individët me sindromën Down.

Baddeley, C. J. (s.d.). Short-term memory in Down syndrome: Applying the working memory model. Down Syndrome Research and Practice 7.

Chiocca, E. (2009, Agosto). La corresponsabilità dell'inclusione scolastica. MIUR: Linee Guida per l'integrazione scolastica degli alunni con disabilità.

Down, A. I. (2008). Verso una scuola più competente e partecipata. Sindrome Down Notizie.

Down, A. I. (2011). Nella nostra classe c'è un alunno con la sindrome Down.

Down, A. I. (2012). Metodologie e Strategie di comunicazione e di apprendimento: riflessioni critiche.

Down, A. I. (2018). Guida sull'inclusione scolastica degli alunni con disabilità in Italia: diritti e doveri.

Dr Rhonda Faragher, P. P. (2020). International Guidelines for the Education of Learners with Down syndrome. Down Syndrome International .

F.SH, Z. K. (2017). Manual në ndihmë të mësuesit për nxënësit me sindromën Down. Fondacioni Down Syndrome Albania.

Jean-Adolphe Rondal, P. D. (2007). Therapies and rehabilitation in Down syndrome . John Wiley & Sons, Ltd .

Michigan, D. S. (2010). Educator Manual: Supporting Students with Down syndrome in Your Classroom. DSAWM.

Ministria e Arsimit, S. d. (2019). Udhëzues për planifik dhe raportim të punës së edukatorëve, mësuesve mbështetës si dhe asistentëve.

Ministria e Arsimit, S. d. (s.d.). Organizimi i sistemit mbështetës në Institucione edukativo-arsimore.

Ministria e Arsimit, S. d. (Shkurt, 2014). Arsimi Gjithpërfshirës – E drejtë e secilit.

Nathan W. Moon, P. (2012). Accommodating Students with Disabilities in Science, Technology,

Engineering, and Mathematics (STEM): Findings from Research and Practice for Middle Grades through University Education. Atlanta, Georgia: Center for Assistive Technology and Environmental Access.

Onlus, G. S. (2013). Vademecum Scuola.

Panayiota Stavroussi, P.n.g.t. F.p.l.x.p. (2010). Science Education and students with intellectual disability: Teaching approaches. Problems of education in the 21st century .

Society, N. D. (s.d.). Preferred Language Guide .

Society, N. D. (s.d.). What is Down syndrome?

Teknologjisë, M. e. (2017). Plani Individual i Arsimit (PIA) dhe udhëzuesi për hartimin e Planit Individual të Arsimit për fëmijë me Nevoja të Veçanta Arsimore. .

Teknologjisë, M. e. (2017). Praktika Pozitive në Arsimin Gjithëpërfshirës . Prishtinë.

Thomas E. Scruggs, M. A. (2008, October). Science and Social Studies for Students With Disabilities. Focus on Exceptional children, 41.

Vision, W. (2014). Manual për mësuesin . Tiranë.

Winders, P. C. (s.d.). Gross Motor Skills in children with Down syndrome – A guide for parents and professionals .

Wing, T. R. (2007). Teaching number skills and concepts with Numicon material. Down Syndrome Research and Practice .

Ky dokument është zhvilluar nga Down Syndrome Kosova me mbështetjen e Save the Children dhe financim të Qeverisë Suedeze. Përgjegjësia për përmbajtjen qëndron tek zhvilluesi. Save the Children dhe Qeveria Suedeze jodomosdoshmerisht ndajnë pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

Është **detyrë e jona të krijojmë një botë**
ku mund të lulëzoj **potenciali i çdo fëmije**
S.G



UDHËZUES PEDAGOGJIK PËR ARSIMIMIN E NXËNËSVE ME SINDROMË DOWN

CIKLI FILLOR
DHE I MESËM I ULËT

